

Komunitetet shkollore dhe politikat arsimore

Studim

Komunitetet shkollore dhe politikat arsimore

2015

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
KAPITULLI I	16
1.1 Studim veprues për mobilizimin e komunitetit të shkollës	17
1.2 Objektivat e studimit	19
1.3 Çështjet kryesore kërkimore	19
KAPITULLI II – METODOLOGJIA	20
(Elona Boce & Endrit Shabani)	
2.1 Kampioni dhe kampionimi	21
2.2 Instrumentet	24
2.3. Besueshmëria dhe vlefshmëria e të dhënave	25
2.4 Analiza e të dhënave	26
2.5 Kufizime dhe sfidat e studimit	26
2.6 Etika e studimit	27
KAPITULLI III - REZULTATET	28
<i>Pjesa e I e studimit - Elona Boce</i>	
3.1. Pjesëmarrja e prindërve, mësuesve dhe nxënësve në jetën e shkollës	29
3.1.1 Vlerësimi për cilësinë e teksteve shkollore	29
3.1.2 Përfshirja e komunitetit të shkollës në përzgjedhjen e teksteve shkollore	31
3.1.3 Përfshirja e komunitetit të shkollës në komisionet e shkarkimit/emërimit të personelit arsimor	33
3.2 Funksionimi i strukturave të shkollës	38
3.2.1 Këshilli i prindërve të klasës	38
3.2.2 Këshilli i prindërve të shkollës	40
3.2.3 Bordi i shkollës	41
3.2.4 Qeveria e nxënësve	44
Përfundime dhe rekomandime	46
<i>Pjesa II e studimit – Endrit Shabani</i>	48
3.3 – Potenciali e prindërve për t'u organizuar dhe ndikuar në vendimmarrjen e shkollës	48
3.4 – Shkolla, familja dhe nxënësit – një vështrim i thelluar i kontekstit socio-ekonomik dhe kulturor i familjes dhe shkollës ku studiojnë nxënësit	69
3.4.1 Familja - Konteksti socio-ekonomik dhe kulturor ku studiojnë nxënësit	69
3.4.2 Shkolla – Konteksti shkollor, përkushtimi i mësuesve dhe perceptimi i nxënësve për shkollën	74
BIBLIOGRAFIA	82

SHKURTIME

DAR - Drejtoria Arsimore Rajonale

KPT - Komisioni i Përzgjedhjes së Teksteve

MAS - Ministria e Arsimit dhe Sportit

MSH – Matura Shtetërore

OSFA - Open Society Foundation for Albania

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Studimi i ndërmarrë nga Fondacioni ‘Shoqëria e Hapur për Shqipërinë’ ka synuar të paraqesë situatën e zbatimit të politikave arsimore në Shqipëri gjatë dy viteve të fundit

Në veçanti studimi synon të përshkruajë shkallën e përfshirjes së komunitetit të shkollës në përzgjedhjen e teksteve shkollore dhe emërimin/shkarkimin e personelit arsimor, funksionimin e strukturave përfaqësuese të shkollës në përputhje me legjislacionin arsimor në fuqi. Në pjesën e dytë, studimi synon të eksplorojë potencialin e komunitetit të shkollës për tu angazhuar në qeverisjen e shkollës. Studimi përdori një kombinim metodash sasiore dhe cilësore dhe përfshiu pjesëmarrës nga komunitetet e shkollave: prindër, nxënës dhe mësues. Gjetjet synojnë të shërbejnë si pikënisje për të nxitur debatin publik për ecurinë e arsimit, e më tej ndryshimin dhe përmirësimin e politikave, që do të siguronin një arsim më cilësor për çdo fëmijë në Shqipëri. E thënë me fjalë të tjera, ky studim synon të nxisë politika të përgjegjshme në arsim, politika të bazuara tek studimi dhe tek evidencat shkencore. Për më tepër, kjo nismë e Fondacionit, pjesë e të cilit është edhe studimi, ka gjithashtu si qëllim zhvillimin e kapaciteteve të komuniteteve shkollore për t’u organizuar dhe ndikuar në vendimmarrjen e shkollës. Për këtë arsye, në këtë studim hulumtohet në thellësi potenciali i i komunitetit shkollor, dhe në veçanti perceptimi i prindërve për rolin që ata duhet të luajnë në shkollë.

PJESA I – ELONA BOCE

Në ç’përmasa ndodh përfshirja e prindërve, mësuesve dhe nxënësve në vendimmarrjen e shkollës?

Përfshirja në procesin e përzgjedhjes së teksteve

- Edhe pse situata e vjeljes së mendimit të prindërve për tekstet duket se është përmirësuar krahasuar me dy vjet më parë, përfshirja e prindërve në Komisionet e Përzgjedhjes së Teksteve (KPT) është ende e ulët, madje edhe më e ulët. Prindërit, përveç atyre që mbajnë njëfarë lidhjeje me shkollën, mbeten ende gjerësisht të painformuar për procesin e përzgjedhjes së teksteve. Perceptimet e prindërve dhe mësuesve nuk përputhen në këtë çështje, pasi mësuesit japin një këndvështrim më pozitiv të situatës sa i përket përfshirjes së prindërve në procesin e përzgjedhjes së teksteve.
- Studimi u dha prindërve, mësuesve dhe nxënësve mundësinë të shprehen për cilësinë e teksteve. Pjesa më e madhe e tyre (67% e prindërve dhe 63% e mësuesve) i vlerësuan si deri diku të mirë, dhe 65% e nxënësve i vlerësuan si “as të thjeshtë as të vështirë për t’u kuptuar”.
- Gjetjet flasin për një mungesë besimi që prindërit kanë në vetvete tek kontributi që mund të japin në procese si përzgjedhja e tekstit, dhe e njëjta mungesë besimi vihet re edhe tek mësuesit.
- Tek mësuesit që janë njëkohësisht edhe prindër fëmijësh në arsimin parauniversitar u vu re një dallim në vlerësimin për

cilësinë e teksteve që mund të jetë me interes për procesin e zgjedhjes së anëtarëve të KPT-ve. Ata ishin më pak të prirur se prindërit për t'i vlerësuar tekstet dobët dhe shumë dobët, dhe më të prirur se kolegët e tyre pa fëmijë në arsimin parauniversitar, që të vlerësonin tekstet e lëndës së tyre më pozitivisht.

- Nga gjetjet e sondazhit me nxënës kuptohet se tekstet vazhdojnë të hartohen pa marrë parasysh nevojat e veçanta që ka çdo fëmijë, duke lënë jashtë përfitimit nga procesi mësimor një pjesë të mirë të nxënësve.
- Gjetjet tregojnë se ka ende një pjesë të mirë të mësuesve dhe të prindërve që nuk janë të informuar për përbërjen e KPT-ve. Prindërit në KPT vazhdojnë të caktohen nga mësuesit apo drejtori, gjë që sjell një mungesë besimi ndër prindër tek forca e tyre përfaqësuese dhe paanshmëria e gjykit. Kjo shoqërohet gjithashtu edhe me mungesë informacioni nga ana e mësuesve për rolin që duhet të luajë prindi në KPT.
- Mësuesit që kanë qenë pjesë e KPT-ve priren t'i bëjnë një vlerësim pozitiv procesit të përzgjedhjes së teksteve gjë që nuk shpjegon pse tekstet në përgjithësi cilësohen si 'deri diku' të mirë. Vetëm një numër më i vogël mësuesish u shpreh hapur për problemet në proces si p.sh.: mosmarrja

parasysh e mendimeve ndryshe, mungesa e ambienteve të përshtatshme për vlerësimin si dhe të qenit të kushtëzuar nga të tjerët. Mësuesit e përfshirë në KPT prireshin të vlerësonin mirë tekstet e përzgjedhur nga procesi ku kishin qenë pjesë.

Përfshirja e komunitetit të shkollës në shkarkimin dhe emërimin e personelit arsimor

1. Shkarkimi i drejtuesve dhe emërimi i drejtuesve të rinj në vitin e kaluar shkollor 2013-2014 u raportua gjerësisht nga prindërit (51%) dhe nga mësuesit (56%).
2. U vu re një prirje e mësuesve dhe prindërve për ta interpretuar shkarkimin e drejtuesit si një zgjedhje personale më shumë sesa shkarkim nga detyra.
3. Nga përgjigjet e mësuesve në sondazh dhe në intervistat në grup, përgjithësisht procesi i emërimit dhe shkarkimit të personelit arsimor nuk ka kaluar nëpër hapat e përcaktuara në udhëzimet përkatëse të MAS. Vendimet janë marrë në mënyrë të centralizuar përgjithësisht nga Drejtori i DAR-it (sipas 65% të mësuesve).
4. Prindërit mbeten gjerësisht të painformuar për procesin e emërimit dhe shkarkimit të personelit arsimor. Përfshirja e prindërve, por edhe e mësuesve në proceset e largimit/shkarkimit dhe emërimit është raportuar në shifra shumë të ulta.

Në ç'përmasa ndodh përfaqësimi i prindërve dhe nxënësve në strukturat e shkollës?

- Prindërit mbeten në një pjesë të madhe të përfshirjes për strukturat e shkollës së fëmijës së tyre si Këshilli i Prindërve të shkollës apo Bordi i shkollës. Sa më lart të jenë këto struktura në vendimmarrjen e shkollës, aq më pak të informuar apo të përfshirë janë prindërit.
- Strukturat e shkollës përgjithësisht shihen nga prindërit si jo të pavarura në vendimmarrje dhe vendimet shihen si një ekskluzivitet i drejtorit apo mësueses kujdestare të klasës. Studimi tregon një lidhje pozitive midis shkollës së informimit apo pjesëmarrjes së prindërve dhe mësuesve në Bordin e Shkollës dhe perceptimit të këtij organi si të pavarur në marrjen e vendimeve.
- Gjetjet tregojnë se shkolla është ende brenda një rrethi vicioz përsa i takon përfshirjes së prindërve: sa më shumë angazhohen prindërit aktivë, aq më shumë prindërit e tjerë tërhiqen dhe distancohen nga shkolla.
- Një element që prindërit e përmendin, veçanërisht në intervistat në grup, si motiv për mospërfshirje ose moskontribut real në struktura është frika nga ndëshkimi që mund t'i vijë fëmijës nga mësuesi nëse prindërit shprehin mendimin e tyre të lirë.
- Profili i preferuar për prindin që duhet të jetë në struktura jep një informacion me vlerë për procesin e zgjedhjes, pasi vë në dukje dallimet në perceptime ndërmjet mësuesve dhe prindërve: për prindërit është me rëndësi që ai që i përfaqëson të jetë i arsimuar dhe të njohë shkollën, ndërsa për mësuesit është me rëndësi që prindi të jetë i arsimuar, por të jetë i motivuar.
- Ekziston ende prirja që në strukturat e shkollës të jenë të përfaqësuar vetëm një pjesë e caktuar e nxënësve, e cila përbëhet nga nxënësit me rezultate më të larta në mësim, çka përmban në vetvete një premisë përjashtuese për pjesën më të madhe të nxënësve.

Cili është potenciali e prindërve për t'u organizuar dhe ndikuar në vendimmarrjen e shkollës?

Takimet me prindër si forume diskutimi

- Pjesëmarrja e prindër nëpër takime me prindër varion gjatë vitit shkollor dhe nga shkolla në shkollë, por në përgjithësi ajo nuk e kalon gjysmën e prindërve të klasës.
- Prindërit nuk marrin pjesë nëpër këto takime për disa arsye: Së pari për shkak të mungesës së kohës apo koha e papërshtatshme kur zhvillohen takimet. Së dyti, për shkak të mënyrës së njoftimit, e cila shpesh nuk është e sukseshme. Së treti, për shkak të çështjeve që diskutohen (apo mënyrës se si ato prezantohen nga mësuesit) nëpër këto takime.
- Në disa raste janë raportuar mësues të cilët gjatë mbledhjes me prindër nuk respektojnë ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, apo të drejtën e nxënësve dhe prindërve për privatësi.
- Takimet me prindër nuk arrijnë të shërbejnë si forume diskutimi për problemet e shkollës, por vetëm si një mënyrë që prindërit të informohen për ecurinë e fëmijës së tyre në mësim.
- Problemet e shkollës nuk diskutohen në takimet me prindër për disa arsye: Së pari, koha në dispozicion nuk është e mjaftueshme. Së dyti, prindërit shpesh janë pak të informuar mbi problemet që ka shkolla. Së treti, prindërit nuk besojnë se problemet do të zgjidhen duke i diskutuar nëpër këto takime, pasi ata besojnë se as mësuesit dhe as prindërit sëbashku nuk kanë fuqi për t'i zgjidhur këto probleme.

Bashkëpunimi mes palëve

- Në lidhje me nivelin e përfshirjes së prindërve në veprimtarinë e shkollës ka të dhëna kontradiktore, të cilat variojnë nga perceptimi

dhe pritshmëritë që ka secili grup apo individ për rolin që prindi duhet të luajë në shkollë.

- Kur ndeshen me probleme që lidhen me shkollën, prindërit synojnë t'i anashkojnë mësuesin kujdestar dhe strukturat përfaqësuese në nivel shkolle, dhe e çojnë çështjen drejtpërsëdrejtë tek drejtori i shkollës.
- Gjithashtu shumë prindër synojnë që t'i zgjidhin këto probleme duke përdorur rrugë informale, apo duke e trajtuar zgjidhjen e tyre jo si një e drejtë por si një favor që po ju bëhet atyre prej drejtorit të shkollës.
- Pjesa më e madhe e prindërve (70%) shprehen se ata duhet të jenë pjesë e vendimmarrjes në shkollë.
- Megjithatë prindërit ndajnë mendime të ndryshme përsa i përket çështjeve për të cilat ata duhet të përfshihen në vendimmarrje. Ka më shumë prindër që mendojnë se ata duhet të jenë pjesë e komisioneve disiplinore (80%) dhe më pak që mendojnë se ata duhet të zgjedhin drejtorin e shkollës (55%).
- Prindërit shfaqin mungesë besimi tek autoritetet shkollore. Vetëm gjysma e prindërve mendojnë se mësuesit (57%) dhe drejtori i shkollës (53%) e kryejnë detyrën e tyre me përgjegjshmëri.
- Prindërit shfaqin pakënaqësi të lartë ndaj njëri tjetrit. Më pak se gjysma e prindërve (42%) mendojnë prindërit i përmbushin detyrimet e tyre në lidhje me shkollën.
- Pjesa më e madhe e mësuesve (92 %) shprehen se prindërit duhet të kujdesen edhe për problemet e shkollës të cilat nuk lidhen vetëm me fëmijën e tyre.
- Prindërit duken më pak të ndërgjegjësuar në këtë drejtim, pasi vetëm 78% e tyre janë

dakord që ata nuk duhet të kujdesen vetëm për problemet të shkollës që lidhen ngushtësisht me fëmijën e tyre.

- Shpesh ky qëndrim 'individualist' i disa prindërve, buron nga konkurrenca në lidhje me arritjet akademike të nxënësve. Kjo konkurrencë promovohet dhe inkurajohet kryesisht nga modeli arsimor, i cili bazohet në provimet e standardizuara dalëse (i.e. Matura Shtetërore).
- Në shkollat publike të arsimit parauniversitar, komunitetet janë shpesh heterogjene, duke bërë që nxënës dhe prindër nga nivele të ndryshme sociale dhe kulturore të bashkëjetojnë me njëri tjetrin në të njëjtin ambient.
- Nga njëra anë, këto diferenca shihen nga prindërit si barrierë për t'i kuptuar dhe trajtuar problemet në një formë të ngjashme, çka do të mundësonte gjithashtu edhe veprim të përbashkët për zgjidhjen e tyre.
- Nga ana tjetër, këto diferenca mund të bëhen shkak për trajtim të pabarabartë të nxënësve, duke bërë që megjithëse në një komunitet të përbashkët shkollor, jo të gjithë nxënësit të ndeshen me të njëjtat sfida.
- Komunitetet e mësuesve në shkollat publike janë shpesh të fraksionuara në grupe dhe nëngrupe bazuar në bindjet politike, profilin profesional, grupmoshën apo gjininë e mësuesve.
- Me bindje politike, kryesisht mësuesit kuptojnë përkatësinë me një parti të caktuar politike. Një përkatësi e tillë shpesh konsiderohet nga mësuesit si garanci për vendin e punës, apo si rrezik për humbjen e tij (në varësi se cila parti është në pushtet).

Reagimi i përbashkët

- Prindërit dhe nxënësit e shohin mbrojtjen e të drejtave të tyre si një akt rebelimi ndaj autoriteteve shkollë. Për pasojë, ata nuk ankohen kur shohin një problem në shkollë pasi i druhen hakmarrjes që mund të vijë prej këtyre të fundit.
- Nxënësit dhe prindërit shprehen se hakmarrja e mësuesit dhe drejtorit të shkollës mund të ushtrohet përmes uljes së notave në mësim, sjelljes fyese apo dekurajuese ndaj nxënësit, apo pengimi i tij për të marrë pjesë nëpër aktivitetet ekstrakurrikulare.
- 'Frika për notën' qëndron si arsyeja kryesore përse pjesa më e madhe e nxënësve (83%) nuk reagojnë ndaj padrejtësive apo problemeve që hasin në shkollë.
- Mësuesit nga ana tjetër stepen të reagojnë për padrejtësitë që hasin në shkollë pasi i druhen hakmarrjes së drejtorit të shkollës apo strukturave të tjera arsimore.
- Mësuesit shprehen se hakmarrja e drejtorit mund të shprehet përmes largimit nga puna pa shkak të arsyeshëm, apo transferimit të tyre në një shkollë tjetër. Masa këto që evidentojnë moszbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për arsimin parauniversitar.
- Prindërit, nxënësit dhe mësuesit ndihen tepër të pafuqishëm për të mbrojtur të drejtat e tyre në shkollë. Kjo bindje ndërtuar mbi eksperiencën të jetuara ose të dëgjua, shpesh nuk sfidohet edhe kur ligji ofron garanci për mbrojtjen e të drejtave të mësuesve, prindërve dhe nxënësve.
- Vetëm 25 % e mësuesve dhe 33% e prindërve besojnë se nëse prindërit do të bëhen bashkë mund të kontribuojnë në përmirësimin e situatës në shkollat publike.

- Prindërit kanë besim të ulët tek përgjegjëshmëria e Ministrisë së Arsimit (21%) dhe Drejtorisë Arsimore (24%). Për këtë arsye shumë prej prindërve preferojnë t'i zgjidhin problemet e shkollës duke kërkuar ndihmën e autoriteteve të tjera lokale si deputeti i qarkut, prefekti apo autoritete partiake në nivel lokal.
- Prindërit raportojnë besim të ulët tek veprimtaria e strukturave përfaqësuese në nivel shkollor, si Këshilli i Prindërve (30%), apo Bordi i Shkollës (27%).
- Pavarësisht besimit të ulët të prindërve tek autoritetet shkollë, tek strukturat përfaqësuese në shkollë, apo edhe tek forca e tyre, shpesh janë raportuar episode ku prindërit, nxënësit, dhe mësuesit janë angazhuar sëbashku kundër një problemi apo një padrejtësie në shkollë dhe ja kanë dalë me sukses ta zgjidhin atë.
- Shkolla, familja dhe nxënësit – një vështrim i thelluar i kontekstit socio-ekonomik dhe kulturor i familjes dhe shkollës ku studiojnë nxënësit

Familja – konteksti socio-ekonomik i familjes

- Familja shqiptare duket se e ka thyer ciklin e familjes patriarkale, pasi vetëm në 10 % të rasteve nxënësit deklarojnë se gjyshërit jetojnë me ta. Megjithatë rolet gjinore në familje, ku gruaja është shtëpiake dhe burri siguron të ardhurat për familjet mbeten ende të theksuara, por ky cikël thyhet kur gruaja kryen arsimin e lartë.
- Prindërit që kanë kryer arsimin e lartë janë më të predispozuar të jenë në punë me kohë të plotë, dhe për pasojë të jenë në situatë më të favorshme ekonomike se prindërit që nuk janë në punë.

- Një në tre nxënës raporton se vështirësitë ekonomike e pengojnë që t'i kushtohet shkollës.
 - Kushtet e studimit (një dhomë më vete, apo tavolinë studimi) duket se nuk kanë ndikim në rezultatet e nxënësit në mësim.
 - Pasja e pajisjeve elektronike (i.e kompjuter, apo internet) në shtëpi ka ndikim negativ tek rezultatet në mësim. Ndërkohë pasja e librave artistik dhe akademik, ka ndikim pozitiv në rezultatet e raportuara.
 - Ka një lidhje të fortë statistikore midis nivelit të shkollimit të të dy prindërve (ose janë të dy me arsim të lartë, ose të dy me arsim fillor).
 - Nxënësit, baballarët e të cilëve kanë kryer shkollën e lartë, janë 10 herë më të prirur për të patur rezultate të lartë në mësim, krahasuar me nxënësit, baballarët e të cilëve kanë kryer vetëm arsimin fillor.
 - Nxënësit, nënat e të cilëve kanë kryer vetëm arsimin fillor janë 20 herë më të prirur të raportojnë rezultate të dobëta në mësim, se nxënësit nënat e të cilëve kanë kryer shkollën e lartë.
 - Nxënësit që jetojnë në qytet raportojnë më shpesh që ndihmohen nga prindërit për mësimet, krahasuar me nxënësit që jetojnë në fshat.
 - Ndiheja që japin prindërit për nxënësit vjen duke rënë me rritjen e nxënësit.
 - Prindërit që kanë kryer shkollën e lartë janë më të predispozuar për të ndihmuar fëmijën me mësimet, krahasuar me prindërit që kanë kryer vetëm arsimin 8 vjeçar.
 - Nxënësit që ndihmohen shpesh nga prindërit raportojnë më shpesh nota të larta dhe më rrallë nota të ulëta në mësim, se sa nxënësit që nuk ndihmohen asnjëherë.
- Shkolla – konteksti shkollor, përkushtimi i mësuesve dhe perceptimi i nxënësve për shkollën.**
- Shumë nxënës nuk e shohin shkollën si një ambient të gëzueshëm, por si një ambient i lidhur me frikën për notën dhe ankthin.
 - 89 % e nxënësve kanë frikë nga nota dhe 68 % e tyre shprehen se do shkonin me qejf në shkollë nëse nuk do të kishte nota.
 - Një në katër fëmijë shprehet se ndihet i braktisur kur është në shkollë, dhe një në tre shprehet se e ka vështirë të bëjë miq në shkollë.
 - Nxënësit që ndihen të braktisur në shkollë raportojnë dy herë më pak nota të larta se nxënësit që nuk ndihen të tillë.
 - Gjysma e nxënësve shprehen se shkolla ka bërë pak për t'i përgatitur ata për jetën.
 - Një në tre fëmijë studiojnë në klasa me 36-45 nxënës, dhe një në dy fëmijë studiojnë në klasa me 26 – 35 nxënës.
 - Një shkollë publike në qytet ka dy herë më shumë gjasa që të jetë e mbipopulluar se një shkollë në fshat.
 - Nxënësit që studiojnë në klasat e mbi-populluara raportojnë për vështirësi në menaxhimin e orës së mësimin nga ana e mësuesit, duke e bërë të vështirë për disa nxënës që të ndjekin mësimin.
 - Pjesa më e madhe e nxënësve shprehen se shkojnë mirë me mësuesit, dhe gjysma e të anketuarve shprehen se mësuesi i ndihmon kur ata kanë vështirësi. Megjithatë një në dy nxënës shprehet se po të kishte mësues të tjerë, do përpiqej më shumë për të mësuar.
 - Mbiipopullimi i klasës ndikon në mënyrën se si mësuesi organizon orën e mësimin, apo në kohën që ai shpenzon me nxënësit.
 - Nxënësit që studiojnë në klasa me mbi 36

nxënës, kanë tre herë më pak gjasë që të shprehin mendimin e tyre në klasë.

- Mësuesit që japin mësim në klasa me mbi 36 nxënës, janë dy herë më pak të predispozuar që ta ndajnë klasën në grupe të vogla pune.
- Vetëm një në katër nxënës deklaroi se nuk kryen kurse jashtë shkollore. Gjysma e nxënësve të anketuar deklaroi se zhvillojnë kurse në Gjuhë Shqipe dhe Matematikë (të

cilat përbëjnë dy provimet bazë të Maturës Shtetërore).

- Disa nxënës bëjnë kurs privat me mësuesin e lëndës së tyre. 71 % e tyre shprehën se nuk do ta ndiqnin këtë kurs nëse në shkollë nuk do të viheshin nota.
- Nxënësit që nuk i kanë prindërit në gjendje pune, ndjekin pak më rrallë kurse private, se sa nxënësit që i kanë prindërit në punë me kohë të plotë.



KAPITULLI I
Hyrje

Foto : LSA PHOTOGRAPHY

Studimi i paraqitur në këtë raport është pjesë përbërëse e projektit operacional “Monitorimi i politikave arsimore dhe fuqizimi i komunitetit shkollor”, i vënë në zbatim gjatë periudhës 2014 - 2015 nga Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (OSFA). Projekti synon të kontribuojë në rritjen e besimit që komuniteti i shkollës ka në fuqinë për të ndryshuar dhe përmirësuar cilësinë e arsimit. Për të arritur këtë synim, Projekti përdor një qasje të dyfishtë mobilizimi dhe fuqizimi: së pari, duke ofruar evidenca nga studimi pjesëmarrës sasior dhe cilësor dhe, së dyti, duke mbështetur nismat e komuniteteve të shkollës për të përmirësuar gjendjen në arsim. Ndërhyrja e projektit, rrjedhimisht edhe studimi, është lokalizuar në qytetet Tiranë, Elbasan, Durrës, Korçë dhe Kukës, përveç sondazhit me nxënës, i cili pati shtrirje gjeografike në të gjithë rrethet e Shqipërisë.

1.1 Studim veprues për mobilizimin e komunitetit të shkollës

Në këtë studim ofrohen një numër argumentesh në formën e gjetjeve nga sondazhet dhe intervistat në grup me prindër, nxënës dhe mësues. Këto gjetje pasurojnë, informojnë dhe njëkohësisht shërbejnë si bazë për procesin e debatit brenda komuniteteve të shkollave për monitorimin e zbatimit të politikave arsimore. Procesi i debatit qytetar dhe i pjesëmarrjes së komunitetit të shkollës në vendimmarrje është nisur dhe mbajtur aktiv nga Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (OSFA) prej disa vitesh tashmë, në veçanti për aspekte kyçe si: rishikimi i legjislacionit të arsimit parauniversitar, politikat e teksteve shkollore, matura shtetërore dhe gjithëpërfshirja në arsim me fokus tek grupet e brishta dhe të marginalizuara të shoqërisë. OSFA është angazhuar për të brendësuar si në përmbajtje edhe në procese të politikëbërjes parime si: demokracia, llogaridhënia, transparencja, përfshirja e prindërve në vendimmarrje, dekoncentrimi etj. Ky proces lehtësimi dhe angazhimi qytetar mbështetet në parimin se pjesëmarrja e komunitetit të shkollës në proceset e vendimmarrjes përbën një nga faktorët që mundëson rritjen e cilësisë në arsim dhe përmirësimin e rezultateve të sistemit arsimor.

Projekti i OSFA nisi të zbatohet në një kohë kur Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, si edhe aktet nënligjore përkatëse – Dispozitat Normative dhe udhëzimet e MAS-it – ende

nuk kishin gjetur zbatim të plotë, për të mos thënë se ende vazhdojnë të mos njihen dhe kuptohen siç duhet nga ofruesit dhe përfituesit e shërbimit arsimor. Ky ligj parashikon për herë të parë përfshirjen e komunitetit shkollor, me theks tek mësuesit dhe prindërit, në procesin e emërimit dhe shkarkimit të personelit arsimor. Kjo përbën sigurisht një risi që ndihmon në proceset e hapjes dhe demokratizimit të shkollës dhe rritjen e llogaridhënies me kah nga përfituesit e shërbimit. Megjithatë, studimi i vitit 2014 i mbështetur nga OSFA për monitorimin e zbatimit të ligjit evidentoj se për emërimin apo shkarkimin e personelit arsimor është përdorur një bazë ligjore e pasaktë dhe se emërimet/shkarkimet në vitin shkollor 2013-2014 janë kryer në një periudhë të shkurtër dhe me intensitet të lartë. Në shumë raste vendimet e lëshuara nga DAR ishin vendime emërimi të komanduara, gjë që nënkupton zëvendësime të përkohshme të drejtorëve, por që edhe këto nuk ishin bërë sipas Udhëzimit përkatës.¹

Në të njëjtën kohë, studimi thekson nevojën për ndërgjegjësimin e strukturave si Bordi i shkollës, për rolin që duhet të kenë sipas ligjit të ri.² Monitorimi i vitit 2013, i mbështetur nga OSFA në 10 shkolla të arsimit parauniversitar në qytetet e Tiranës, Elbasanit dhe Durrësit arriti në përfundimet se niveli i informacionit për ligjin e ri dhe kërkesat që rrjedhin prej tij ishte shumë i ulët, dhe se gjatë vitit 2012-2013 emërimet dhe largimet e personelit arsimor nuk ishin bërë në asnjë rast në përputhje me kërkesat e ligjit të ri. Gjithashtu në drejtim të strukturave të shkollës, u vu re se nuk

ishin zhvilluar zgjedhje të fshehta për krijimin e Bordeve të shkollës, se Këshillat e Prindërve ekzistonin formalisht dhe jo realisht, ndërkohë që aftësia vetëorganizuese e strukturës së Qeverisë së Nxënësve u vlerësua e ulët. Ndërkohë nga monitorimi nuk u evidentua ngritja e strukturave të parashikuara në ligj si: Komisionet e Etikës apo Komisioneve Vendore dhe Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.³

Përsa i takon politikës arsimore të Altertekstit, Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” ka vënë në dukje prej disa vitesh tashmë nevojën për përmirësimin e mëtejshëm të reformës. Një analizë krahasimore ndër vite 2010-2012 evidentoj se pjesëmarrja e prindërve nuk ishte një pikë e fortë e procesit: ata ishin përfshirë në numër shumë të pakët. Rekomandimi i Fondacionit për të rritur përfaqësimin e prindërve në komisionet e vlerësimit të teksteve me 30%, ishte marrë parasysh vetëm pjesërisht, në 2012, pasi prindërit ishin lejuar të ishin pjesë e këtyre komisioneve pa të drejtë vote.⁴

Në këtë kontekst, projekti i OSFA synon të kontribuojë pikërisht në rritjen e informimit të komunitetit të shkollës për procedurat e sakta ligjore dhe rolin që duhet të luajë në vendimmarrjen e shkollës, ashtu siç parashikohet në legjisllacion. Megjithëse është ende herët për të pritur efektivitetin e zbatimit të politikave deri në nivel shkolle, Fondacioni është i interesuar të evidentojë gjendjen aktuale. Në të njëjtën kohë monitorimi pati si qëllim nxitjen dhe aktivizimin e strukturave të shkollës dhe komuniteteve për çështjet e eviden-

1 Udhëzimi Nr. 57, datë 12. 11.2013, “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të Arsimit Parauniversitar”, Kreu 1, Pika c.

2 Shoqata e Prindërve të Tiranës. (2014). Raport vlerësimi i monitorimit të zgjedhjes së drejtorëve të shkollave në qytetin e Tiranës.

3 Fondacioni «Shoqëria e Hapur për Shqipërinë». (2013). Monitorimi i Ligjit të Arsimit Parauniversitar: Strukturat e ngritura brenda shkolle.

4 Fondacioni «Shoqëria e Hapur për Shqipërinë». (2012). Raport monitorimi Altertekst 2012.

tuara. Për këtë arsye, pjesë e ndërhyrjes do të jetë jo vetëm vlerësimi i zbatimit të këtyre politikave, por mbi të gjitha, ofrimi i të dhënave për të ndihmuar përcaktimin e prioriteteve për përbushjen e të cilave do të nxitet angazhimi i komunitetit shkollor.

Në vetvete më tepër një kërkim veprues sesa një kërkim tradicional, studimi i paraqitur këtu i shton vlerë argumenteve të studimeve të deritanishme për angazhimin qytetar në arsim dhe njëkohësisht sjell disa risi pasi: paraqet situatën pas dy vjetësh të hyrjes në fuqi të ligjit të arsimit parauniversitar dhe udhëzimeve përkatëse. Studimi hulumton në veçanti aspekte që janë të rëndësishme në procesin e mobilizimit të komunitetit si: besimi që kanë tek njëri-tjetri anëtarët e komunitetit të shkollës, qëndrimet e tyre kundrejt aktorëve të tjerë të përfshirë në vendimmarrjen në arsim, perceptimi për angazhimin dhe rolin që duhet të luajnë. Së fundi, ashtu sikur u përmend, studimi ofron argumentet për çështjet ku duhet të ndërhyhet më së pari dhe një vështrim në faktorët që duhet të cekën për të pritur dhe nxitur ndryshimin.

1.2 Objektivat e studimit

Në përputhje me qëllimin e projektit, studimi synoi:

- Të evidentojë opinionet e nxënësve, prindërve dhe mësuesve lidhur me zbatimin e politikave arsimore.
- Të evidentojë anët pozitive dhe problemet lidhur me zbatimin e politikave arsimore të përfshira në studim.
- Të ofrojë rekomandime lidhur me përmirësimin e zbatimit të politikave arsimore të analizuar në studim.

1.3 Çështjet kryesore kërkimore

Në bazën e këtij studimi ishin këto çështje:

- *Çështja kërkimore nr 1:* Në ç'përmasë ndodh përfshirja e prindërve, mësuesve dhe nxënësve në vendimmarrjen e shkollës?
- *Çështja kërkimore nr 2:* Në ç'përmasë ndodh përfaqësimi i prindërve dhe nxënësve në strukturat e shkollës?
- *Çështja kërkimore nr 3:* Cili është potenciali e prindërve për t'u organizuar dhe ndikuar në vendimmarrjen e shkollës?
- *Çështja kërkimore nr 3:* Cili është konteksti ku studiojnë nxënësit?



KAPITULLI II

Metodologjia

Në këtë kapitull, përshkruhet strategjia e kërkimit, metodat, teknikat e kampionimit, mbledhjes dhe analizës së të dhënave, sfidat dhe aspektet etike të studimit. Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të përshkruara në kapitullin 'Hyrje', u përdor metodologjia mikse, e cial kombinon metodat sasiore (sondazhet) me metodat cilësore (intervistat e thelluara në grup) të kërkimit shkencor. Për të rritur vlefshmërinë e gjetjeve të studimit, u përdor metoda e triangulimit të të dhënave, e cila përfshiu triangulimin metodologjik dhe triangulimin e burimeve (siç shpjegohet më poshtë). Intervistat e strukturuar (sondazhet) u zhvilluan në terren me prindër të nxënësve me mësues në shkollat e arsimit parauniversitar, ndërsa sondazhi me nxënës 15-18 vjeç u zhvillua online. Intervistat e thelluara u zhvilluan në 25 grupe të ndara në tri kategori: nxënës, mësues dhe prindër.

2.1 Kampioni dhe kampionimi

Kampioni i prindërve

Për sondazhin me prindër, është përdorur një kampionim i dizenuar në disa nivele. Madhësia e kampionit është 1250 prindër banorë të Tiranës, Elbasanit, Durrësit, Korçës dhe Kukësit. Përzgjedhja e këtyre qyteteve është bërë për shkak të qëllimit të këtij projekti për të mobilizuar komunitet shkollorë në këto qytete.

- Hapi i parë i kampionimit ishte caktimi i numrit të intervistave të strukturuar (N=1200) sipas qyteteve. Ky numër u caktua në proporcion me popullatën e votuesve të qytetit.⁵ Për zonën e Kukësit, duke qenë se rezultoi një numër i vogël intervistash, u shtuan edhe një numër prej 50 intervistash për të pasur një mbulim më të mirë. Shpërndarja e 1250 intervistave sipas qyteteve ishte si më poshtë (Tabela 1):

Tabela 1. Shpërndarja e intervistave me prindër sipas qyteteve

Bashkia	Numri i intervistave
Tiranë	714
Durrës	224
Elbasan	137
Korçë	101
Kukës	74

- Njësia parësore e kampionimit ishin banesat (banesa private, apartamente në pallat, kasolle/barake), të cilat ishin të paracaktuara nga hartat me pikëzim rastësor. U ndërtua

⁵ Bazuar në listën e votuesve publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zgjedhjet kombëtare në 2013. Për zonat me përqindje të vogël banorësh, janë shtuar edhe 50 intervista për të pasur një mbulim më të plotë të zonës.

spiralja e pikave mbi godina në mënyrë të barazlartuar për të siguruar një shpërndarje gjeografike gjithëpërfshirëse.

- Njësia e fundme e kampionimit ishin prindërit ose kujdestari i fëmijës i cili ishte më i përfshirë me shkollën e fëmijës. Për të marrë pjesë në intervistë personi duhej të ishte një prej personave madhor në familje që ndjek arsimimin e fëmijës, pra që mban lidhje me shkollën. Në pjesën më të madhe të rasteve (75%) ky person ishte nëna (Tabela 2).

Tabela 2. Personi i intervistuar në sondazhin me prindër

	Shpeshtësia	Përqindja
Nëna	921	75.3
Babai	196	16.0
Gjyshe	65	5.3
Gjysh	17	1.4
Motra	18	1.5
Tjetër (xhaxhai, vëllai, halla)	6	0.5
Total	1223	100.0

Kampioni i mësuesve

Për sondazhin me mësues, u përdor gjithashtu një kampion i dizenuar në disa nivele. Madhësia e kampionit është 1200 mësues (1190 pas filtrimit të intervistave), të cilët japin mësim në shkolla të arsimit parauniversitar në qytetet e Tiranës, Elbasanit, Durrësit, Korçës dhe Kukësit. Si njësi parësore kampionimi shërbyen shkollat e këtyre qyteteve, ndërkohë që njësia e fundme e kampionimit ishin mësuesit që japin mësim pranë këtyre shkollave.

Caktimi i kampionit në secilën shkollë u krye sipas hapave të mëposhtëm:

- U llogarit numri i kampionit të mësuesve për çdo nivel shkollë me anë të formulës $sh_n/sh_t * 100 * 1200$, ku sh_n – numri i shkollave brenda një niveli në pesë qytetet dhe sh_t – numri

total i shkollave në pesë qytetet;

- U llogarit numri i intervistave për çdo nivel shkollë në çdo qytet me anë të formulës $sh_{nq}/sh_n * 100 * i_n$, ku sh_{nq} – numri i shkollave të një niveli brenda në qytet, sh_n – numri i shkollave brenda një niveli në pesë qytetet dhe i_n – numri i intervistave brenda atij niveli. Numri më i lartë i intervistave të caktuara në një shkollë ishte 21 dhe më i ulët 7.
- Duke qenë se numri total i shkollave përbënte census, u mendua të përzgjidhej një në çdo dy shkolla duke i renditur brenda të njëjtit nivel në rend alfabetik. U llogarit numri i kampionit të shkollave për çdo qytet me anë të formulës $sh_{nq}/2$ ku sh_{nq} – numri i shkollave sipas nivelit dhe qytetit. Në rastet kur brenda atij niveli ishte vetëm një shkollë, atëherë kjo shkollë është zgjedhur në kampion. Në fund, kampioni i studimit u përbë nga 93 shkolla.
- Numri i intervistave për çdo shkollë u llogarit duke pjesëtuar numrin e intervistave të planifikuara për tu zhvilluar brenda një tipi shkollë në qytet (e.g. intervista për tu zhvilluar në shkollat e mesme të përgjithshme), me numrin e shkollave që janë pjesë e kampionit për atë qytet (e.g. shkolla të mesme të përgjithshme për tu studiuar në qytet)..
- U zgjedhën shkollat në mënyrë rastësore nga lista zyrtare e shkollave publike dhe jo publike e vitit shkollor 2013-2014.⁶

Kampioni i nxënësve

Kampioni në sondazhin online me nxënës është 1177 nxënës, të grupmoshës 15 deri në 19 vjeç, që deklarojnë se jetojnë në Shqipëri.

Baza e të dhënave nga sondazhi me nxënës rezultoi në një numër të lartë vlerash të munguara

⁶ Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, 2014.

për shkak të mospërgjigjes nga respondentët. Një arsye për këtë është fakti që sondazhi është vetëadministruar online nga nxënësit, duke u dhënë atyre lirinë të mos përgjigjen për pyetjet apo ta ndërpresin pyetësorin pa e plotësuar deri në fund. Numri i pyetësorëve të regjistruar, të përfunduar ose jo, ishte 2328. Pas filtrimit, numri i pyetësorëve të vlefshëm rezultoi 1177. Rezultatet e testit të Little për vlerat e munguara në mënyrë tërësisht rastësore (*Little's MCAR test*) treguan se vlerat nuk mungonin në mënyrë rastësore ($p < 0.05$). Për këtë arsye, u përdor metoda e *multiple imputation* (gjenerimit të shumëfishtë të të dhënave për të plotësuar databazën).

Pjesëmarrësit në intervistat në grup

Në intervistat në grup morën pjesë rreth 150 mësues nga Tirana, Durrësi, Kukësi, Elbasani dhe Korça. Përzgjedhja e pjesëmarrësve është bërë si pasojë e bashkëpunimit midis studiuesve dhe koordinatorëve lokal të këtij projekti. Në fillim studiuesit përgatitën profilet e kërkuara për çdo pjesëmarrës dhe ia dërguan këtë koordinatorëve. Më pas, këta të fundit propozuan tek studiuesit një listë emërore me të paktën dy kandidatura për çdo profil të kërkuar. Pasi studiuesit bënë përzgjedhjen e pjesëmarrësve që i përshtateshin më shumë profileve të kërkuara, koordinatorët ftuan pjesëmarrësit në intervistat në grup.

Në hartimin e profileve u mbajtën parasysh disa kriteret: Për nxënësit u kërkuar që të ishin të grupmoshës 16-19 vjeç, të kishte një përfaqësim të barabartë midis dy gjinive, si dhe performanca në mësim (i.e. nxënës me nota të larta dhe me nota të ulta).

Për mësuesit u kërkuar që të kishte një përfaqësim të barabartë midis dy gjinive, midis mësuesve me përvojë të gjatë në mësimdhënie (mbi 10 vjet) dhe mësuesve të rinj, llojit dhe vendndodhjes së

shkollës (i.e. shkollë në periferi apo në qendër; dhe shkollë e përgjithshme apo profesionale), si edhe midis fushave lëndore që mësuesit japin mësim (i.e. shoqërore ose natyrore).

Për prindërit u kërkuar që të kishte një përfaqësim të barabartë midis dy gjinive, moshës së tyre (i.e. nën apo mbi 40 vjeç), vendbanimit (i.e. rural apo urban), statusi i punësimit (i.e. i vetëpunësuar, sipërmarrës, i punësuar, shtëpiak, pensionist), si dhe nivelit të arsimit apo lloji i shkollës që ndjek fëmija (i.e. arsimit nëntëvjeçar apo i mesëm; dhe arsim i përgjithshëm apo profesional).

Ky diversitet i pjesëmarrësve në intervista në grup u synua me qëllim që të kontrollohej efekti i variablave të ndryshëm në përgjigjet e dhëna, por edhe për të marrë një informacion sa më të gjerë dhe sa më të plotë mbi çështjet e diskutuara.

Mbledhja e të dhënave

Procesi i mbledhjes së të dhënave sasiore në terren u zhvillua në disa faza: gjatë muajve korrik-gusht 2013 u mbledhën të dhëna përmes sondazhit me prindër, gjatë muajit tetor 2013 u mbledhën të dhëna përmes sondazhit me mësues, dhe gjatë muajve nëntor-dhjetor 2013 për sondazhin me nxënës.

Në sondazhin me prindër, përcaktimi i banesës ku do të zhvillohej intervista bëhej me anën e sistemit GPS. Intervista me prindin ose kujdestarin që ishte më pranë çështjeve të shkollës zhvillohej në mjediset e shtëpisë. Në sondazhin me mësues, intervistat janë kryer në ambientet e shkollës ose të oborrit të shkollës, gjatë kohës së pushimit të gjatë ose të orëve që mësuesit ishin të lirë. Regjistrimi i të dhënave nga sondazhet në terren është bërë nga intervistuesit, në programin e instaluar në tableta dhe programi ka mundësu-

ar transferimin e të dhënave nga tableti në data-bazë në kohë reale, përmes internetit.

Në sondazhin online me nxënës, për të ftuar respondentët në plotësimin e pyetësorit online janë përdorur reklama në rrjetet sociale (i.e. Facebook Ads). Reklama online ofron *tools* të cilat mundësojnë përzgjedhjen e grupit të cilit do t'i shfaqej reklama, në bazë të vendndodhjes dhe moshës që respondentit ka deklaruar në profilin e tij në Facebook. Gjithashtu edhe në pyetësor respondentit kërkohet të deklaronte moshëndhe nëse ai deklaronte një moshë jashtë grupmoshës së synuar (15 – 19 vjeç) ai përjashtohet nga sondazhi në mënyrë automatike dhe nuk lejohej rifutja e tij në pyetësor. Gjithashtu nga një pajisje kompjuterike nuk mund të plotësohej më shumë se një pyetësor për shkak të filtrimit me anë të Protokollit të Internetit (IP⁷). Megjithatë respondentit mund t'i rikthehej në çdo kohë një pyetësori të papërfunduar dhe ta korigjonte atë, për sa kohë ai ende nuk e kishte përfunduar pyetësorin duke klikuar *Dërgo*.

Për mbledhjen e të dhënave cilësore u organizuan 26 intervista në grup në pesë qytetet e studimit. Pjesëmarrësit u identifikuan nga koordinatorët e OSFA në qytete. Grupet u zhvilluan në ambiente jashtë shkolle, në mënyrë që të shmangej ndikimi i drejtorit të shkollës në përgjigjet e pjesëmarrësve. Intervistat u kryhen gjatë periudhës tetor – nëntor 2014, dhe kohëzgjatja e tyre mesatare ishte 1 orë e 30 minuta.

⁷ IP – Internet Protocol shërben për të identifikuar përdoruesin e internetit dhe vendndodhjen e tij.

2.2 Instrumentet

Për të ndërtuar instrumentet sasimore dhe cilësore të kërkimit ekipi u bazua në rishikimin e studimeve të mëparshme dhe literaturës ekzistuese për kërkimin shkencor. Në veçanti rishikimi i studimeve të mbështetura nga Fondacioni OSFA shërbeu për të pasuruar, ndryshuar dhe përshtatur listën e variablave dhe treguesve. Pyetjet e ndërtuara si matje për variablat e interesuar u vlerësuan nga grupi i ekspertëve për qartësinë e termave dhe përshtatshmërinë me kontekstin. Disa nga variablat në sondazhet e prindërve dhe mësuesve (si ato të lidhura me besimin dhe solidaritetin, veprimin e përbashkët dhe bashkëpunimin) janë përshtatur duke u bazuar në *Integrated Questionnaire for the Measurement of Social Capital (INQUESOC)*, një instrument i përdorur nga OECD për të matur aspekte të kapitalit social në vendet në zhvillim.

Të gjithë instrumentet u pilotuan përpara se të përdreshin për mbledhjen e të dhënave.

Instrumentet sasimore

Instrumentet e studimit sasior ishin a) pyetësori i përdorur në sondazhin me prindërit; b) pyetësori i përdorur në sondazhin me mësuesit dhe c) pyetësori online i plotësuar nga nxënësit. *Pyetësori për prindërit* ndërtohet nga 113 pyetje, të cilat masin variabla kategorikë dhe të vazhdueshëm. Ai jep të dhëna për katër pyetjet kërkimore, dhe është i ndarë në katër seksione: 1) përfaqësimi i prindërve në vendimmarrjen e shkollës (në politikën e altermekstit dhe të emërimit/shkarkimit të personelit arsimor); 2) përfaqësimi i komunitetit të shkollës në strukturat e saj; 3) potenciali i prindërve për t'u organizuar dhe ndikuar në shkollë; dhe 4) konteksti social ku jeton fëmija. *Pyetësori për mësuesit* përbëhet nga 78 pyetje të

cilat gjithashtu u përgjigjen tri pyetjeve të para të kërkimit.. Në dallim nga pyetësi i prindërve, pyetësi i mësuesve përmban pyetje edhe për përfshirjen e vetë mësuesve në vendimmarrje. *Pyetësi për nxënësit* përbëhet nga 50 pyetje të cilat japin kryesisht informacion për kontekstin social ku jeton nxënësi, si edhe për përfaqësimin e komunitetit të shkollës dhe funksionimin e strukturave të saj.

Instrumentet cilësore

Instrumentet cilësore që u përdorën ishin: a) guida e intervistave në grup me prindër; b) guida e intervistave në grup me mësues; dhe c) guida e intervistave në grup me nxënë. Çështjet e eksploruara në këto intervista gjysëm të strukturuar përqëndroheshin tek politika e përfaqësimi të prindërve dhe mësuesve në emërimin apo shkarkimin e personelit arsimor; përfaqësimi i prindërve në strukturat e shkollës dhe potenciali i prindërve për të advokuar. Duke qenë se këto intervista u zhvilluan pas sondazheve me prindër dhe nxënë, gjetjet paraprahe të sondazheve u përdorën si bazë për formulimin e pyetjeve të guidave, me qëllim që të evidentoheshin në thellësi problematika të evidentuara gjatë sondazheve

2.3. Besueshmëria dhe vlefshmëria e të dhënave

Vlefshmëria dhe besueshmëria e gjetjeve janë të lidhura ngushtësisht me njëra – tjetrën, për sa kohë disa gjetje nuk janë të besueshme ato nuk janë as të vlefshme.

Që të ruhet qëndrueshmëria e brendshme e instrumenteve të studimit, gjatë hartimit të tyre është bërë kujdes që të ketë përpuethshmëri mes koncepteve të matura nga instrumenti. Shkalla e besueshmërisë së instrumenteve (i.e. pyetësorët)

të përdorura gjatë sondazheve, bazuar në testin e qëndrueshmërisë së brendshme për shkallët matëse rezultoi e pranueshme dhe e lartë. Koefficienti i *Cronbach's alpha* për shkallët matëse në pyetësorin e mësuesve ishte 0.739, në pyetësorin e prindërve 0.756, dhe në pyetësorin e nxënësve 0.640. Një koeficient i tillë vlerësohet si tepër i lartë dhe konfirmon një qëndrueshmëri të brendshme të instrumenteve. Instrumentet sigurojnë gjithashtu vlefshmëri konverguese për shkak të korrelacionit domethënës midis matjeve të përdorura. Ndërkohë gabueshmëria e gjetjeve të sondazhit llogaritet +/- 3%,

Për të rritur shkallën e vlefshmërisë së gjetjeve, janë përdorur teknika e triangulimit të të dhënave, si dhe teknika e vlerësimit prej pjesëmarrësve në studim (alias respondent validation). Së pari, teknika e triangulimit të të dhënave, ka përfshirë triangulimin metodologjik dhe triangulimin e burimeve. Triangulimi metodologjik është arritur duke matur të njëjtat koncepte me metoda të ndryshme (i.e. sasore dhe cilësore), ndërsa triangulimi i burimeve është arritur duke përballur informacionin e përfutur prej burimeve të ndryshme (i.e. prindërve, nxënësve, mësuesve).

Së dyti, teknika e vlerësimit prej pjesëmarrësve, është siguruar duke organizuar tryeza diskutimi në të pesë qytetet ku është zhvilluar studimi. Për këtë qëllim, gjatë muajit Dhjetor 2014 janë zhvilluar 15 tryeza ku morën pjesë në total rreth 300 mësues, nxënë dhe prindër nga Tirana, Durrësi, Kukësi, Elbasani dhe Korça. Pjesëmarrësve u janë paraqitur gjetjet e studimit dhe është diskutuar me ta nëse ata mendojnë se këto gjetje përshkruajnë realitetin që ata njohin. Duke qenë se një pjesë e madhe e pjesëmarrësve nëpër këto takime kishin marrë pjesë edhe në studim, ata patën mundësi të jepnin *feedback* nëse gjetjet

korrespondonin me atë që ata kishin kontribuar në studim. Këto takime shërbyen gjithashtu edhe për të identifikuar disa keqkuptime gjatë interpretimit të gjetjeve, si dhe identifikuan disa kufizime në studim, të cilat janë pasqyruar në seksionin e mëposhtëm.

Së fundmi, duhet sqaruar se vlefshmëria dhe besueshmëria e të dhënave lidhen me forcën përfaqësuese të gjetjeve. Megjithëse këto gjetje jo domosdoshmërisht përfaqësojnë situatën e të gjithë popullatës së prindërve, ato përfaqësojnë me një shkallë të lartë besueshmërie situatën e shkollave dhe qëndrimet e komuniteteve shkollore në pesë qytetet ku është shtrirë studimi.

2.4 Analiza e të dhënave

Të dhënat cilësore u analizuan në disa faza. Në fillim u zbardhën rreth 30 orë intervista në grup. Më pas u ndërtua një listë me kode bazuar në pyetjet kërkimore si dhe tematikat që u synuan të eksplorohehen gjatë këtij studimi. Për të eliminuar diferencat në interpretimin e të dhënave, u punua me kujdes midis studiuesve gjatë hartimit të kodeve si dhe interpretimin e tyre. Të dhënat sasiore u kontrolluan për të evidentuar rastet e korrelimeve, apo rastet kur të dhënat sugjerorin gjetje kontradiktore. Në çdo rast përballaj e të dhënave të përfuara përmes sondazheve me intervistat e thelluara, ishte tepër e vlefshme për të kuptuar në thellësi fenomenin në fjalë, dhe për ta interpretuar drejt atë. Për çështje të cilat mbeteshin të paqarta nga sondazhet e zhvilluara, u eksplorimi në thellësi përgjatë intervistave të thelluara në grup.

Të dhënat janë analizuar me ndihmën programeve profesionale si *IBM SPSS Statistics 20*, *NVivo 10* dhe *AudioNote*.

2.5 Kufizime dhe sfidat e studimit

Sondazhet mbartin në vetvete kufizimin që përvojën vetjake dhe subjektive të respondentëve e konvertojnë në vlera sasiore, çka mund të shoqërohet me gabimin e gjykimit subjektiv.

Ndërkohë, siç u shpjegua edhe më lart, ndryshe nga sondazhet me prindër dhe mësues ku pyetjet u lexuan prej intervistuesve, në rastin e nxënësve formulari u plotësua vetë prej tyre (pa ndihmën e një intervistuesi). Për pasojë mund të ketë ndodhur që ata të kenë hasur vështirësi në kuptimin e plotë të pyetjeve të pyetësorit. Gjithashtu, duke patur shqetësimin që pyetësori të mos bëhej shumë i gjatë, pasi kështu mund të rritej numri i refuzimeve, nuk u arrit të eksplorohehin të gjitha variablat e dëshiruara prej studiuesve. Për shembull konteksti familjar nuk u eksploru në tërësinë e tij. Gjithashtu kampioni i respondentëve të pyetësorit online, mund të mos ketë përfaqësuar plotësisht atë kategori të nxënësve që nuk kanë akses në internet apo që nuk janë përdorues të Facebook. Së fundmi, duke qenë se sondazhi online është bazuar mbi pjesëmarrjen vullnetare të nxënësve (dhe jo të përzgjedhjen e tyre rastësore prej intervistuesit), kampioni mund të ketë prirje që të përfaqësojë opinionet e atyre që janë më të motivuar për të marrë pjesë në studime të tilla.

Kufizime studimi mund të ketë hasur edhe në procesin e mbledhjes së të dhënave në terren, ku në sondazhin me mësues në disa raste intervistuesit ishin të detyruar të zhvillonin intervistat me mësuesit në një ambient brenda shkollës ku ishin të pranishëm edhe të tjerë (stafi i shkollës). Apo në raste të tjera intervista është zhvilluar me dijeni të drejtorit të shkollës, çka mund ta ketë bërë mësuesin të mendojë se përgjigjet e intervistës mund të mësohen prej drejtorit. Këto elementë mund të kenë ndikuar objektivitetin e

përgjigjeve të dhëna nga mësuesit, sidomos në rastet kur kërkohen opinione apo qëndrime që lidhen me shkollën dhe administrimin e saj.

Koha dhe vendi i zhvillimit të studimit mund të paraqesë gjithashtu ndikimi në gjetjet e studimit. Së pari studimi është zhvilluar vetëm në pesë qytete të shqipërisë, të cilat edhe pse përfaqësojnë pjesën më të madhe të popullsisë, sërish shfaqin një kufizim përsa i përket përfaqësueshmërisë së kampionit. Ndërkohë zhvillimet politike gjatë vitit 2014, kohë kur janë mbledhur edhe të dhënat në terren, gjithashtu mund të kenë luajtur një rol duke ndikuar në përgjigjet e pjesëmarrësve në studim.

Së fundmi, të dy studiuesit janë me shkollë të lartë, vijnë nga një formim në shkencat sociale, punojnë si pedagogë në universitet, dhe jetojnë në Tiranë. Statusi dhe kushtet e tyre sociale dhe ekonomike mund të kufizojnë interpretimin e gjetjeve nga lentet e një vëzhguesi që nuk ndan të njëjtat vështirësi me individin e disavantazhuar në shoqëri.

Pavarësisht kufizimeve të mësipërme, për shkak të përmasave të kampioneve të studiuara, studimi ka një marzh gabimi të ulët, që siguron vlefshmërinë e matjeve. Në të njëjtën kohë, triangulimi metodologjik dhe triangulimi i burimeve rrit vlefshmërinë dhe besueshmërinë e gjetjeve.

Së fundmi, duke pasur parasysh se përfaqësimi i komunitetit të shkollës dhe funksionimi i strukturave të saj janë çështje që po gjejnë terren me vështirësi në kontekstin arsimor shqiptar, është e nevojshme që në studimet e ardhshme, t'i lihet më shumë hapësirë dimensionit të kapitalit social, i cili hulumton arsyet përse mospërfshirja e komunitetit i reziston kohës.

2.6 Etika e studimit

Duke qenë se në Shqipëri ende nuk ka një Kod Etike për kërkimin shkencor, ky studim është hartuar në përputhje me disa kode etike dhe rregullore që përdoren nga organizatat e studiuesve në Bashkimin Evropian, Angli dhe SHBA (BERA, 2011; AERA, 2011; ESCR, 2012). Gjithashtu gjatë fazës së mbledhjes dhe analizimit të të dhënave janë respektuar dispozitat e ligjit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale (2008).

Është bërë kujdes prej studiuesve që instrumentet e përdorura në studim të mos përbënin risk për pjesëmarrësit. Çdo pjesëmarrës në studim është informuar tërësisht për studimin, qëllimin dhe përdorimin e tij. Çdo pjesëmarrës ka firmosur një letër pranimit përpara se të merrte pjesë në studim. Në rastet kur pjesëmarrësit kanë qenë nën 18 vjeç (i.e. nxënësit) pjesëmarrja është bërë vetëm pasi prindi është njoftuar tërësisht për studimin dhe ka nënshkruar letrën e pranimit. Nxënës nën 16 vjeç nuk janë pranuar në studim. Në rastin e sondazhit online me nxënës, asnjë respondent nuk është lejuar të vazhdojë pyetësorin nëse nuk deklaronte se ishte të paktën 16 vjeç dhe po e plotësonte pyetësorin në prani të prindit apo një kujdestari ligjor.

Të dhënat nga sondazhet dhe intervistat në grup u mbledhën dhe u administruan në mënyrë konfidenciale dhe tërësisht anonime. Çdo instrument i përdorur në këtë studim për mbledhjen e të dhënave është hartuar duke mbajtur parasysh respektimin e të drejtës për privatësi të çdo pjesëmarrësi në studim. Të gjithë pjesëmarrësit në studim – si në sondazhe, edhe në intervistat në grup – janë informuar për të drejtën e tyre që të refuzojnë pjesëmarrjen në studim, apo të tërhiqen prej tij në çdo kohë, pa qenë nevoja ta justifikojnë vendimin e tyre. Janë marrë masa që një e drejtë e tillë t'i garantohet çdo pjesëmarrësi në këtë studim.

KAPITULLI III

Rezultatet



Në këtë kapitull, paraqiten gjetjet nga sondazhet dhe nga intervistat në grup me prindër, mësues dhe nxënës. Numri i intervistave të vlefshme të cilat u morën parasysht për analizën ishte 1223 për sondazhin me prindër, 1190 për sondazhin me mësues dhe 1177 për sondazhin me nxënës. Gjetjet sasiore për çdo grup pjesëmarrës në studim janë mbështetur dhe plotësuar nga gjetjet cilësore dhe janë organizuar sipas çështjeve kryesore dhe nënçështjeve të studimit. Paraqitja e gjetjeve është kryer duke pasur parasysht se ato do të përdoren për informimin e procesit të debatit dhe të pjesëmarrjes së komunitetit në shkollë, pra do të ketë si audiencë lexuesish jo vetëm politikëbërësit dhe studiuesit, por edhe strukturat e shkollës, mësuesit, nxënësit, prindërit dhe komunitetin.

3.1. Pjesëmarrja e prindërve, mësuesve dhe nxënësve në jetën e shkollës

Çështja e parë që studimi përpiqet t'i japë përgjigje ishte se në ç'përmasa ndodh përfshirja e prindërve, mësuesve dhe nxënësve në vendimmarrjen e shkollës. Kjo çështje përmbante nënçështje të tilla si: përfshirja e strukturave në përzgjedhjen e teksteve shkollë si edhe në emërimin/shkarkimin e personelit arsimor. Prindërit, mësuesit dhe nxënësit janë pyetur gjithashtu për cilësinë e teksteve të shkollës.

3.1.1 Vlerësimi për cilësinë e teksteve shkollë Si i vlerësojnë prindërit tekstat?

Pjesa më e madhe e prindërve (67%) i vlerësuuan “deri diku të mirë” tekstat me të cilat mësuan fëmijët e tyre. 15% e tyre i vlerësuan tekstat “shumë të mirë” (Tabela 3).

Tabela 3. Mendimi i prindërve për tekstat shkollë

	Shpeshësia	Përqindja
Shumë të dobët	65	5.5
Të dobët	150	12.8
Deri diku të mirë	783	66.6
Shumë të mirë	178	15.1
Total	1176	100.0

Shkalla e arsimimit të prindërve kishte ndikim domethënës statistikor: sa më të arsimuar, aq më të prirur ishin prindërit për të vlerësuar tekstat si të dobët ($\chi^2(20) = 45.881, p < 0.05$).⁸ Informimi apo edhe pjesëmarrja në procesin

⁸ Kjo është mënyra e paraqitjes së rezultateve nga testi statistikor i chi-square për pavarësinë ndërmjet variablove, i cili mat lidhjen ndërmjet variablove (ndryshoreve) kategorike (nominale). χ^2 është konvencion i këtij testi. Në kllapa vendoset 'shkalla e lirisë', ose ndryshe numri i vlerave që lejohet të variojë në llogaritjen përfundimtare të testit, që na shërben të gjykojmë për ndryshueshmërinë (variabilitetin) brenda kampionit në fjalë; p është niveli i koeficientit alpha, kriteri apriori që tregon probabilitetin e hedhjes poshtë në mënyrë të gabuar të hipotezës zero. Ky koeficient është .05 ose .01.

e përzgjedhjes së teksteve nuk rezultoi në një lidhje domethënëse me vlerësimin e prindërve për tekstet. Kjo gjetje mbështet arsyetimin se prindërit thellë-thellë nuk besojnë tek rëndësia e pjesëmarrjes apo informimit të tyre për procesin e përzgjedhjes së teksteve. Kjo mund të vijë për disa arsye: së pari, siç tregojnë gjetjet më poshtë, mësuesit gjithashtu nuk kanë besim tek fakti se prindërit janë të rëndësishëm në këtë proces dhe kjo mund të shkurajojë prindërit. Një arsye tjetër është se prindërve mund t'u mungojë besimi tek ekspertiza për të vlerësuar tekstin shkollor. Gjithashtu, siç do të tregojnë më poshtë, pjesa më e madhe e prindërve që kanë marrë pjesë në KPT janë zgjedhur nga mësuesit dhe drejtuesi, pra zgjedhja e tyre nuk është bazuar në respekt të procedurave. Është raportuar shpesh në intervistat në grup por edhe në sondazhe (gjatë pyetjeve të hapura) se prindërit që janë zgjedhur në struktura, janë ata që priren të favorizojnë zgjedhjet e drejtuesit të shkollës dhe mësuesit që i ka zgjedhur. Këta faktorë mund të ndikojë gatishmërinë e prindërve për t'u përfshirë dhe kontribuar në proces dhe duhen pasur parasysh gjatë zgjedhjes së prindërve në Komisionet e Përzgjedhjes së Teksteve.

Si i vlerësojnë mësuesit tekstet?

Në përgjithësi, mësuesit i vlerësuan tekstet e lëndëve që japin mësim 'deri diku të mira' (60%) dhe 'shumë të mira' (31%). Është interesante që 18% e prindërve kundrejt vetëm 3% e mësuesve të cilët janë gjithashtu prindër nxënësish, i vlerësojnë tekstet e lëndës si "shumë të dobta" dhe "të dobta". U vu re gjithashtu se mësuesit të cilët ishin prindër nxënësish, ishin më të prirur të vlerësonin shumë mirë tekstet e shkollës së tyre (30%) sesa tekstet e shkollës së fëmijëve të tyre (20.5%). Megjithatë, krahasimet nuk mund

të jenë ekuivalente, pasi në njërin pyetje mësuesit vlerësuan tekstet për *lëndën që ata japin mësim* ku pritet të kenë përgjegjësi në përzgjedhje. Ndërkohë të pyetur për tekstet e fëmijës së tyre, ata janë përgjigjur për cilësinë e teksteve të shkollës *në përgjithësi*, çka mund të ketë ndikuar në vlerësim më të ulët. Krahasimet brenda për-brenda grupit të mësuesve jepen tek Tabela 4.

Mësuesit të cilët janë prindër nxënësish ishin disi më të prirur se mësuesit që nuk kanë fëmijë në shkollë për të vlerësuar tekstet e lëndës së tyre si 'deri diku të mirë' dhe më pak të prirur për t'i vlerësuar tekstet si të dobët dhe shumë të dobët ($\chi^2(3) = 8.154, p < 0.05$).

Këto gjetje tregojnë se të qenit prind vetë, e ndikon mënyrën se si arsyeton mësuesi. Kjo nuk do të thotë se vlerësimi i tyre për tekstet është më objektiv, por që është i ndryshëm nga ai i prindërve në përgjithësi apo i mësuesve që s'kanë fëmijë në shkollë. Faktori brenda këtij grupi është dukshëm i ndryshëm krahasuar me grupet e tjera pasi mësuesit që janë prindër nxënësish duhet të mbartin këto dy role me vete: edhe të ofruesit të shërbimit, edhe të përfituesit të shërbimit, pra i ndërthurin të dy këndvështrimet në vlerësimin e tyre. Kjo mund të jetë me interes në situatat e përzgjedhjes së mësuesve në Komisionet e Përzgjedhjes së Teksteve.

Tabela 4. Vlerësimi i mësuesve për tekstet shkollore

	Vlerësimi i të gjithë mësuesve për tekstet e lëndës që japin mësim	Vlerësimi i mësuesve prindër për tekstet e lëndës që japin mësim	Vlerësimi i mësuesve pa fëmijë në arsimin parauniversitar për tekstet e lëndës që japin mësim	Vlerësimi i mësuesve prindër për tekstet e fëmijës së tyre
	Përqindja	Përqindja	Përqindja	Përqindja
Shumë të dobët	2.0	1.5	2.5	.4
Të dobët	3.1	1.8	4.2	3.5
Deri diku të mirë	62.7	65.5	60.2	75.1
Shumë të mirë	32.2	31.2	33.1	21.0
Total	100.0	100.0	100.0	100.0


Fusha lëndore kishte lidhje me vlerësimin që mësuesit u bënë teksteve të asaj fushe. Mësuesit e lëndës së gjuhës dhe leximit/letërsisë ishin më të prirur se mësuesit e lëndëve të tjera për të vlerësuar si *të dobët* cilësinë e teksteve të lëndës së tyre. Kjo gjetje është në përputhje edhe me rezultatet e monitorimit të Altertekstit në vitin 2012, ku 'Gjuha shqipe' ishte lënda e dytë e përcaktuar si më e vështirë. Mësuesit e shkencave shoqërore dhe natyrore ishin më të prirur t'i jepnin një vlerësim *deri diku* pozitiv teksteve të lëndës së tyre. Mësuesit e gjuhës së huaj ishin më të prirur se mësuesit e lëndëve të tjera për të vlerësuar cilësinë e teksteve lëndës së tyre si *shumë të mirë* ($\chi^2 (24) = 330.366, p < 0.05$). Koeficienti i Pearson i *Chi-square* është shumë domethënës dhe këto gjetje përveçse tregojnë perceptimin e mësuesve, i cili është i rëndësishëm pasi ata janë përcjellësit dhe përdoruesit e tekstit, por duhen marrë edhe si një tregues për cilësinë reale të teksteve të lëndëve të ndryshme.

Si i vlerësojnë nxënësit tekstet?

Në përgjithësi nxënësit i përshkruan tekstet në mënyrë neutrale: 65.4% i vlerësuan as të thjeshtë dhe as të vështirë për t'u kuptuar. Megjithatë, 25.7% e nxënësve, pra një e katërta e tyre, i vlerësuan si të vështirë (Tabela 5).

Nxënësit me rezultate të ulta në mësim prireshin t'i vlerësonin tekstet si të vështira për t'u kuptuar, krahasuar me nxënësit me rezultate të larta, të cilët i vlerësonin si të thjeshta për t'u kuptuar ($\chi^2 (8) = 57.504, p < 0.05$). Kjo flet për prirjen që tekstet hartohen duke mos pasur parasysh kërkesat dhe nevojat e ndryshme të nxënësve.

Grafiku 5. Vlerësimi i nxënësve për tekstet me të cilat mësojnë



3.1.2 Përfshirja e komunitetit të shkollës në përzgjedhjen e teksteve shkollore

A u është marrë prindërve mendim për tekstet?

Pyetja nëse prindërve u ishte marrë mendim për cilësinë e teksteve në vitin 2013-2014 iu bë si prindërve edhe mësuesve. Ndërkohë që 75% e prindërve në sondazh mohuan të jenë pyetur për tekstet, 79% e mësuesve deklaruan të kundërtën: se prindërve u ishte marrë mendimi nga shkolla (Tabela 6). Duhet mbajtur parasysh gjithsesi se rezultatet e dy sondazheve nuk janë tërësisht të krahasueshëm në lidhje me këtë pyetje pasi përgjigjet e mësuesve nuk pasqyrojnë në ç'shikallë është *realisht* përfshirja e prindërve. Megjithatë, në thelb gjetjet pasqyrojnë perceptime që kundërshtojnë njëri-tjetrin.

Tabela 6.

A u është marrë mendim prindërve nga shkolla për cilësinë e teksteve me të cilat mësojnë fëmijët gjatë vitit shkollor 2013-2014?

Përgjigjet e prindërve		
	Përqindja	Përqindja
Po	78.6	24.8
Jo	21.4	75.2
Total	100.0	100.0

Nëse krahasojmë këto gjetje me ato të monitorimit të 2012, duket se ka një përmirësim në shifrat e vjeljes së mendimit të prindërve. Në 2012 vetëm 5% e prindërve deklaruan se u ishte marrë mendim për tekstet.⁹

A kanë qenë prindërit pjesë e Komisioneve të Përzgjedhjes së Teksteve?

Më pak se gjysma (45%) e totalit të mësuesve pohuan se prindërit në shkollën e tyre kanë qenë pjesë në KPT. Ndërkohë nga mësuesit që e dinin se prindërit duhet të ishin pjesë e KPT-ve (n=537) 94% e pohuan këtë, krahasuar me vetëm 3.3% (n=40) e prindërve që pohuan se kishin qenë pjesë e këtyre komisioneve (Tabela 7).

Tabela 7.

A kanë qenë prindërit pjesë e Komisioneve të Përzgjedhjes së Teksteve? (në përqindje)

	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve
Po	45.1	3.3
Jo	1.6	2.8
Pa përgjigje	.6	.1
Nuk e di/të painformuar ¹⁰	52.7	93.9
Total	100.0	100.0

⁹ Fondacioni «Shoqëria e Hapur për Shqipërinë». (2012). Raport monitorimi Altartekst 2012. f.33

¹⁰ Kjo shifër përfshin mësuesit apo prindërit të cilët, kur u pyetën se kush merr pjesë në procesin e përzgjedhjes së teksteve, nuk i përmendën prindërit si pjesë përbërëse të KPT-ve.

Shifra e përfshirjes së prindërve në KPT është edhe më e ulët se ajo e raportit të monitorimit të Altartekstit të vitit 2012 ku 4% e prindërve kishin pohuar të ishin pjesë e KPT-ve.¹¹

Në vijim 51% e mësuesve deklaruan se vetë mësuesit kishin zgjedhur prindërit në këtë komision ndërkohë që 35% raportuan se prindërit i kishte caktuar drejtori i shkollës. Edhe prindërit raportojnë se janë zgjedhur kryesisht prej mësuesve në KPT megjithëse numri i prindërve është i vogël për të bërë një krahasim (Tabela 8). Këto shifra janë të rëndësishme për t'u pasur parasysh, duke qenë se në intervistat në grup me prindër doli vazhdueshëm problemi i zgjedhjes ose caktimit nga drejtori dhe mësuesi në strukturat e shkollës të prindërve që ishin të njëanshëm dhe që mbanin krahun e drejtorit ose mësuesit në trajtimin e çështjeve.

Tabela 8.

Nëse prindërit kanë marrë pjesë në KPT, kush i ka përfshirë? (në përqindje)

	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve
Drejtori i shkollës	35.2%	13.3
Mësuesi i shkollës	51.0%	40.0
Këshilli i prindërve	14.2%	10.7
Bordi i shkollës	12.5%	8.0
Drejtorja arsimore	4.8%	2.7
Pa përgjigje	.6%	17.3
Nuk e di	3.0%	5.3
Tjetër, specifiko:	10.2%	2.7

Pjesëmarrja ose jo e prindërve në komisionin e përzgjedhjes së teksteve nuk kishte lidhje statistikisht domethënëse me perceptimin e mësuesve

¹¹ Fondacioni «Shoqëria e Hapur për Shqipërinë». (2012). Raport monitorimi Altartekst 2012. f.18


për cilësinë e teksteve ($p > 0.05$). Ndërkohë gjetjet treguan se pjesëmarrja e *mësuesve* në komision kishte lidhje domethënëse me perceptimin e mësuesve për cilësinë e teksteve. Nëse kombinojmë një mësues i cili beson se prindi nuk ka rëndësi për procesin e përzgjedhjes së teksteve, me një prind që beson të njëjtën gjë, siç u evidentua nga gjetjet më sipër, atëherë lënia jashtë e prindërve nga procesi është pasojë e natyrshme.

Për më tepër, fakti që 42 mësues janë përgjigjur se prindërit patën rol vendimmarrës në KPT, tregon se mësuesit nuk i njohin udhëzimet të cilat specifikojnë rolin e prindit si vëzhgues në këto komisione.

A kanë qenë mësuesit pjesë e Komisioneve të teksteve? Si e gjykojnë ata procesin?

Pjesa më e madhe (82%) e mësuesve të intervistuar pohuan se kishin qenë pjesë e KPT-ve (Tabela 9).

Tabela 9.
A kanë marrë pjesë ndonjëherë mësuesit në Komisionin e Përzgjedhjes së Teksteve shkollore?



Nga mësuesit që kishin qenë pjesë e KPT-ve, pjesa më e madhe (84.6%) deklaruan se çdo hap në procesin e përzgjedhjes shkoi mirë. Kjo do të thotë ose që procesi i përzgjedhjes ka gjithsesi një mangësi që mund të vijë nga faza paraprake e vlerësimit të teksteve, ose mësuesit japin një përshkrim më pozitiv të procesit sesa është realisht. Megjithatë 68 mësues deklaruan se në proces nuk merreshin parasysh mendimet

ndryshe, ndërkohë që 31 mësues pohuan se nuk kishte kohë të mjaftueshme në proces për të bërë vlerësimin. Arsye të tjera që u përmendën nga mësuesit e intervistuar si parregullsi të procesit ishin: gabimet shkencore në tekste, zgjedhja e “tekstit më të mirë në mes të të këqinjve”, mungesa e ambienteve të përshtatshme, mospagesa për punën dhe të qenit të kushtëzuar nga të tjerët në marrjen e vendimit.

Mësuesit të cilët kishin qenë pjesë e KPT-ve u prirën të japin një vlerësim më pozitiv të cilësisë së teksteve si ‘deri diku të mirë’ dhe ‘shumë të mirë’ ($\chi^2(5) = 211.791$, $p < 0.05$). Kjo është e shpjgueshme me faktin që këta mësues ndanin përgjegjësinë për zgjedhjen e teksteve, pra prirshin të vlerësonin mirë tekstet e përzgjedhur nga një proces ku ata kishin qenë pjesë.


3.1.3 Përfshirja e komunitetit të shkollës në komisionet e shkarkimit/emërimit të personelit arsimor

A është shkarkuar drejtuesi i shkollës vitin e kaluar shkollor? Kush mori pjesë në shkarkimin e tij/saj?
Më shumë se gjysma (51%) e prindërve dhe (56%) e mësuesve pohuan se drejtuesi i shkollës është shkarkuar vitin e kaluar shkollor (Tabela 10).

Tabela 10.
A është shkarkuar drejtuesi i shkollës vitin e kaluar shkollor 2013-2014? (në përqindje)

	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve
Po	56.2	3.3
Jo	41.6	2.8
Pa përgjigje	.6	.1
Nuk e di	1.6	93.9
Total	100.0	100.0

Tabela 11.
Kush u përfshi në shkarkimin e drejtuesit të shkollës¹²



Është interesante që edhe pse në disa raste bëhet fjalë për të njëjtën shkollë, disa mësues deklaruan se drejtori është shkarkuar dhe disa të tjerë jo. Kjo sjell që rezultatet për shkarkimin e drejtorit të mos përputhen me rezultatet e emërimit të drejtorit. Me shumë gjasa këtë e krijojnë të kuptuarit e largimit të drejtuesit *si një zgjedhje personale ose 'dorëheqje'*, më shumë sesa si shkarkim nga detyra.

Shkarkimi nuk është bërë në përputhje me procedurat e specifikuar në udhëzimin e MAS për shkarkimin e drejtuesit të institucionit arsimor pasi përfshirja e Bordit të shkollës është raportuar vetëm nga 1.2% e mësuesve (n=8) (Tabela 11). Sipas udhëzimit Nr. 57, datë 12.11.2013, "Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të Arsimit Parauniversitar", Bordi i shkollës duhet të luajë një rol të rëndësishëm në proces. Titullari i njësisë arsimore vendore duhet t'ia paraqesë fillimisht Bordit kërkesën për shkarkim dhe ky i fundit jep pëlqimin e tij për shkarkimin ose vendosjen e drejtuesit në periudhë prove për një vit shkollor.

Ndërkohë që më shumë se gjysma e prindërve të intervistuar u përgjigjën se *nuk e dinë* kush u përfshi në shkarkimin e drejtuesit të shkollës së fëmijës, pjesa më e madhe e mësuesve (65%) u shprehën se ishte drejtuesi i DAR-it. Por gjithashtu një pjesë e mësuesve (gati 29%) u përgjigjën se *nuk e dinin*. Kjo shifër tregon se mësuesit nuk janë ende gati për t'u shprehur në mënyrë të lirshme për vendimet që merren në shkollën e tyre. Ndërkohë në intervistat në grup mësuesit u shprehën kryesisht se vendimet e emërimit dhe shkarkimit ishin të DAR-it.

Përfshirja e prindërve në procesin e shkarkimit të drejtuesit u raportua në një shkallë shumë të ulët, edhe pse më shpesh nga prindërit (n=14) sesa nga mësuesit (n=5). Sipas mësuesve, prindërit në këtë proces u zgjodhën nga këshilli i prindërve ose bordi i shkollës.

Vetëm katër mësues në sondazh pranuan se kishin qenë pjesë e komisionit vlerësues për

¹² Ky total nënkupton se pyetja është me përgjigje të shumëfishta, pra numri i rasteve për secilën përgjigje varion, ndërkohë që një rast mund të ketë dhënë një numër të ndryshëm përgjigjesh dhe përqindja totale nuk është 100%.

shkarkimin e drejtuesit të shkollës. Vetëm në një rast në të gjithë sondazhin e mësuesve mësuesi u shpreh se Bordi i shkollës votoi me shumicë votash të fshehta shkarkimin e drejtorit, ndërkohë që një tjetër u shpreh se Bordi i shkollës, me shumicë votash, i kërkoi DAR-it që të shkarkonte drejtorin e shkollës.

Gjetjet e mësipërme nga sondazhet mbështeten gjithashtu edhe nga gjetjet e grupeve të fokusuar me mësues dhe prindër të cilët u shprehën për raste të moszbatimit të procedurave ligjore për emërimin dhe shkarkimin e drejtuesve. Të pyetur se çfarë i pengonte të ishin pjesë e këtij procesi, ashtu siç parashikohet në ligj, mësuesit përmendën si një nga arsyet mungesën e informimit të tyre për ligjin.

"...e para është mungesa e informimit. Jo të gjithë e dinë. Tek ne para ca ditësh e morën vesh se ka një komision, ndërkohë që ligji ka kohë që ka dalë."

Mësues, Elbasan

Ndër mësuesit në intervistat në grup u vu re gjithashtu edhe një prirje për të fajësuar hallkat e tjera në arsim për faktin që *nuk i informojnë se ligji ka ndryshuar* dhe që *tani mësuesit duhet të jenë pjesë e procesit*. Një arsye tjetër e ndeshur më rrallë, e dhënë prej tyre, është se mësuesit nuk kanë ende kulturën e zbatimit të ligjit, ndërgjegjësimin e duhur për rolin që duhet të luajnë dhe për atë se çfarë duhet të kërkojnë nga drejtuesi i tyre.

"Ne nisemi nga interesa të ngushta."

Mësues, Elbasan

"Faji është edhe i mësuesve që e lexojnë ligjin dhe nuk kërkojnë të drejtat e tyre ose të zba-

tojnë ç'thuhet në ligj. Si edhe mentaliteti i indiferencës për të dhënë opinionin e tyre rreth dikujt." Mësues, Durrës

Një pjesë e mirë e mësuesve në intervistat në grup e shpjeguan mospërfshirjen e tyre në proces si një pasojë të mosfunksionimit të sistemit ligjor, duke u shprehur me një mungesë besimi në këtë sistem, e shoqëruar edhe me frikën se nëse ngre zërin, mund të ndëshkohesh.

"Do të thoja që [ligji] mirë është, po a ka guxim njeri që të bëjë diçka të tillë? Mësuesit janë të pambrojtur, nuk kërkojnë dot as të drejtat e veta. ... gjithkush do të ruajë vendin e punës, sepse lufta bëhet se kush do të hiqet nga puna. Se ka njerëz që kanë influencë politike. Kanë mbështetje nëpër institucione."

Mësues, Durrës

Sipas mësuesve, indiferenca e tyre për të marrë pjesë, e ka në fakt bazën në këtë frikë dhe mungesë besimi tek sistemi ligjor. Përzgjedhja e njerëzve që duhet ta zbatojnë këtë ligj është gjithashtu e rëndësishme sipas tyre. Një arsye tjetër e përmendur si pengesë për të zbatuar ligjin e arsimit është ndikimi shoqëror e farefisnor. Ndërkohë, forca e ndërhyrjeve politike në shkarkimin dhe emërimin e drejtuesit arsimor është përmendur shpesh nga mësuesit në intervistat në grup si një nga faktorët kryesorë.

"Të gjitha emërimet vijnë nga lart. Kjo ndodh sepse politika nuk e le arsimin të punojë i qetë."

Mësues, Tiranë

"Në shkollën time, drejtori u zëvendësua me një njeri që nuk ka punuar as edhe një ditë në arsim, që nuk dinte as organikën, as dispozitat

normative, nuk dite as sa minuta ishte ora e mësimit. Mendonte se ishte 60 minuta një orë mësimi."

Mësues, Tiranë

A është emëruar drejtues i ri? Kush mori pjesë në emërimin e tij/saj?

Janë më shumë mësues që deklarojnë se në shkollën e tyre është emëruar drejtues i ri, sesa ata që deklarojnë se drejtuesi i mëparshëm është shkarkuar. (Shih shpjegimin më sipër). Në emërimin e drejtuesit, komisioni i vlerësimit, i cili është edhe struktura që përcaktohet në udhëzim për vlerësimin e kandidatëve për drejtues, u raportua si një strukturë e përfshirë vetëm nga 6.6% e mësuesve (Tabela 12). Kjo tregon se edhe për emërimin e drejtuesit të shkollës nuk janë ndjekur procedurat e specifikuar në udhëzimin nr. 57 të MAS i cili përcakton se komisioni i vlerësimit ka detyrën e vlerësimit të aplikimeve për pozicionin e drejtuesit dhe rekomandon kandidatët tek drejtuesi i njësisë arsimore vendore. Prindërit përgjithësisht u shprehën se *nuk kanë dijeni* se kush është përfshirë në emërimin e drejtuesit. Ndërkohë sipas pjesës më të madhe të mësuesve (68%) në vendimarrje u përfshi vetëm drejtori i DAR-it.

Tabela 12.
Kush u përfshi në emërimin e drejtuesit të ri të shkollës (në përqindje)

	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve
Komisioni i vlerësimit	6.6%	2.5%
Drejtori i DAR	68.0%	36.1%
Prindërit	1.6%	1.3%
Pa përgjigje	.9%	0.9%
Nuk e di	23.8%	52.4%
Tjetër, specifik:	5.9%	10.9%

Në rastet që në proces ishin përfshirë prindërit (n=12), mësuesit deklaruan se prindërit ishin zgjedhur si përfaqësues nga këshilli i prindërve, bordi dhe nga mësues të shkollës. Megjithatë kontributi real i prindërve në proces vihet në dyshim.

"Këtë vit janë shpërndarë formularë për të plotësuar emrin e drejtorëve që dëshirojmë të vendosen, dhe u votua ... Pjesëmarrja e prindërve që e madhe, por nuk u mor parasysh emri që u zgjodh." Prind, Durrës

Në sondazh, 21 mësues deklaruan se kishin qenë pjesë e komisionit të vlerësimit për kandidaturat e drejtuesit. Në kampion rezultoni të kishin qenë të përfshirë një ose dy mësues nga e njëjta shkollë, por kishte edhe një rast ku, katër mësues në të njëjtën shkollë deklarorin se kishin qenë pjesë e procesit. Dhjetë mësues të pranishëm në këto komisione vlerësimi deklaruan se kishin pasur rol vendimarrës, ndërsa pjesa tjetër rol këshillues ose vëzhgues pa të drejtë vote. Kjo tregon sërish për një mungesë informimi dhe njohurie të saktë për rolin që mësuesi ka në komisionet e vlerësimit për emërimin e drejtuesit.

Të pyetur për hapat që u ndoqën gjatë procesit të emërimit, 13 mësues përmendën se vlerësimi i aplikantëve ishte bërë sipas kriterëve, 10 mësues përmendën se kandidati ishte zgjedhur nga dy kandidaturat e propozuara nga komisioni dhe 9 mësues përmendën publikimin e thirrjes për vend vakant. Pra në përgjithësi, mësuesit nuk raportuan të ishin ndjekur të gjithë hapat e duhur të procesit të specifikuar në udhëzimin e MAS.

A janë larguar mësues nga shkolla vitin e kaluar? Kush u përfshi në proces?

13% e mësuesve kundrejt 21% të prindërve pohuan se ishin larguar mësues nga shkolla.

Komisionet e vlerësimit dhe përfshirja e prindërve në procesin e largimit të mësuesve nga detyra janë raportuar vetëm në 1.3% të rasteve respektivisht (Tabela 13), çka nuk është në përputhje me udhëzimin Nr. 56 “Për procedurat e emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar.” Nga mësuesit që e pohuan se në shkollën e tyre ishin larguar mësues, 62% mendonin se në largim kishte pasur ndikim drejtori i DAR-it. Vetëm 5% e tyre mendonin se vendimmarrës kishte qenë drejtori i shkollës. Ndërkohë në udhëzim përcaktohet se vlerësimi dhe propozimi i kandidatëve për mësues duhet të bëhet nga komisioni i vlerësimit dhe vendimi për emërimin duhet të merret nga drejtuesi i institucionit arsimor.

Tabela 13.
Kush u përfshi në largimin e mësuesve të shkollës (në përqindje)

	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve
Komisioni i vlerësimit	1.3%	2.3%
Drejtori i DAR	61.8%	24.9%
Drejtori i shkollës	5.3%	10.9%
Prindër	1.3%	2.7%
Pa përgjigje	.7%	1.9%
Nuk e di	10.5%	42.0%
Tjetër, specifiko:	22.4%	22.2%

Vihet re një mospërputhje pasi më shumë mësues u përgjigjën se ishin emëruar mësues të rinj sesa të ishin larguar. Megjithatë, shpeshtësitë e përgjigjeve nuk pasqyrojnë numrin e mësuesve të larguar apo të emëruar realisht në shkollë, por thjesht fenomenin e largimit/emërimit, pavarësisht se sa është numri i të larguarve/emëruarve.

Vetëm dy mësues raportuan se prindërit ishin pjesë e procesit të largimit të mësuesve. Të dy këta mësues ishin në fakt nga e njëjta shkollë (9-vjeçare), pra me shumë gjasa, nënkuptonin të njëjtin prind/

prindër, të cilët sipas tyre ishin ‘vetëzgjedhur’ në këtë komision. Ndërkohë asnjë mësues nuk deklaroi të kishte qenë pjesë e komisionit për largimin e mësuesve.

A janë emëruar mësues vitin e kaluar në shkollë? Kush është përfshirë në emërimin e tyre?

36.3% e mësuesve pohuan se në shkollën e tyre vitin e kaluar shkollor ishin emëruar mësues të rinj, por krijimi i komisioni i vlerësimit u raportua vetëm nga 7.4% e mësuesve. 72% e këtyre mësuesve pohuan se ishte një emërim i bërë nga drejtuesi i DAR-it (Tabela 14).

Tabela 14.
Kush u përfshi në emërimin e mësuesve të shkollës (në përqindje)


	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve
Komisioni i vlerësimit	7.4%	1.7%
Drejtori i DAR	72.0%	33.9%
Prindërit	6.9%	18.9%
Pa përgjigje	1.2%	0.6%
Nuk e di	19.4%	50.8%

Vetëm pesë mësues (nga shkolla të ndryshme në sondazh) pohuan se prindërit ishin përfshirë në procesin e emërimit të mësuesve. Tre prej tyre ishin zgjedhur nga këshilli i prindërve dhe të tjerët nga drejtuesi i shkollës apo bordi. Shtatë mësues deklaruan të kishin qenë pjesë e komisionit të vlerësimit për emërimin e mësuesve të shkollës, nga të cilët pesë në rol vendimmarrës dhe dy të tjerët në rol këshillues/vëzhgues.

Gjetjet në lidhje me përfshirjen e strukturave në vendimmarrje për çështje si tekstet apo emërimet dhe shkarkimet e personelit arsimor plotësohen më shumë nga gjetjet në lidhje me shkollën e funksionimit dhe efektivitetin e strukturave të shkollës, të cilat paraqiten në pjesën që pason.

Tabela 15.

A është/janë ngritur Këshilli i prindërve të klasës në shkollë?



3.2 Funksionimi i strukturave të shkollës

Për të plotësuar përshkrimin e situatës së përfshirjes, studimi synoi t'i përgjigjej gjithashtu pyetjes se në ç'shikallë ndodh përfaqësimi i prindërve në strukturat e shkollës. Duke pasur parasysh përcaktimin ligjor të funksionimit të strukturave, është hulumtuar në thellësi mënyra si funksionojnë struktura si: Këshilli i prindërve të klasës, Këshilli i prindërve të shkollës, Bordi i Shkollës dhe Qeveria e Nxënësve.

3.2.1 Këshilli i prindërve të klasës

Në përgjithësi prindërit, mësuesit dhe nxënësit pohuan se kjo strukturë ishte ngritur në shkollën e tyre (70% e prindërve të intervistuar, 97% e mësuesve dhe 74% e nxënësve) (Tabela 15).

Pjesa më e madhe e prindërve dhe mësuesve pohuan gjithashtu se prindërit në këshill ishin zgjedhur me votim nga të gjithë prindërit e klasës, edhe pse 113 prindër (13%) dhe 70 mësues (6%) pohuan se prindërit janë caktuar nga drejtori ose mësuesi. Pjesa më e madhe e prindërve (72%)

gjithashtu pohuan se këshilli i prindërve ishte zgjedhur me votim nga të gjithë prindërit e klasës (Tabela 16).

Tabela 16.

Si u zgjodhën prindërit në Këshillin e Prindërve të klasës? (në përqindje)

	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve
Me votim nga të gjithë prindërit e klasës	89.6	71.7
Janë caktuar nga drejtori ose mësuesi	6.0	13.2
Pa përgjigje	.1	.2
Nuk e di	2.2	8.0
Tjetër	2.0	6.9
Total	100.0	100.0

54% e mësuesve dhe vetëm 25.5% e prindërve raportuan se këshilli i prindërve të klasës mbledh një herë deri në disa herë në muaj, ndërkohë që 33.4% e mësuesve pohuan se mbledh disa herë në semestër. Një e treta e prindërve nuk kanë dijeni se sa shpesh janë mbledhur këto struktura (Tabela 17).

Tabela 17.
Sa shpesh janë mbledhur Këshillat e Prindërve të klasës?
(në përqindje)

	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve
Një herë deri disa herë në muaj	54.1	25.5
Disa herë në semestër	33.3	27.9
Një-dy herë në vit	2.5	8.6
Nuk është mbledhur asnjëherë	1.1	4.4
Pa përgjigje	.1	.1
Nuk e di	4.7	32.6
Tjetër	4.2	.8
Total	100.0	100.0

Ndërkohë që 61.6% e mësuesve të intervistuar e shihnin këshillin e prindërve të klasës si të pavarur në marrjen e vendimeve, 33% e prindërve e mendonin kështu (Tabela 18). Të pyetur për arsyet, prindërit e shohin mësuesen kujdestare dhe drejtuesin e shkollës si ata që marrin vendime në emër të këshillit të prindërve. Mësuesit nga ana tjetër kanë nxjerrë më shpesh se prindërit arsyen se prindërit nuk kanë njohuri të mjaftueshme për rolin që mund të luajnë në këshill.

“Në komunitetin tonë është pak e vështirë... Nuk janë bindës, nuk dinë të argumentojnë për të mbrojt fëmijët e tyre.”
Mësues, Durrës

Pra, secili nga grupet e shih grupin tjetër si arsyen kryesore që struktura e këshillit të prindërve nuk funksionon në mënyrë të pavarur.

Tabela 18.
Nëse mendoni se këshilli i prindërve të klasës nuk është i pavarur, cilat janë arsyet sipas jush?

	Sondazhi i mësuesve	Sondazhi i prindërve
Vendimmarrjen e ka drejtori i shkollës	21.3%	40.6%
Vendimmarrjen e ka mësuesja kujdestare e klasës	49.1%	56.7%
Prindërit që marrin pjesë nuk kanë mjaftueshëm njohuri për rolin e tyre	38.6%	10.9%

Sipas prindërve pjesëmarrës në intervistat në grup është shkolla ajo që nuk i informon prindërit siç duhet për rolin e tyre dhe nuk i përfshin mjaftueshëm.

“Po të jetë thjesht me mbush një letër, unë nuk shkoj fare. Ndjelesh moralisht i ofenduar. Problemi është që ti si shkollë duhet të më bësh pjesëmarrës mua, është detyrë ligjore dhe morale.”
Prind, Tiranë

Në thelb, tek prindërit vihej re një mungesë besimi se pjesëmarrja e tyre ka vlerë.

“Arsye është se shkon për të zgjidh një problem tek shkolla me mësuesin ose me drejtorin dhe sheh indiferencë, dmth nuk merr atë që ti ankohesh.”
Prind, Kukës

Ç’profil duhet të ketë një prind për të qenë pjesë në këshillin e prindërve?

Prindi duhet të jetë i arsimuar për të qenë pjesë në këshillin e prindërve – kjo ishte cilësia më e shpeshtë e përmendur si nga mësuesit edhe nga prindërit (50% e mësuesve dhe 72% e prindërve të intervistuar). Por nëse për prindërit “njohja e çështjeve të shkollës” ishte cilësia e dytë më e

përmendur, për mësuesit ishte “dëshira dhe motivimi i prindërve” (Tabela 19).

Tabela 19.

Çfarë cilësish duhet të ketë prindi i zgjedhur në këshill? Cilësitë e raportuara më shpesh nga prindërit dhe mësuesit

	Përgjigjet e prindërve
Të jetë i arsimuar	72.0%
Të kuptojë nga çështjet e shkollës	52.8%
Të ketë kohë të kontribuojë	52.5%
Të ketë dëshirë dhe motivim	36.6%

	Përgjigjet e mësuesve
Të jetë i arsimuar	49.8
Të ketë dëshirë dhe motivim	11.7
Të ketë integritet, të jetë i përgjegjshëm	8.9
Kultura e pasur dhe aftësi komunikuese	8.7

Një gjetje si kjo është me rëndësi për procesin e planifikimit të nismave komunitare sepse hedh dritë në premisat nga të cilat nisen këto dy grupe: për prindërit është më e rëndësishme që ai që i përfaqëson të njohë shkollën, ndërsa për mësuesit është i rëndësishëm që të jetë i motivuar.

3.2.2 Këshilli i prindërve të shkollës

Këshilli i prindërve të shkollës ishte një strukturë që u raportua si e ngritur nga 95.4% e mësuesve dhe 65% e nxënësve krahasuar me 45% e prindërve (Tabela 20).

Tabela 20.

A është ngritur Këshilli i Prindërve të shkollës? (në përqindje)

	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve	Përgjigjet e nxënësve
Po	95.4	44.8	65.1
Jo	.7	11.3	15.9
Nuk e di	3.9	43.9	19.0
Total	100.0	100.0	100.0

Duket se sa më shumë ngjitesh në hierarkinë e strukturave të shkollës, aq më pak prindërit janë të informuar apo të përfshirë. Në mbështetje të kësaj gjetjeje është edhe rezultati se 64% e mësuesve kundrejt 24% e prindërve të intervistuar pohuan se këshilli i prindërve të shkollës ishte i pavarur në marrjen e vendimeve (Tabela 21). Prindërit të cilët kishin qenë pjesë e Këshillit të Prindërve të Shkollës ishin të prirur të mendonin se kjo strukturë ishte e pavarur në vendimmarrje ($\chi^2(6) = 73.196, p < 0.05$).

Tabela 21.

A mendoni se Këshilli i Prindërve të shkollës është i pavarur në marrjen e vendimeve?

	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve
Po	64.0	24.2
Deri diku	20.2	19.4
Jo	7.1	14.7
Nuk e di	8.7	41.7
Total	100.0	100.0

Në intervistat në grup me mësues, duke shpjeguar mospërfshirjen e prindërve, mësuesit pohuan se janë prindërit e fëmijëve me rezultate më të ulta që nuk vijnë në shkollë, ndërkohë shprehen se ata [mësuesit] zgjedhin prindërit më aktivë, të cilët nga ana e tyre vijnë më shpesh se të tjerët në shkollë. Pra, doemos interesi i prindërve të tjerë vjen gjithnjë e më shumë duke rënë. Ky shpjegim ngjan me një rreth të mbyllur, ku nuk kuptohet cili është shkaku dhe cili pasoja, pasi sa më shumë angazhohen prindërit aktivë, aq më shumë prindërit e tjerë tërhiqen dhe distancohen nga shkolla. Me shumë gjasa, janë të dy palët që kanë rolin e tyre në mbajtjen e këtij rrethi të mbyllur: nga njëra anë shkolla me qasjen e saj përjashtuese elitare, dhe nga ana tjetër, prindërit me

qasjen e tyre që në thelb është vetëpërrjashtuese. Të dy këto qasje, siç sugjerojnë edhe gjetjet nga sondazhet, edhe ato nga intervistat në grup, e kanë themelin në besimin e ulët tek pala tjetër, por për prindërit, ky besim i ulët deri diku është edhe tek vetja dhe tek pjesëtarët e komunitetit të tyre (pavarësisht se një pjesë e mirë e tyre, siç shihet në gjetjet e pjesës tjetër të studimit, shprehen se kanë besim tek prindërit e tjerë). Një arsye pse besimi ulet edhe më shumë është se prindërit nuk ballafaqohen me rezultate të përfshirjes së tyre, me fjalë të tjera, nuk i shohin të mirat e përfshirjes.

“Edhe pse kam qenë prej mëse gjashtë vitesh anëtare e këshillit të prindërve dhe bordit të shkollës, asnjëherë nuk është marrë parasysh mendimi i prindërve.”

Prind, Korçë

Studimi rikonfirmon se shkolla/mësuesit priren të bashkëpunojnë pra me një grup prindërisht që pikërisht për arsyen se zgjidhen arbitrarisht (me sugjerim të mësuesit ose drejtorit) nuk e luajnë rolin e tyre dhe nuk përfaqësojnë prindërit e tjerë.

Faktorë të tjerë që japin mësuesit si shpjegim për mospërfshirjen e prindërve janë largësia fizike e shtëpisë nga shkolla, ngarkesa në punë dhe në orare dhe niveli i ulët arsimor.

“Nuk kanë dëshirë prindërit. Më janë përgjigjur se “nuk funksionon, përse të zgjidhem.” I kam thënë zgjidhu dhe bëj ndryshimin, por është zgjedhur dhe ka vazhduar në atë monotoninë.”

Mësues, Kukës

“Është edhe niveli arsimor i tyre, që nuk dinë çfarë të bëjnë dhe stepen.”

Mësues, Kukës

“Në zonën ku jap mësim, arsimi i prindërve është tetëvjeçar, gratë janë shtëpiake... nuk e lënë gruan të dalë nga shtëpia, të marrë pjesë në takime. Fëmija e nis shkollën dhe prindi nuk e njeh mësuesin ku ka dorëzuar fëmijën.”

Mësues, Kukës

Prindërit të pyetur në intervistat në grup (4 nga 10 grupe) se si e shohin pjesëmarrjen e tyre në strukturat e shkollës dhanë si arsye frikën dhe trysinë se mendimi i tyre i shprehur lirshëm në këto struktura do të ndikonte tek vlerësimi dhe nota e fëmijës. Kjo lloj frike është përmendur gjithashtu nga 15 prindër në përgjigjet e pyetjeve të hapura në sondazhin me prindër.¹³

“Prindërit i pengojnë pasojat që mund të kenë fëmijët më mbrapa në shkollë dhe prindi qëndron larg...”

Prind, Elbasan

Prindër të tjerë, pikërisht këtë pjesëmarrje e shohin si një faktor që prindërit e përdorin për të ndihmuar mbarëvajtjen e fëmijëve në mësim.

“Ndonjë interes nuk ka asnjë prind me u zgjedh, por shkon me idenë se do të ndikojë tek ecuria e fëmijës. ...prindërit i shohin gjërat ngushtë. Nuk i shohin për të qenë vendimmarës në të mirën e shkollës.”

Prind, Kukës

3.2.3 Bordi i shkollës

Në një shumicë prej 97.4%, mësuesit, por edhe nxënësit (78%) pohuan se në shkollën e tyre ishte

¹³ Në të vërtetë, frika, nota, besimi dhe liria/lirshmëria ishin ndër konceptet më të shpeshta të përmendura nga prindërit, mësuesit dhe nxënësit në diskutimet e grupeve të fokusuara.

ngritur Bordi i shkollës vitin e kaluar shkollor.¹⁴ Ndërkohë prindërit që e pohuan këtë ishin më pak se gjysma (49%), gjë që tregon se një pjesë e mirë e prindërve janë të painformuar (Tabela 22).

Tabela 22.
A është ngritur Bordi i shkollës? (në përqindje)

	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve	Përgjigjet e nxënësve
Po	97.4	24.2	77.6
Jo	0.6	14.7	9.3
Nuk e di	2.0	41.7	13.1
Total	100.0	100.0	100.0

Nga mësuesit që e pohuan ngritjen e kësaj strukture, 84% prej tyre, krahasuar me 27% të prindërve pohuan se informoheshin në lidhje me çfarë diskutonte konkretisht Bordi në takime (Tabela 23). Kjo do të thotë se çështjet që diskutohen në Bord, nuk diskutohen apo bëhen me dije përtej mureve të shkollës, me komunitetin e gjerë të prindërve të saj.

Tabela 23.
A informoheni për çfarë diskutohet në takimet e Bordit të shkollës? (në përqindje)


	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve
Po	84.4	27.2
Jo	13.5	70.2
Nuk e di	2.1	2.6
Total	100.0	100.0

Ndërkohë një pjesë e mirë e nxënësve (71%) u shprehën se njihnin pak ose asnjë nga anëtarët

¹⁴ Mësuesit të cilët u përgjigjën se Bordi nuk ishin ngritur, ishin nga të njëjtat shkolla ku kolegët e tyre u përgjigjën se Bordi ishte ngritur. Kjo mund të shpjegohet që mësuesit janë të painformuar.

e Bordit. 29% e nxënësve në sondazhin online u shprehën se nuk kishin asnjë informacion në lidhje me aktivitetin e Bordit (Tabela 24).

Tabela 24.
Sa i njihni anëtarët e Bordit të shkollës suaj? (në përqindje)



23% e prindërve kundrejt 67% të mësuesve pohuan se bordi i shkollës ishte i pavarur në vendimarrje (Tabela 25). Megjithatë, në intervistat në grup, mësuesit u shprehën se bordi nuk funksionon ashtu siç e kërkon ligji dhe se në realitet, ka vetëm rol formal, aspak domethënës dhe kjo është gjithashtu një nga arsytet pse mësuesit dhe prindërit e distancojnë veten nga përfshirja në të.

"Bordi po të funksionojë ashtu siç duhet, atëherë edhe ai prind që do të zgjidhet, edhe mësuesi që do të zgjidhet, ka dëshirë të përfshihet, por kur nuk funksionon, ç'i duhet emri atij?"
Mësues, Elbasan

Tabela 25.
A mendoni se Bordi i shkollës është i pavarur në vendimarrje?

	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve
Po	66.9	22.7
Deri diku	19.2	17.5
Jo	6.5	14.4
Nuk e di	7.4	45.4
Total	100.0	100.0

Pjesa më e madhe e mësuesve dhe prindërve të intervistuar nuk kishin qenë anëtarë në Bordin të shkollës. 19% e mësuesve dhe 6% e prindërve të intervistuar kishin qenë anëtarë të Bordit, vitin e kaluar ose vitet e mëparshme (Tabela 26).

Tabela 26.
A keni qenë ndonjëherë anëtar i Bordit dhe kur?
(në përqindje)

	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve
Po, para disa vitesh	12.9	3.2
Po, vitin e kaluar	6.1	2.8
Jo, nuk kam qenë	81.0	94.0
Total	100.0	100.0

Gjetjet sugjerojnë se përfshirja e mësuesit në Bord ndikonte në perceptimin se sa i pavarur ishte Bordi në vendimarrje. Mësuesit që kishin qenë anëtarë bordi para disa vitesh ishin më të prirur ta perceptonin bordin si një strukturë vendimet e së cilës i merr dikush tjetër. Ndërkohë, mësuesit që ishin anëtarë bordi *vitin e kaluar* ishin më të prirur se të tjerët për ta perceptuar si të pavarur në vendimarrje ($\chi^2 (6) = 22.725, p < 0.05$). Pra, sa më afër me kohën e intervistës të kishte qenë përfshirja e tyre në Bord, aq më të prirur ishin mësuesit ta vlerësonin si të pavarur. Nëse mësuesit nuk ishin të informuar për takimet e Bordit, ishin më të prirur të mendonin se Bordi nuk është i pavarur në vendimarrjen e tij ($\chi^2 (6) = 100.785, p < 0.05$).

Prindërit e papunë ishin më të prirur të shihnin Bordin si jo të pavarur krahasuar me prindërit e punësuar me kohë të plotë ($\chi^2 (6) = 58.070, p < 0.05$). Prindërit që kanë qenë pjesë e Bordit ishin më të prirur të mendonin se Bordi ishte i pavar-

ur në vendimarrje ($\chi^2 (6) = 58.070, p < 0.05$). Megjithatë, *mënyra e zgjedhjes në Bord* nuk rezultoi të ndikonte perceptimin sesa i pavarur ishte Bordi në vendimarrje.

"Nga drejtoresha u diktua që të zgjedhim filanin që ka këtë pozicion pune... Ky ka qenë i pushtetshëm. Mendoj që fshihet diçka nën të, se ka shumë ndikim në bord. Edhe unë po të isha drejtoreshë do të vendosja filanin që të më mbronte e mbështeste."
Prind, Korçë

21% e nxënësve në sondazhin online pohuan se Bordi i shkollës së tyre ishte plotësisht funksional, kundrejt 35.5% që e vlerësuan si 'deri diku funksional' dhe 12% që u shprehën se Bordi nuk funksiononte (Tabela 27).

Tabela 27.
Sa funksional është Bordi i Shkollës në shkollën tuaj?

	Përqindja e rasteve
Është plotësisht funksional	21.3
Është deri diku funksional	35.5
Bordi nuk funksionon	12.1
Nuk kam asnjë informacion në lidhje me aktivitetin e Bordit	31.1
Total	100.0

3.2.4 Qeveria e nxënësve

Pjesa më e madhe e nxënësve thanë se qeveria e nxënësve ishte ngritur në shkollën e tyre (Tabela 28).

Tabela 28.
A është ngritur Qeveria e Nxënësve në shkollën tuaj?

	Përqindja e rasteve
Po	86.1
Jo	8.7
Nuk e di	5.2
Total	100.0

Të pyetur se sa i njihnin anëtarët e qeverisë së nxënësve, 25% e nxënësve u shprehën se i njihnin të gjithë anëtarët. Ndërkohë 30% njihnin shumicën e anëtarëve dhe 46% njihnin disa ose asnjë (Tabela 29).

Tabela 29.
Sa i njihni anëtarët e Qeverisë së Nxënësve të shkollës suaj?

	Përqindja e rasteve
I njoh të gjithë anëtarët	24.5
Njoh shumicën e anëtarëve	29.9
Njoh pak prej tyre	38.4
Nuk njoh asnjë prej tyre	7.2
Total	100.0

Sipas vlerësimit të 32% të nxënësve, qeveria e nxënësve në shkollën e tyre ishte plotësisht funksionale, kundrejt 44% të tyre që e vlerësuan si deri diku funksionale. 14% e nxënësve raportuan se nuk kishin asnjë informacion në lidhje me aktivitetin e qeverisë së nxënësve (Tabela 30).

Tabela 30.
Sa funksionale është Qeveria e Nxënësve në shkollën tuaj?

	Përqindja e rasteve
Është plotësisht funksionale	31.9
Është deri diku funksionale	44.3
Qeveria e nxënësve nuk funksionon	9.4
Nuk kam asnjë informacion në lidhje me aktivitetin e Qeverisë së nxënësve	14.4
Total	100.0

Ndërkohë që 79% e nxënësve u shprehën se kishin votuar për të zgjedhur anëtarët e qeverisë së nxënësve (senatorët), 21% nuk kishin votuar (Tabela 31).

Tabela 31.
A keni votuar ju për të zgjedhur antarët e Qeverisë së Nxënësve (senatorët)?

	Përqindja e rasteve
Po	
Jo	20.7
Total	100.0

“Tek klasa jonë senatori duhet ta kishte mesataren mbi 8.5-së edhe u mbledhen tre veta që kishin mesataren e kërkuar dhe pastaj u zgjodh në bazë të shoqërisë, ai që rrihte më shumë nxënës në klasë, ai u zgjodh.” Nxënës, Tiranë

Gati 27% e nxënësve pohuan se kryetarin e qeverisë së nxënësve (presidentin) e kishin zgjedhur të gjithë nxënësit, ndërkohë që 49% u shprehën se ishte zgjedhur nga senatorët, pra përfaqësuesit e nxënësve nga klasat (Tabela 32).

"Ka nxënës që e lakmojnë këtë post (të presidentit) dhe mund t'ia arrijnë nëpërmjet njohtjeve me mësuesit."

Nxënës, Durrës

"Mësuesja nuk donte që ajo të kandidonte më për senator, sepse është pak me karakter subjektiv... Nuk donte të zgjidhej se e ngrinte zërin për problemet."

Nxënës, Korçë

Tabela 32.
Kush e zgjidhi Kryetarin e Qeverisë së Nxënësve (Presidentin)?

	Përqindja e rasteve
Përfaqësuesit e klasave (senatorët)	49.0
Të gjithë nxënësit	26.6
Mësuesi koordinator i senatit	6.6
Drejtori i shkollës	3.2
Nuk e di/ Nuk dua te pergjigjem	14.6
Total	100.0

Pjesa më e madhe e nxënësve (58%) nuk kishin kandiduar personalisht në zgjedhjet për qeverinë e nxënësve në shkollën e tyre, kundrejt 35% që kishin kandiduar (Tabela 33).

Tabela 33.
A keni kandiduar ju personalisht në zgjedhjet për Qeverinë e Nxënësve në shkollën tuaj?

	Përqindja e rasteve
Po	35.3
Jo	58.3
Nuk di të jenë bërë/nuk janë bërë zgjedhje	6.4
Total	100.0

Në mënyrë të pritshme, ishin më shumë nxënësit me rezultate shumë të mira dhe të mira që kishin kandiduar sesa ata me rezultate nën mesataren ($\chi^2 (8) = 74.259, p < 0.05$). Po ashtu, kishin kandiduar më shumë nxënës prindërit e të cilëve kishin qenë anëtarë të Këshillit të prindërve të klasës ose shkollës ($\chi^2 (2) = 46.433, p < 0.05$).

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. Pjesëmarrja e prindërve, mësuesve dhe nxënësve në jetën e shkollës

Çështja e parë që studimi u përpoq t'i japë përgjigje ishte se në ç'përmasa ndodh përfshirja e prindërve, mësuesve dhe nxënësve në vendim-marrjen e shkollës. Përgjigja më e shkurtër që mund t'i jepet kësaj pyetjeje është: jo në përmasat që përcaktohet ligjërisht. Më poshtë janë disa rekomandime për:

1.1 Përfshirjen e komunitetit të shkollës në përzgjedhjen e teksteve shkollore

Vlerësimi kryesisht neutral që vetë mësuesit, por edhe prindërit dhe nxënësit i bëjnë teksteve shkollore është një sinjal që reforma e teksteve shkollore duhet të vijojë në disa drejtime:

- Jo vetëm të sigurohet përfaqësimi i prindërve në përbërjen e KPT-ve, i cili është aktualisht tepër i ulët, por duhet të mbahet parasysh se këta prindër duhet të zgjidhen nga prindërit e tjerë të shkollës ose strukturat e tyre, dhe jo nga drejtuesi i shkollës dhe/apo mësues.
- Në rastet kur është e mundur, në KPT mund të merret parasysh përfshirja e mësuesve të cilët janë gjithashtu prindër të nxënësve në arsimin parauniversitar, pasi ata mund të japin këndvështrimin e të dy grupeve: edhe të ofruesit të shërbimit, edhe të përfituesit të shërbimit.
- Përsa i takon cilësisë së teksteve, është me rëndësi t'i kushtohet vëmendje cilësisë së teksteve të gjuhës shqipe dhe letërsisë. Tekstet gjithashtu nuk duhet të hartohen me një shkallë të lartë vështirësie, por të marrin parasysh edhe nevojat e nxënësve me arritje mesatare dhe nën mesataren.

- Studimi në mënyrë jo të drejtpërdrejtë tregoi se cilësia e teksteve të gjuhës shqipe dhe leximit duhet të marrë një vëmendje të veçantë.

1.2 Përfshirjen e komunitetit të shkollës në proceset e shkarkimit/emërimit të personelit arsimor

Emërimi dhe shkarkimi i personelit arsimor nuk është bërë në përputhje me procedurat e parashikuara në udhëzimet e MAS. Përfshirja e strukturave si Bordi apo komisionet e vlerësimit është raportuar në shifra shumë të ulta. Përfshirja e prindërve dhe mësuesve është një nga pikat e dobta të këtyre proceseve. Mungesa e informimit, mungesa e besimit tek sistemi, ndërhyrjet politike dhe nepotike, Rekomandohet që:

Të ndërmerret një proces ndërgjegjësimi dhe informimi në të gjitha shkollat e vendit për ndryshimet e parashikuara në ligjin e ri të arsimit parauniversitar dhe aktet e tij nënligjore, veçanërisht për rolin që kanë strukturat e shkollës dhe komunitetet e shkollës në vendim-marrje. Ky proces ndërgjegjësimi duhet të përfshijë edhe fuqizimin e komuniteteve për të evidentuar rastet e shkeljeve dhe për t'i raportuar ato.

2 Funkionimi i strukturave të shkollës

Për të plotësuar përshkrimin e situatës së përfshirjes, studimi synoi t'i përgjigjej gjithashtu pyetjes se në ç'përmasa ndodh përfaqësimi i prindërve në strukturat e shkollës.

Pjesa më e rëndësishme e gjetjeve në lidhje me përfaqësimin e prindërve në proceset e zbatimit të politikave arsimore apo në strukturat e shkollës lidhen me faktin se ka një mungesë besimi brenda komunitetit të prindërve dhe midis prindërve dhe shkollës. [Mos]përfshirja e prindërve është një rreth të mbyllur: sa më shumë angazhohen prindërit aktivë, aq më shumë prindërit e tjerë

tërhiqen dhe distancohen nga shkolla. Të dy palët që kanë rolin e tyre në mbajtjen e këtij rrethi të mbyllur: nga njëra anë shkolla me qasjen e saj përjashtuese elitare, dhe nga ana tjetër, prindërit me qasjen e tyre që në thelb është vetëpërjashtuese. Të dy këto qasje, siç sugjerojnë edhe gjetjet nga sondazhet, edhe ato nga intervistat në grup, e kanë themelin në besimin e ulët tek pala tjetër, por për prindërit, ky besim i ulët deri diku është edhe tek vetja dhe tek pjesëtarët e komunitetit të tyre (pavarësisht se një pjesë e mirë e tyre, siç shihet në gjetjet e pjesës tjetër të studimit, shprehen se kanë besim tek prindërit e tjerë). Një arsye pse besimi ulet edhe më shumë është se prindërit nuk ballafaqohen me rezultate të përfshirjes së tyre, me fjalë të tjera, nuk i shohin të mirat e përfshirjes.

Një projekt, sado i mirëmenduar, nuk është i mjaftueshëm për të synuar ndryshimin e qëndrimeve që bazohen në besime të brendshme, por mund të ndihmojë për të ndërgjegjësuar komunitetet e shkollës dhe aktorë të tjerë në fushën e arsimit. Ndërgjegjësimi duhet të fillojë nga përcaktimi i dallimeve dhe ngjashmërive në të kuptuar, të cilat shpesh bëhen edhe pengesë për bashkëpunim. Komunitetet e shkollës nuk mendojnë njësoj për disa nga çështjet e rëndësishme që lidhen me funksionimin e shkollës. Janë pikërisht besimet e brendshme të të gjitha palëve, që aktualizohen në sjellje, të cilat mbajnë larg nga shkolla një pjesë të mirë të komunitetit të prindërve. Projekti i Fondacionit duhet të krijojë hapësirën dhe mundësitë për këto grupe dhe palë interesi që të diskutojnë

dhe analizojnë tensionet e kontradiktat që i pengojnë të bashkëpunojnë. Gjetjet e këtij studimi në këtë kuptim nevojitet të validohen duke i shërbyer procesit të krijimit të të kuptuarit të përbashkët të universit të shkollës, të misionit të arsimit dhe përfitimeve të bashkëndara nga anëtarët e të gjitha grupeve të përfshira: prindër, nxënës, mësues, autoritete etj.

Disa rekomandime më specifike në drejtim të strukturave janë:

- T'u jepet mundësia prindërve, mësuesve dhe nxënësve të ndryshëm (të diversifikohet pjesëmarrja) për të qenë anëtarë në strukturat e shkollës. Kjo do të rrisë besimin tek strukturat, proceset, sistemi dhe tek rezultatet e tij.
- Mësuesit dhe shkolla duhet të njohin mirë problemet që i mbajnë prindërit larg nga shkolla, dhe t'i mitigojnë këto sfida në mënyrën e përshtatshme dhe të duhur. Nëse prindërit nuk vijnë dot për arsye largësie fizike, atëherë duhet të gjendet një mënyrë tjetër për t'i kontaktuar, përveç takimeve ballë për ballë. Në rast se ata vijnë sepse "druhen" nga vlerësimi i mësuesve për notat e fëmijës, atëherë duhet të gjendet mënyra jo intimiduese për t'i ftuar dhe bërë pjesë prindërit në shkollë.
- Mësuesit duhet të bëhen të ndërgjegjshëm se si e përdorin pushtetin e notës dhe se si ky pushtet ka efektet e tij jo vetëm tek nxënësit, por edhe më gjerë dhe se si ndikon në aspektet e tjera të jetës së shkollës.

3.3 – Potenciali i komunitetit (prindër, nxënës dhe mësues) për t'u organizuar dhe ndikuar në vendimmarrjen e shkollës

3.3.1 Takimet me prindër si forume diskutimi

Takimet mujore midis prindërve dhe mësuesve paraqesin një mundësi të mirë për zhvillimin e diskutimeve mes prindërve dhe mësuesve në lidhje me problemet e shkollës.

a. Pjesëmarrja në takime


Studimi ka evidentuar se në shkollat publike të arsimit parauniversitar pjesëmarrja e prindërve në takime me prindër nuk është në nivele të kënaqshme. Megjithatë kjo pjesëmarrje ndryshon nga shkolla në shkollë, por edhe brenda të njëjtës shkollë në varësi të disa variablave: si momenti gjatë vitit akademik, mosha e fëmijës apo sjellja dhe përformanca e fëmijës në shkollë. Është raportuar gjerësisht gjatë intervistave në grup që në takimin e parë me prindër pjesëmarrja e prindërve është shumë më e lartë se në takimet e tjera. Gjithashtu gjatë sondazhit ka rezultuar se sa më të vegjël të jenë nxënësit aq më e lartë është pjesëmarrja e prindërve nëpër këto takime duke evidentuar që me rritjen e fëmijëve prindërit marrin më pak pjesë në takime me prindër. Arsyet për një sjellje të tillë do të eksploroohen më poshtë, por kryesisht ato variojnë nga rritja e besimit tek fëmijët, deri tek larmishmëria e problemeve me të cilat nxënësit përballen në moshën të ndryshme.

Megjithëse prindërit në një shkollë të madhe (81% e prindërve të anketuar) vetëdeklarojnë se

marrin pjesë rregullisht në takimet me prindër, nga triangulimi i burimeve është konfirmuar se pjesëmarrja e tyre mbetet ende e ulët (më pak se gjysma e prindërve të klasës). Për të kuptuar këtë ‘inflacion’ në vetëdeklarimin e prindërve, u pyetën prindërit pjesëmarrës në intervistat në grup, dhe rezultoi se për një pjesë dërrmuese të tyre pjesëmarrja në takime me prindër konsiderohet si një tregues i përgjegjshmërisë së tyre si prind dhe i interesimit të tyre për fëmijën. Për pasojë është e arsyeshme të mendohet se prindërit mund ta kenë të vështirë të pranojnë se ata nuk marrin pjesë në takime me prindër. Megjithatë kjo e dhënë mund të jetë edhe ndikim i metodologjisë së mbledhjes së të dhënave, ku gjatë sondazhit pyetja ka qenë e tillë që prindi është kërkuar të shprehet nëse ai vetë shkon apo jo në takimet me prindër, ndërsa gjatë intervistave në grup pyetja ka qenë për të gjithë prindërit e klasës (i.e. për tjetrin).

Për të eksploruar arsyet përse prindërit nuk marrin pjesë në takimet me prindër, është përdorur metoda e triangulimit (metodologjik dhe i burimeve). Studimi ka evidentuar se në plan të parë qëndron *mungesa e kohës nga ana e prindërve për të ndjekur takimet me prindër*. Gjithashtu orari që shkolla cakton për takimet me prindër shpesh kryqëzohet me orarin e punës në profesione të ndryshme, duke e bërë të vështirë për prindërit që janë në punë ndjekjen e këtyre takimeve. Mungesa e kohës apo koha e papërshtatshme e takimeve me prindër konfirmohet nga 65% e prindërve që deklarojnë se nuk marrin pjesë në takime me prindër dhe 39% e mësuesve të anketuar (Shih Tabela 34).

Tabela 34:
Arsyet përse prindërit nuk marrin pjesë nëpër takime me prindër



Arsyeja e dytë e mospjesëmarrjes është *mosnjoftimi në kohë i prindërve për takimet*, siç konfirmohet nga 12.3% e mësuesve të anketuar. Mënyra e njoftimit të prindërve është hulumtuar përmes intervistave në grup dhe është evidentuar se kryesisht njoftimi bëhet përmes nxënësve. Në pjesën më të madhe nxënësve u komunikohet verbalisht nga mësuesi kujdestar që të njoftojnë prindërit për takimin e radhës, dhe në disa raste më të rralla ju jepet njoftim me shkrim, i cili duhet firmosur nga prindi dhe sjellë sërish në shkollë. Në shkollat private shpesh njoftimi bëhet në forma të tjera, siç është njoftimi i prindërve përmes telefonit (me sms). Nga ky studim ka rezultuar se kjo formë njoftimi është shumë më efektive dhe siguron një pjesëmarrje shumë më të madhe të prindërve se sa metodat e tjera.

Arsyeja e tretë që i demotivon prindërit të ndjekin takimet me prindër lidhet me atë që diskutohet në këto takime. Kështu 3.9% e prindërve që deklarojnë se nuk i ndjekin takimet me prindër, deklarojnë se nuk shkojnë në këto takime ngaqë nuk ndihen mirë në to. Gjithashtu prindërit pjesë-

marrës në intervistat në grup ankohen se që në takimin e parë atyre u kërkohen para për shkollën, por ndërkohë nuk ka transparencë as se si shpenzohen këto para dhe as se cilat janë nevojat e shkollës për të cilat nevojiten këto para. Për më tepër rezulton se në këto takime prindërve u tërhiqet vëmendja në lidhje me sjelljen e fëmijës së tyre në shkollë. Në disa raste këto vërejtje bëhen në sy të prindërve të tjerë, çka e bën edhe më të vështirë pozitën e prindërve, sikurse edhe mund t'i dekurajojë ata që të vazhdojnë të ndjekin këto takime.

“Vajza ime ishte 2-3 here ne takim me prinder dhe takimi ishte per uniformen qe duhet te paguainin mesuesit vete dhe per rojen, ishte nje fond qe prinderit do pagonin. Kishte dhe prinder qe diskutuan qe pse ne do i blejme edhe perdet e shkolles, ne shkolla shteterore, ne jemi me asistence, me nje pune qe paguhemi shume pak edhe nuk na del’.
Prind Elbasan

“Te shkolla ime nuk marrin te gjithe pjese, mesuesja thote shikoj po te njejtat fytyra perhere. Eshte nje vajze qe eshte shume e mire psh dhe prindin e saj rralle e shikoj, ndersa keta mesataret marrin pjese, kurse te dobetit nuk marrin pjese, prinderit e femijeve te dobet, nuk e di se pse’.
Nxënës Tiranë

b) Përmbajtja e takimeve

Studimi ka evidentuar se ka një prirje të përgjithshme për mënyrën se si zhvillohen takimet me prindër, e cila në vija të përgjithshme ndryshon shumë pak si në boshtin gjeografik ashtu edhe atë të kohës.

Takimet me prindër janë përshkruar në intervistat në grup në pak a shumë në këtë mënyrë :
Në fillim prindërit mbidhen në një nga klasat e

shkollës. Më pas mësuesi kujdestar i informon për çështje me rëndësi për shkollën dhe për procesin mësimor. Në takimin e parë me prindër ky informacion përqëndrohet kryesisht rreth planit vjetor të aktiviteteteve, rregulloren e shkollës, detyrimin për të kontribuar financiarisht nga ana e prindërve, dhe zgjedhjen e këshillit të prindërve të klasës. Më pas mësuesi fillon të diskutojë në mënyrë individuale me secilin prind në lidhje me ecurinë në mësim dhe sjelljen e nxënësit. Në takimet e tjera (nga takimi i dytë e mbrapa) pjesa e parë ku jepet informacion i përgjithshëm ose eliminohet ose reduktohet në ndonjë njoftim të ardhur nga drejtoria e shkollës.

Është vërejtur me shqetësim, pohimi i disa nxënësve dhe prindërve pejsëmarrës në intervistat në grup, ku kanë deklaruar se në disa raste mësuesi jep vlerësimet për nxënësin (përfshi notat apo komente mbi sjelljen e tij) në sy të të gjithë prindërve. Megjithëse një sjellje e tillë mund të ketë qëllim për të ushtruar presion mbi prindërit që të kujdesen më shumë për fëmijën e tyre, ajo bie ndesh me normat etike dhe për më tepër është në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (2008). Për më tepër, siç është përmendur edhe më lart në këtë raport, një sjellje e tillë mund të ketë ndikim direkt në dekurajimin e prindit për të marrë pjesë në takimet me prindër.

Arsyet se pse nxenesit nuk kane deshire me marre pjese, edhe qe une [vete] s`kam qef me marr pjese, [eshte] se fillon mesuesja [te thote ne mbledhje te prinderve qe nxenesi] ka bere kete, ka bere ate.
Nxënës Kukës

“Kurse ketu tek shkolla ku une kam djalin, ja jep [notat] ne sy te gjitheve. Nuk me pelqen. Mesuesja mbledh madje dhe nga klasat e tjera prinder dhe

ta thote ne sy te te gjithëve, 'shiko djali jot nuk po meson mire, e kam ngritur i kam vene kater. S`kam ca ti bej me, ka keto problem'. Ndersa nje prindi tjetër i thote qe 'vajza jote me doli nga mesimi ne filan ore" dhe prindi i thote qe nuk e di pse nuk me keni lajmeruar', gje qe mesuesja kujdestare duhet t`ia kishte thene ne vecanti".

Prind Korçë

Një shqetësim tjetër është se këto takime përqëndrohen tek problemet individuale të nxënësit dhe jo tek problemet e përbashkëta të shkollës. Gjetje kjo që konfirmohet përmes triangulimit të të dhënave. Kështu, të pyetur se çfarë diskutohet në takimet me prindër, 74% e prindërve pjesëmarrës në sondazh deklarojnë se u diskutua ecuria në mësim dhe sjellja e fëmijës së tyre dhe vetëm 7.4% e tyre pohojnë që të jenë diskutuar problemet e shkollës. Të njëjtat gjetje pohohen edhe në sondazhin me mësues, ku 68.2% e mësuesve të anketuar shprehen se në këto takime diskutohet për mbarëvajtjen në mësim dhe sjelljen e nxënësve në shkollë.

Megjithatë, këto gjetje bien ndesh me atë që mësuesit e anketuar deklarojnë gjatë sondazhit, ku 92% e tyre janë të mendimit se prindërit nuk duhet të angazhohen vetëm me problemet që lidhen me fëmijët e tyre. Me të drejtë do të lindte pyetja se përse mësuesit diskutojnë me prindërit vetëm problemet individuale të fëmijës së tyre, ndërkohë që ata (mësuesit) mendojnë se prindi duhet të angazhohet edhe për probleme që prekin shkollën në tërësi?

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje, autorët e këtij studimi kanë eksploruar më në thellësi arsyet përse takimet me prindër nuk arrijnë të shërbejnë si forume diskutimi për problemet e shkollës.

Së pari rezulton mungesa e kohës në dispozicion nga ana e mësuesit, gjë që ndikohet kryesisht nga numri i nxënësve në klasë. Për shembull në klasa ku ka 40 nxënës, sikur vetëm gjysma e tyre të marrin pjesë në takimet me prindër, dhe mësuesja të shpenzojë 5 minuta me secilin prind për të diskutuar mbi ecurinë e fëmijës së tij në mësim, vetëm kjo pjesë e takimit do të kërkonte të paktën 100 minuta (gati dy orë). Për më tepër mësuesit e intervistuar raportojnë se këto takime zhvillohen mbas ditës normale të punës së mësim, dhe pothuajse ansjërherë nuk rimbursohen plotësisht, duke ulur kështu motivimin e mësuesve për këto takime.

Së dyti, prindërit e intervistuar shprehen se në përgjithësi ata nuk kanë besim tek mundësia e mësuesit kujdestar për të zgjidhur problemet që ka shkolla, dhe për pasojë ata ndihen të dekurajuar që t'i diskutojnë këto probleme gjatë takimit me prindër. Në kushte të tilla prindërit pjesëmarrës në intervistat në grup shprehen se i duket më e arsyeshme që ta shpenzojnë kohën gjatë takimeve me prindër për të diskutuar vetëm për ecurinë në mësim të fëmijës së tyre.

Së treti, pjesa më e madhe e nxënësve të intervistuar shprehen se me prindërit e tyre ata shumë rrallë diskutojnë për probleme të shkollës që nuk lidhen direkt me klasën e tyre. Siç mund të jetë për shembull siguria në shkollë apo higjiena e tualeteve të shkollës. Për pasojë, një arsye e mos angazhimit të prindërve mund të jetë edhe mungesa e informacionit që ata kanë për problemet e shkollës.

Së fundmi, nga të trija kategoritë e pjesëmarrësve në intervistat në grup pohohet se 'tradicionalisht' takimet me prindër nuk kanë shërbyer si

një mundësi për të diskutuar problemet e shkollës, duke bërë që një pjesë e konsiderueshme e prindërve thjesht ta marrin të mirëqënë këtë fakt dhe të mos synojnë ta sfidojnë këtë koncept.

Megjithatë, pavarësisht shqetësimeve të ngritura më sipër, nga intervistat në grup është konfirmuar se ka raste të rralla ku në takime me prindër diskutohen probleme të përbashkëta të prindërve, të cilat lidhen kryesisht me mësuesit apo me infrastrukturën e shkollës. Gjithashtu ekzistojnë edhe 'takimet e përqëndruara', të cilat janë një mundësi për të diskutuar probleme të përbashkëta të shkollës, ku prindërit thërriten për të diskutuar mbi një temë të caktuar, e cila iu është njoftuar që më parë. Fatkeqësisht, në intervistat në grup raportohet se takime të tilla ndodhin shumë rrallë dhe pjesëmarrja e prindërve në to është shumë e ulët krahasuar me takimet 'e zakonshme' me prindër. Kjo gjetje e fundit ngre dyshimin mbi interesin dhe gatishmërinë e prindërve për t'i përdorur takimet me prindër si mediume komunikimi për të ngritur zërin për problemet e shkollës. Megjithatë një çështje e tillë duhet eksploruar më tej, pasi për momentin numri tepër i vogël i këtyre takimeve, dhe mënyra e organizimit të tyre, nuk japin të dhëna të mjaftueshme për të konfirmuar këto dyshime.

"Neqoftese une shkoj ne mbledhje prinderish rregullisht, normal qe me intereson edhe ambjenti ku meson femija im, po kur mesuesit nuk japin asnjelloj informacioni, une shkoj thjesht pyes, qysh eshte femija im, si shkon me mesime, ka bere ndonje rremuje ndonje gje".

Prind, Elbasan

"Nuk flasim per keto gjera [problemet e perbashketa te shkolles] se jane 20 veta qe presin mbrapa

meje dhe koha eshte shume e kufizuar. Te flasi mesuesja njezet minuta per nje problematike edhe aty jane 30 prinder, plus edhe nja 40 femije qe nuk kane ikur akoma qe jane aty prezent".

Prind, Tiranë

3.3.2 Bashkëpunimi mes palëve

a) Përfshirja e prindërve në veprimtarinë e shkollës

Angazhimi i prindërve në aktivitetet e shkollës vlerësohet si tepër i rëndësishëm për mirëadministrimin e saj. Megjithatë, siç u përshkrua edhe më sipër, të dhënat e këtij studimi tregojnë se përfshirja e prindërve mbetet ende një sfidë për sistemin arsimor shqiptar. Megjithëse 81% e mësuesve të anketuar deklarojnë se prindërit përfshihen në veprimtarinë e shkollës, vetëm 32% e prindërve pohojnë të kenë marrë pjesë në aktivitetet e shkollës gjatë vitit shkollor 2013 - 2014. Një mospërputhje e tillë në deklarime mund të jetë pasojë e një efekti shumëfishues ku i njëjti prind aktiv në shkollë, mund të raportohet nga disa mësues të së njëjtës shkollë. Megjithatë kjo kontradiktë në raportime mund të shpjegohet edhe me diferencat në mënyrën e perceptimit të përfshirjes në shkollë apo të pritshmërive që mund të kenë palët mbi shkollën dhe llojin e përfshirjes së prindërve në shkollë.

Për më tepër gjatë intervistave në grup me mësues u vu re një prirje e tyre për të theksuar se prindërit janë pjesë e veprimtarisë së shkollës. Një prirje e tillë mund të ndikohet si nga dëshira për të ndarë përgjegjësitë për problemet e shkollës, por edhe me faktin se për shumë mësues përfshirja e prindërve shihet si tregues për vlerësimin e punës së tyre. Një perceptim i tillë mund të ndikojë në raportimin e prindërve si pjesëmarrës në aktivitetet e shkollës edhe kur realiteti mund të

jetë i ndryshëm.

Pavarësisht raportimeve kontradiktore, triangulimi i të dhënave tregon qartazi se përfshirja e prindit në shkollë mbetet ende në nivele të ulta, dhe për më tepër mundësitë që shkolla i ofron prindërve për t'u përfshirë janë ende larg asaj që kërkohet jo vetëm në strategjinë kombëtare të arsimit parauniversitar (2014), por edhe në legjislacionin shqiptar për arsimin parauniversitar (Ligji 69/2012).

b) Bashkëpunimi për zgjidhjen e problemeve

Përsa i përket zgjidhjes së problemeve që kanë nxënësit në shkollë, është konfirmuar përmes triangulimit metodologjik dhe të burimeve, se pothuajse gjysma e prindërve pjesëmarrës në studim synojnë t'i zgjidhin problemet duke shkuar drejt e tek drejtori i shkollës dhe duke anashkaluar mësuesin kujdestar. Kështu 53% e prindërve të anketuar janë shprehur se nëse fëmija e tyre ka ndonjë problem në shkollë ata do të synonin ta zgjidhnin problemin duke u ankuar tek drejtori i shkollës (Tabela 35).

Tabela 35:
Në ç'mënyrë mund të kontribuonin prindërit për një problem të caktuar në shkollë?

	Përgjigjet e mësuesve	Përgjigjet e prindërve
Reagimi për problemin e përbashkët	Takim me drejtuesit e shkollës	53.0%
	Kërkesë ndaj Ministrisë, bashkisë/komunës	13.1%
	Peticion i hapur në media	6.9%
	Protestë	4.2%
	Fushate përmes rrjeteve sociale (facebook etj)	4.3%
	Pa përgjigje	1.7%
	Nuk e di	3.0%
Tjeter	14.0%	
Total		100%

Një qëndrim i tillë vihet re edhe tek mësuesit e anketuar, 61% e të cilëve shprehen se për të zgjidhur një problem në shkollë prindërit duhet të takojnë drejtorin e shkollës dhe vetëm 20% e tyre mendojnë se prindi duhet të takohet me mësuesin kujdestar. Megjithëse pushteti i mësuesit në shkollë mund të jetë i kufizuar përballë atij të drejtorit të shkollës, ky qëndrim i mësuesve mund të interpretohet si një tërheqje nga roli i tyre si ndërmjetësues midis prindit dhe drejtorit, apo mësuesve të tjerë.

“Une kisha një problem me tualetet që shkojnë te gjitha klasat bashke. Një djale 15 vjecar shkon në tualet ku mund të shkoj dhe një vajze 10 vjecare, une e ngrita këtë problem me te madhe. U zgjat gjashte muaj kjo gje, i thashe mesueses kujdestare që me thote ‘te lutem mos me ve në pozite se eshte në rol buka e fëmijeve të mi’. Shkova në drejtori duke i thene që ‘po nuk e zgjidhet do shkoj në drejtori arsimore’. U zgjidh brenda dites”.

Prind, Kukës

Gjatë intervistave në grup është hulumtuar kjo tendencë e prindërve për tu drejtuar menjëherë tek drejtori i shkollës dhe ka rezultuar se arsyet variojnë nga besimi tek forca e drejtorit të shkollës për të zgjidhur problemin, tek mungesa e komunikimit të prindit me mësuesin kujdestar. Gjithësesi, pavarësisht arsyeve përse prindërit preferojnë drejtorin e shkollës përpara mësuesit kujdestar për zgjidhjen e problemeve, një sjellje e tillë mund të tregojë një bashkëpunim jo shumë të konsoliduar midis prindërve dhe mësuesve. Një bashkëpunim i tillë do të ndihmonte në ndërtimin e një partneriteti strategjik mes prindërve dhe mësuesve, duke bërë që nga njëra anë mësuesi të ishte më i sigurtë në ruajtjen e vendit të punës (për sa kohë ai do të përmbushte me

përgjegjshmëri detyrën e tij si mësues); nga ana tjetër, ky partneritet mund të kishte ndikim në përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe për pasojë të rezultateve të nxënësve në mësim.

Së fundmi, vlen të theksohet se përmes triangulimit të burimeve është konfirmuar se shumë prindër priren që problemet të cilat lidhen me shkollën t'i zgjidhin jo përmes rrugëve formale, por përmes rrugëve informale (i.e. përmes miqve të përbashkët). Megjithëse në disa raste kjo mënyrë mund të rezultojë efektive për zgjidhjen e problemit individual të fëmijës ajo mbart disa rreziqe. Së pari, kjo zgjidhje lë të pazgjidhur problemin për fëmijët e tjerë dhe, për pasojë, nuk ndihmon në zgjidhjen përfundimtare të problemit, por vetëm shmangien e tij. Së dyti, kjo mënyrë mbart rrezikun që fëmija të përfitojë trajtim favorizues kundrejt nxënësve të tjerë, duke bërë që të lëkundet besimi i fëmijëve tek vlera të rëndësishme morale si trajtimi i barabartë dhe vlerësimi i merituar. Së treti, kjo zgjidhje paraqet edhe një problem për shëndoshjen e strukturave përfaqësuese në shkollë (i.e. Këshilli i Prindërve, Bordi i Shkollës), pasi nëse prindërit do t'i zgjidhin të gjithë vetë (përmes rrugëve informale) këto probleme, ata mund të mos angazhoheshin për fuqizimin e këtyre strukturave, duke ndikuar që ato të jenë inekzistente dhe të mos kenë ndikim në zgjidhjen e problemeve të shkollës. Duke e futur kështu situatën në një rreth vicioz, ku edhe më shumë prindër të synojnë t'i zgjidhin problemet në rrugë informale, të cilat duken më efektive. Së

fundmi, një prind që synon ta zgjidhë problemin në rrugë informale në vend që të kërkojë të drejtat e tij si prind që i garantohen me ligj, përfundon duke kërkuar një 'favor'. Një sjellje e tillë mendohet se në vend që të fuqizojë rolin e prindërve si nxitës të llogaridhënies brenda shkollës, fuqizon edhe më tej pushtetin individual të drejtorit të shkollës.

“Mendoj që prindërit zgjedhin rrugen me të shkurter, me mendimin që drejtori është lider në shkolle dhe ben ligjin, ai vendos për këte gje, ikin te drejtori duke menduar që ne këte menyre do gjejne nje zgjidhje me shpejt...Në disa raste ikin tek drejtori edhe se mund ta njohin apo të kenë muhabet me të”

Mësues, Kukës

Kryesisht menyra me e sukseshme e zgjidhjes se problemeve ne shkolle eshte me te mire. Po l gjete ndonje mik mesuesit gjerat zgjidhen me shpejt, ose edhe sikur thjesht me e marre per kafe, sepse ndryshe po u ankove ta merr inat femijen...Ne fakt kjo ka qene edhe sin je lloj tradite ne shkollat tona.”

Durrës, Prind

Ne shkollen time nuk ekziston hierarkia fare, psh mesuesja ime kujdestare nuk ka ne dore asnje gje, po duhet te shkosh tek drejtoresha dhe ajo te adreson tek nendrejtoresha. Nendrejtoresha supozohet t'i zgjidhi edhe problemet me te thjeshta”

Nxënë, Tiranë

Sfidat e bashkëpunimit: Perceptimi për veten dhe grupin

• Perceptimi për rolin e prindit në shkollë

Teoria e *profecisë vetëpërmbythëse* përkufizohet në trajta të përgjithshme si fuqia e një pohimi që megjithëse i pavërtetë në fillim, të bëhet i vërtetë pasi individit që e beson atë sillet në mënyrë të tillë që e vërteton pohimin (Merton, 1948). Duke njohur fuqinë e perceptimit që ka individit për rolin e tij (dhe të grupit që përfaqëson) në shoqëri, është synuar të eksplorohet se si e perceptojnë prindërit veten e tyre dhe rolin që ata kanë në komunitetin shkollor. Për pasojë përmes sondazhit prindërve i janë dhënë disa pohime në lidhje me rolin që ata duhet të luajnë në shkollë dhe i është kërkuar të shprehin qëndrimin e tyre për këto qëndrime. Gjetjet e sondazhit janë me shumë interes në disa drejtime. Së pari, pjesa më e madhe e prindërve të anketuar (i.e. mesatarisht mbi 70 % e tyre për të gjitha pohimet) shprehen se ata duhet të jenë pjesë thelbësore e vendimmarrjes në nivel shkollë. Këto të dhëna që konfirmojnë interesin e prindërve për të marrë pjesë në drejtimin dhe administrimin e shkollës, sugjerojnë që duhet të ketë pengesa të jashtme të cilat nuk i lejojnë ata që ta kenë vërtet një rol të tillë në shkollë (siç shpjegohet në mënyrë të detajuar në seksionet e mëposhtme të këtij studimi).

Së dyti, edhe brenda dakordësisë për të marrë pjesë në vendimmarrje, duket se ka variacione për aspekte të caktuara të saj. Kështu dakordësia më e lartë është se prindërit duhet të marrin pjesë në dhënien e masave disiplinore ndaj nxënësve (80 %), ndërkohë që kjo përqindje fillon e bie për aspekte më të specializuara si përzgjedhja e teksteve (78 %), aprovimi i buxhetit të shkollës (69 %), emërimi i mësuesve (69 %) dhe përzgjedhja e

drejtorit të shkollës (55 %). Këto variacione mund të shpjegohen me hezitimin e disa prindërve për të marrë përgjegjësi për çështje që ata i shohin si të komplikuar (e.g. buxheti, tekstet), por edhe me një farë perceptimi tepër të përhapur (kryesisht midis mësuesve, por jo vetëm) ku prindi shihet si i pakualifikuar mjaftueshëm për tu marrë me 'punët e shkollës'. Ky perceptim i shprehur gjerësisht dhe për një kohë të konsiderueshme mund të ndikojë në mënyrën se si prindërit perceptojnë veten e tyre por edhe prindërit e tjerë në raport me shkollën. Së fundmi, po të marrim parasysh se një pjesë e konsiderueshme e prindërve janë edukuar në shkollat e modelit sovjetik, ku pushteti ishte i centralizuar, mund të aludohet se perceptimi i një shkolle tërësisht të decentralizuar kërkon kohë. Një gjë e tillë mund të reflektohet më së miri tek fakti që pohimi me dakordësinë më të ulët (55%) ka qenë në lidhje me rolin e prindërve në emërimin dhe shkarkimin e drejtorit të shkollës.


Megjithatë, pavarësisht arsyeve që mund t'i kenë nxitur disa prindër të anketuar që ta shohin të kufizuar rolin e tyre në shkollë, perceptimi i prindërve si aktorë të pafuqishëm në vendimmarrje, mund të ndikojë në dekurajimin e tyre për të kërkuar të drejtat që ju garantohen me ligj.

• Besimi dhe vlerësimin për njëri – tjetrin

Një element i rëndësishëm në ndërtimin e një marrëdhënieje social-politike është besimi mes palëve dhe vlerësimi për njëri-tjetrin. Në këtë linjë arsyetimi mund të argumentohet se besimi i prindërve tek njëri – tjetri dhe vlerësimi për njëri – tjetrin është shumë i rëndësishëm për organizimin e tyre të përbashkët. Prandaj i është kërkuar prindërve të anketuar të vlerësojnë se sa i përmbyshin prindërit detyrimet e tyre. Ka rezultuar se 57 % e prindërve të anketuar mendojnë se më-

Tabela 36: Vlerësimi i prindërve për punën që bëjnë aktorët e ndryshëm në shkollë.

Sa dakord jeni se grupet apo strukturat e mëposhtme e kryejnë me përgjegjshmëri rolin apo detyrimin e tyre?



suesit e përmbushin me përgjegjshmëri detyrën e tyre, ndërkohë 53 % e tyre e mendojnë këtë për drejtorin e shkollës, dhe vetëm 42 % e mendojnë këtë për prindërit (Shiko Tabela 36).

Këto rezultate, ku ka më shumë prindër që vlerësojnë punën e drejtorit të shkollës se sa të prindërve, mund të jenë tregues i një vetëreflektimi nga ana e prindërve që ata nuk po bëjnë aq sa duhet për sa i përket përgjegjësive që duhet të marrin në lidhje me shkollën. Por nga ana tjetër ato mund të jenë gjithashtu tregues të pakënaqësive që kanë prindërit me njëri-tjetrin. Gjatë intervistave në grup me prindër, u vu re se një pjesë e madhe e tyre kanë ankesa për prindërit e atyre fëmijëve që ata i quanin ‘problematikë’, të cilët i fajësojnë për mungesë përgjegjshmërie në edukimin e fëmijëve të tyre. Gjithashtu një pjesë e madhe e prindërve të intervistuar ankohen se

një pjesë e prindërve janë shumë indiferentë dhe nuk angazhohen pothuajse fare për të kontribuar (jo vetëm financiarisht) për shkollën ku mësojnë fëmijët e tyre.

“Po kane mungese besimi, s`kane vullnet, nivele te ndryshme prinderish. Klasa intelektuale ja di me shume vleren shkolles, arsimit dhe pat-jeter qe do fokusohet ne gjithepershirjen e aktiviteteve per shkollen”.

Prind, Tiranë

“Ta themi hapur tani: ka prinder qe nuk merren fare me femijet e tyre dhe pastaj hallin e tyre e kam une se vjen femija me ankohet ne shtepi. Me prinder te tille vec te besh sher, cfare te bashkepunosh me ta? Ata nuk dijne te edukojne femijen e vet”.

Prind, Elbasan

Për më tepër, edhe mësuesit duket se nuk janë të kënaqur nga sjellja e prindërve, ku vetëm 15% e mësuesve të anketuar mendojnë se ata e përbushin detyrën e tyre me përgjegjshmëri.

“Prindi shqiptar nuk e di deri ku e ka hapin që te kerkoj te drejten e vet, njekohesisht eshte kaq indiferent nga shkolla, sa edhe per gjera disiplinore ne lidhje me femijen ta ve fajin ty”.
Mësues, Elbasan

“Ne komunitetin e shkolles time, le per te deshriuar edhe niveli arsimor i prinderve, si pike e dobet. Indiferent, problem sociale. Kane probleme me sanksionet e femijeve qe kane ne shkolle”.
Mësues, Durrës

Nga ana tjetër, prindërit shfaqin rezerva për sjelljen dhe përgjegjshmërinë e mësuesve që i japin mësim fëmijëve të tyre. Thuajse një në dy prindër të anketuar (57%) shprehen se janë plotësisht dakord që mësuesit e kryejnë detyrën e tyre me përgjegjshmëri. Këto shifra janë koherente me gjetjet e intervistave në grup, në të cilat është konfirmuar se palët kanë ankesa për njëra – tjetrën. Prindërit e intervistuar shfaqin mungesë besimi në punën që bëjnë mësuesit, duke ngritur jo rralë herë edhe akuza për diskriminim apo trajtim të pabarabartë, të cilat (sipas tyre) në disa raste bëhen për qëllime korruptive (duke nënkuptuar ryshfet apo trafik influence).

“Tani ne shkolle nxenesit nuk shihen te gjithë njelloj se disa jo i mbajn me hater per arsye politike, jo disa i njohin...”.
Prind, Kukës

Këto qëndrime të artikuluara më sipër, pavarë-

sisht nëse në disa raste mund të jenë ngritur mbi eksperiencën të jetuara dhe zhgënjime personale, në thelb minojnë besimin tek njëri-tjetri dhe frymën e bashkëpunimit prindër – mësues. Në kushte të tilla palët mund ta kenë vështirë të bashkohen përballë problemeve të përbashkëta të lindura në shkollë. Për ta ilustruar, nëse në shkollë ka mungesë të bazës materiale të nevojshme për zhvillimin e mësimin (çka është në interes të të dyja palëve), prindërit dhe mësuesit kanë pak gjasë që të ngrenë zërin sëbashku për zgjidhjen e këtij problemi. Po ashtu nëse një mësues kërcënohet për tu pushuar nga puna për arsye politike (pavarësisht nëse e kryen detyrën e tij me përgjegjshmëri) ai do ta ketë të vështirë të gjejë mbështetjen e prindërve nëse më parë nuk ka ndërtuar një marrëdhënie besimi dhe bashkëpunimi me prindërit.


“Po sikur te them une qe nuk e kerkoj dot ndihmen e prinderit, se prindi shkon te drejtori”.
Mësues, Korçë

• **Konkurrenca mes nxënësve dhe prindërve të tyre**

Në mënyrë që bashkëpunimi mes një grupi interesi të funksionjë si i tillë do të ishte e arsyeshme që pjesëtarët e grupit të ishin të ndërgjegjësuar dhe të interesuar për interesat e përbashkëta të grupit. Me këtë qëllim janë pyetur prindërit pjesëmarrës në sondazh nëse ata mendojnë se duhet të interesohen jo vetëm për problemet që lidhen ngushtësisht me fëmijën e tyre, por edhe me problemet që prekin gjithë komunitetin shkollor. Nga përgjigjet vërejmë se një në dy prindër (53%) të anketuar shprehen se janë *plotësisht dakord* që ata duhet të angazhohen për probleme që nuk lidhen vetëm me fëmijën e tyre, dhe një në katër prindër (25%) shprehen se janë *deri diku dakord* me këtë pohim. Nga këto rezultate duket se

pjesa më e madhe e prindërve të anketuar (mbi tre të katërtat e tyre) janë të ndërgjegjësuar se në mënyrë që të kujdesen për mirëqenien e fëmijës së tyre ata duhet të interesohen për të gjithë trupën e nxënësve të shkollës, pasi një problem që sot është i një fëmije, nesër mund të prekë drejtpërdrejtë fëmijën e tyre. Megjithatë, fakti që një pjesë jo e vogël (21 % e prindërve të anketuar) shprehen në mënyrë të hapur se interesimi i prindit duhet të jetë i ngushtuar vetëm tek fëmija e tyre përbën një shqetësim për organizimin e përbashkët të prindërve si grup interesi. Siç u diskutua edhe më sipër në këtë studim, ka më shumë mësues se sa prindër që mendojnë se prindërit nuk duhet të interesohen vetëm për problemet individuale të fëmijës së tyre. Kështu 92% e mësuesve të anketuar shprehen se prindërit duhet të interesohen edhe për problemet e përbashkëta të shkollës dhe jo vetëm për problemet që lidhen ngushtësisht me fëmijën e tyre.

Tabela 37:
Mendimi i prindërve se për çfarë duhet të interesohen ata më tepër (në përqindje)



Ndërkohë që më poshtë do të eksplorojmë arsyet objektive dhe subjektive të mos reagimit faktik të prindërve për problemet e përbashkëta të shkollës, këtu do eksplorojmë arsyet që i shtyjnë prindërit të deklarojnë hapur se ata duhet të kenë

një fokus të përqëndruar ngushtësisht tek fëmija e tyre. Kështu nga intervistat në grup ka rezultuar se një ndër arsyt kryesore të këtij qëndrimi është konkurrenca direkte mes fëmijëve, e nxitur apo mbështetur nga prindërit. Nga njëra anë, kjo konkurrencë mund të burojë nga sistemi arsimor, i cili i detyron nxënësit që në fund të shkollës së mesme të konkurrojnë me njëri – tjetrin në Maturë Shtetërore.

Siç diskutohet edhe më poshtë në këtë studim, Matura Shtetërore i vendos nxënësit në një konkurrencë direkte me njëri – tjetrin për një vend të lirë në universitetin shtetëror. Nga ana tjetër, është konfirmuar nga triangulimi i burimeve se ka një tendencë të disa prindërve për t'i vlerësuar arritjet në mësimet (notat) të fëmijëve të tyre duke i krahasuar ato me me arritjet (notat) e fëmijëve të fqinjve apo kushërinjve. Një konkurrencë e tillë në disa raste bëhet shumë e ashpër duke motivuar tek nxënësi devizën 'secili për vete'.

“Çështja është se ka disa prinder qe mund ti prishe dhe interesi. Mund ta kete femijen shume mire me nota dhe thote pse ta prish noten e femijes tim”
Prind, Durrës

“Ka dhe prinder qe mendojne qe femija e tyre te jete me perpara se femijet e tjere, po eshte vetem nje pakice e vogel besoj une”.
Prind, Elbasan

“Dhe gjysherit dhe prinderit, pyetjen e pare qe i ben nxensit, ‘a je i pari klases ti’? Po nuk besoj se kjo eshte me tendence qe ‘a i ke lene te tjeret mbrapa’?”.
Prind, Tiranë

Megjithëse konkurenca shpesh është e shëndetshme dhe mund të luajë rol të rëndësishëm në nxitjen e nxënësve për të punuar më shumë, është e arsyeshme të argumentohet se ajo duhet të ngrihet mbi disa parime etike dhe zhvillohet në kushte të shëndetshme për fëmijët. Ndonëse mund të jetë e shëndetshme interesi i secilit prind që fëmija e tij të bëjë përpjekje individuale për zhvillim intelektual, ai (fëmija) gjithashtu ka nevojë për një mjedis social të shëndetshëm ku mund të mësojë. Për këtë arsye kohezioni social në komunitetin shkollor do të ishte shumë i rëndësishëm për zhvillimin e fëmijës, dhe interesimi i prindit ngushtësisht për problemet që lidhen ekskluzivisht me fëmijën e tij në nivel afatshkurtër, mund ta dëmtojë pikërisht fëmijën në nivel afatgjatë. Për ta ilustruar këtë, nëse prindi nuk do të interesohet për sigurinë në shkollë meqë fëmija e tij nuk është ‘problematik’, ai mund të mos kuptojë se në një shkollë të pasigurtë çdo nxënës mund të bie pre (në mënyrë direkte ose jo) e dhunës verbale dhe fizike.

E njëjta gjë vlen edhe për higjienën e tualeteve të shkollës, ku një prind nuk mund ta zgjidhë problemin vetëm duke e porositur fëmijën e tij që të mos i frekuentojë ato, pasi nëse këto tualete bëhen burim i një epidemie ajo mund të prekë të gjithë nxënësit e shkollës. Për sa më lart konkurrenca mes nxënësve (dhe nganjëherë mes prindërve) do të ishte mirë që të jetë në thelb e shëndetshme dhe të nxitet si nga dëshira për përparim personal ashtu edhe nga përgjegjësia për komunitetin ku bën pjesë. Për ta përmbyllur, interesimi për problemet e përbashkëta të komunitetit shkollor është në çdo rast interesim direkt për fëmijën, për sa kohë ai kalon në këtë komunitet një pjesë të madhe të ditës, dhe një pjesë të rëndësishme të jetës së tij.

“Banjot janë për ibret, por normalisht ne i porosisim fëmijet që të mos shkojnë aty. Une për vete i them gjithmonë fëmijes sim ‘te keqen mami me mire shko ne ndonje lokal aty afër se sa tek banjot e shkolles’”.

Prind, Tiranë

Pavarësisht shpjegimeve të mësipërme, autorët e këtij studimi janë të vetëdijshëm që mungesa e kohezicionit social është një fenomen që nuk mund të kuptohet duke studiuar në mënyrë të izoluar vetëm komunitetin shkollor. Autorë të ndryshëm argumentojnë se dekadat e fundit kanë sjellë ndryshime të mëdha social-ekonomike dhe kulturore në botë, duke ndikuar në shpërbërjen e komuniteteve shoqërore të mëparshme dhe ridimensionimin e mënyrës se si qytetari percepton veten dhe shoqërinë (lexo për më tepër Putnam, 2001; Sandel, 2010). Për pasojë mund të argumentohet se ndryshimet shoqërore që ka pësuar Shqipëria gjatë dekadave të fundit mund të jenë gjithashtu përgjegjëse për mënyrën se si prindërit, si pjesë e shoqërisë, e perceptojnë veten e tyre dhe komunitetin e përbashkët, çka sigurisht performohet edhe në ambienti në shkollës, por nuk kufizohet vetëm aty.

“Me levizjet demografike kemi një perzierje kulturash, nivelesh. Jeta është bere me shume ritmike, secili ka punen e vet, janë bere prinderit individualist, i intereson vetem fëmija i vet”.

Prind, Tiranë

Kohezioni social mes prindërve

Arsye tjetër që mund të pengojë kohezionin social midis prindërve mund të jenë edhe diferencat kulturore dhe sociale, reale apo të perceptuara.

Gjatë intervistave në grup është vënë re një tendencë e theksuar e prindërve për të evidentuar që jo të gjithë prindërit kanë “të njëjtin nivel kulturor” dhe për pasojë ata nuk mund “të merren vesh me njëri-tjetrin”. Këto perceptime janë hulumtuar edhe më tej dhe është vënë re se komunitetet shkollore janë heterogjene, ku gjendja ekonomike apo sociale e prindërve shpesh ndryshon shumë. Në disa raste, në shkollën e mesme të qytetit shumë fëmijë vijnë nga fshatrat përreth. Megjithëse vendbanimi, statusi social apo gjendja ekonomike jo domosdoshmërisht janë tregues i botëkuptimit apo i nivelit kulturor, këto diferencat janë sjellë shumë shpesh prej prindërve si arsye përse ata nuk mund të kuptohen me njëri-tjetrin. Për pasojë, ka arsye të besohet se perceptimi i këtyre diferencave, edhe pse ndoshta jo tërësisht i vërtetë, përbën një kërcënim për ndërtimin e kohezionit social midis prindërve dhe bashkëpunimin e tyre me njëri tjetrin

“Në fakt dhe nuk njihemi me njëri-tjetrin, nuk takohemi dhe nuk komunikojmë me njëri-tjetrin”.

Prind, Durrës

“Prindit e fshatit me shumë se pesëdhjetë për qind nuk marrin pjesë në ditën e caktuar për mbledhje. Janë të painteresuar, nuk e kanë traditën, nuk e kanë kulturën. Nuk janë institucionale me pak fjalë”

Prind, Kukës

Nga ana tjetër, këto diferencat mund të kenë edhe një efekt tjetër. Gjatë intervistave në grup është raportuar për një trajtim jo të njëjtë të nxënësve në varësi të statusit social (dhe ekonomik) të prindërve të tyre, çka mund të bëjë që disa nxënës

të trajtohen në mënyrë të privilegjuar. Nëse këto pretendime janë të vërteta, atëherë do të ishte me vend të mendohej se jo të gjithë prindërit i përjetojnë njësoj problemet e shkollës, dhe megjithëse lundrojnë në të njëjtën varkë disave ‘nuk u lagen këmbët’.

“Une kam shku me u anku te drejtori por nuk na zgjidh njeri pune ne se jemi fukarej. Per romet nuk e vejne zjarrin, kam shku disa here per tu anku...Masanej nje prind m'tha mos ju drejto asaj mesuese se eshte hakmarrese dhe mund ti prishi pune djalit, mund ti uli noten”.

Prind, Tiranë

“Arsyeja eshte kjo se vete prinderit e te dy komuniteteve nuk e ndejne veten dashamires me pjesen tjeter. Kjo vjen nga niveli ekonomik i ulet dhe arsimimi i ulet. Duke pare qe prinderit e nje femije tjeter eshte me nota te mira dhe prindi intelektual, nuk mund te me afrohet mua dhe te me mbeshtet...Ne periferi gjithmone prinderit jane te nivelit te dyte”.

Prind, Korçë

Kohezioni social mes mësuesve

Përsa i përket mësuesve, kohezioni social mes tyre mund të vështirësohet prej arsyeve sa të ngjashme aq edhe të ndryshme nga ato të prindërve. Kështu, gjatë intervistave në grup është raportuar gjerësisht se në shumicën e komuniteteve të mësuesve, ata ndahen në grupe (tarafë apo klane). Këto nënndarje shpesh bëhen në bazë të arsyeve të ndryshme, duke filluar që nga preferencat personale, tek bindjet politike (të majtë, të djathtë) dhe deri tek grupmosha (mësues rishtar dhe mësues të vjetër në profesion). Vlen të theksohet se ekzistenca e nënndarjeve të tilla nga njëra anë

dëmton besimin tek njëri tjetri dhe nga ana tjetër në mënyrë praktike do të vështirësonte edhe më shumë mundësinë e mësuesve për t'u bërë bashkë në mbrojtje të të drejtave të tyre. E thënë kjo, pasi është e arsyeshme të besohet se për një drejtues është më e vështirë që të hakmerret ndaj të gjithë mësuesve të shkollës, se sa ndaj një apo disa mësuesve të veçuar.

“Nje shembull ne nje x grup pedagogjik qe tha ‘une jam mire, c`me duhet mua’... edhe jane [mesuesit e shkolles] me idene qe kur kisha une nje problem nuk u ngrit njeri, tani as une nuk ngrihem”.

Mësues, Tiranë

“[K]emi frike per te besuar [tek njeri –tjetri]. Diku edhe nga pikepamjet politike brenda kolektivit. Qe do te thote ai qe eshte me pikepamjet e x partie eshte me i sigurt se ai tjetri. Pastaj vjen partia tjetere ne pushtet dhe permbysen gjerat”.

Mësues, Kukës

“Problemi eshte qe kemi te bejme me servile qe punojne me te dyja palet e politikës. Une besoj qe po te ishim bashke disa vete [dhe] te luftonim per te njejtën kauze do ja dilnim. Po une mendoj qe ne momentin qe do i preken interesat personale gjithsecili do hedhi cdo gje poshte, bindje partie etj”.

Mësues, Durrës

“Kolektivi ekziston vetem per te hedh gure nen rrota, jo per tu bere bashke. Nuk ka transparence. Punet tona te shkolles fliten neper klube”.

Mësues, Tiranë

Duhet theksuar se kur flitet për ndarje politike, këtu nuk bëhet aq fjalë për ndasi ideologjike midis mësuesve, se sa për përkatësi me një parti të caktuar politike. Ekzistenca e një përkatësie të tillë, e cila siç duket shërben si garanci apo si rrezik për vendin e punës, shpalos shumë probleme të tjera të rëndësishme për arsimin shqiptar. Së pari, një gjetje e tillë tregon se ligji për arsimin parauniversitar (69/2012) nuk zbatohet sipas dispozitave të tij për emërimin dhe shkarkimin e mësuesve. Së dyti, sepse nëse mësuesit e shohin garancinë e profesionit të tyre tek përkatësia me partinë politike, është e arsyeshme të besohet që ata do të investojnë më shumë kohë dhe energji për partinë politike, se sa për kualifikimin e tyre profesional apo për marëdhënien me nxënësit dhe prindërit.

3.3.3 Reagimi i përbashkët

Të dhënat e mësipërme, ku rreth tre të katërtat e prindërve të anketuar pranojnë se ata duhet të angazhohen për problemet e përbashkëta të shkollës, duket se nuk reflektojnë angazhimin e tyre faktik në shkollë. Kështu gjatë intervistave të thelluara evidentohet se në praktikë angazhimi i prindërve për probleme të përbashkëta të shkollës është në nivele minimale. Duke sugjeruar kështu që edhe ata prindër që e dijnë se duhet të angazhohen për problemet e përbashkëta të shkollës, në praktikë nuk e bëjnë një gjë të tillë. Për këtë arsye janë eksploruar në thellësi arsyet objektive dhe subjektive që i pengojnë apo dekurajojnë prindërit të angazhohen në problemet e përbashkëta të shkollës.

“Nje pjese [e prinderve] nuk ankohet [per problemet e shkolles] se dhe kane mangesi ekonomike dhe s`kane mundesi per te ofruar per zgjidhje, nje pjese nuk kane arsimimin e duhur,

[nuk janë të] kulturuar sa duhet, një pjesë janë të pamotiv[uar]”.

Prind, Korçë

a) Frika nga hakmarrja e mësuesit (nota, mosaktivizimi, presioni, armiqësia)

Studimi ka evidentuar se prindërit dhe nxënësit e shohin angazhimin për zgjidhjen e një problemi të përbashkët në shkollë si formë ankese ndaj personit që është përgjegjës për çështjen përkatëse. Për ta ilustruar, nëse prindërit ankohen për bazën materiale në shkollë, ata e perceptojnë këtë si një akuzë për Drejtorinë Arsimore. Apo nëse ankohen për buxhetin e shkollës, e shohin këtë si akuzë për drejtorin e shkollës. E thënë me fjalë të tjera prindërit mendojnë se me ankesën e tyre ata mund të evidentojnë abuzimin e ndonjë autoriteti arsimor, dhe për pasojë ata i druhen ‘hakmarrjes’ prej këtij autoriteti (i.e. mësuesi, drejtori apo drejtori arsimor). Triangulimi i të dhënave tregon se në mënyrë direkte nxënësit i druhen ‘hakmarrjes’ së mësuesit. Megjithëse termi ‘hakmarrje’ shpesh mund të ngarkohet me një kuptim tepër negativ, ai është përdorur gjerësisht nga prindërit, nxënësit dhe mësuesit pjesëmarrës në këtë studim, për të shpjeguar tendencën e disa mësuesve (apo drejtorit të shkollës) për të kërkuar shpagim ndaj një sjelleje apo veprimi të nxënësve dhe prindërve të tyre. Kur u pyetën nxënësit dhe prindërit pjesëmarrës në intervistat në grup se cilat janë mjetet përmes të cilave mësuesi kërkon shpagim ndaj nxënësit, ata renditën notën (vlerësimin për arritjet e nxënësit) si instrumentin kryesor, dhe më pas sjelljet fyese dhe dekurajuese ndaj nxënësit (i.e. mos aktivizimi në mësim apo aktivitete jashtë shkollore; fyerje apo vërejtje të shpeshta dhe të paarsyetuara). Gjithashtu prindërit që jetojnë në qytete të vogla shqetëso-

hen se mos ‘armiqësia’ me mësuesin mund të zgjasë për vite të tëra, duke bërë që ‘hakmarrja’ të shtrihet edhe ndaj fëmijëve të tjerë (të të njëjtit prind) apo të tejkalojë kufijtë e shkollës.

“Edhe prindi nuk është i guximshëm sepse vjen tek unë dhe thote mua mos me nxirr, sepse kanë frikën e fëmijes”.

Mësues, Kukës

Pra aktivizimi i nxënësve (por edhe i prindërve të tyre) në shkollat publike parauniversitare ka një barrierë tepër solide dhe kjo është frika për notën. Edhe sondazhi me nxënës ka evidentuar se nota mbetet shqetësimi më i madh i nxënësve dhe pjesa më e madhe e nxënësve të anketuar (83%) shpehen se nëse nuk do të ishin të shqetësuar për notën që do të merrnin në shkollë ata do angazhoheshin më aktivisht për zgjidhjen e problemeve të shkollës si dhe do të ngrinin zërin kundër padrejtësive që ndodhin në shkollë.

Pavarësisht se është e vështirë të evidentohet se deri ku kjo frikë e nxënësve për notën është reale apo e perceptuar, triangulimi i të dhënave tregon se ajo (frika për notën) ka një ndikim të rëndësishëm në kufizimin e lirisë së nxënësve në shkollë apo guximin e tyre për të ngritur zërin ndaj padrejtësive që hasin në ambientet shkollore.

“Atehere sigurisht që ajo që i ndodh të gjithëve me ndodh edhe mua, është ajo frika e protagonizmit ose frika nga të tjeret që ti je ai që ke shkuar dhe ke spiunuar sic perdoret rendomte. Çfare do beja unë? Thjesht do mbroja veten duke mbyllur syte dhe veshet”.

Nxënës, Tiranë

Kaq e madhe është frika e prindërve nga 'hakmarrja' e mësuesve, sa edhe në rastet kur ata besojnë se problemi që kanë në shkollën e fëmijës mund të zgjidhet përmes ekspozimit të tij në media, ata sërish nuk e zgjedhin këtë rrugë, sepse i druhen reagimit 'hakmarrës' të mësuesit. Kështu, të pyetur se si do të vepronin në rast të një problemi në shkollë, vetëm 6 deri në 7 % e prindërve pjesëmarrës në sondazh e shohin adresimin e problemit në media si zgjidhje. Ndërkohë kur kjo çështje u eksplorua më tej shumë prindër u shprehën se edhe pse besonin që denoncimi në media mund ta zgjidhte problemin, ata nuk e preferonin këtë zgjidhje, pasi i djuheshin një 'hakmarrjeje' nga ana e mësuesve apo drejtorit të shkollës. Ndoshta është me rëndësi të theksohet se edhe në rastet kur prindërit deklarojnë se do të ishin të gatshëm ta ekspozonin problemin në media, kryesisht bëhet fjalë për një problem që prek në mënyrë specifike fëmijën e tyre, dhe jo një çështje që prek interesin e një grupi të madh nxënësish. Për pasojë identifikimi i prindit denoncuës bëhet shumë më i lehtë se sa në rastin kur problemi do të ishte i përbashkët për shkollën.

"E para është se një kategori thote, une e kam femine ne rregull me nota, edhe mesuesi me pergjigjet kshu qe ne rregull, e dyta thote, po te hy une do jem thjesht zhurmues per shkollen kshuqe me mire s`po prishna."

Prind, Kukës

"Une nqs nuk do zgjidhej ne Drejtorine Arsimore, mendoj se do ta lija aty problemin, nuk do shkoja me lart. As ne media nuk do shkoja. Nuk do shkoja ne media sepse duke njohur femijen tim qe eshte i ndjeshem, se mund te behet publike ne klase mund ta njohin dhe prandaj"

Prind, Korçë

"Nuk shkojm ne media sepse e para na ker cenohen femijet. Nqs dalim ne media mund te kete pasoja... Normale qe nota eshte e para, por edhe te tjerat..."

Prind, Durres

Për të shpjeguar këtë interes të nxënësve dhe prindërve për notat, vlen të kujtojmë se ato (notat e nxënësve) ndikojnë në formulën përfundimtare të Maturës Shtetërore, dhe për pasojë në mundësinë e nxënësit për të zgjedhur degën e preferuar të studimit në universitetin publik. E thënë më thjeshtë, vlerësimi i mësuesit (notat) ka ndikim të rëndësishëm në të ardhmen e nxënësit. Ndërkohë, sistemi arsimor parauniversitar në Shqipëri është i tillë që mësuesi ka pushtet të plotë për vlerësimin e nxënësit, pasi mungojnë skema të sekretimit të detyrave, vlerësimë të jashtme (për arritjet gjatë viteve të shkollës) apo udhëzime të formalizuara për vlerësimin e nxënësit. Për pasojë, duke qenë se vlerësimi i nxënësit nga mësuesi mund të konsiderohet ende larg të qenit tërësisht objektiv, mund të mendohet se shqetësimi i nxënësit për reagimin 'hakmarrës' të mësuesit mund të mos jetë tërësisht i pabazuar.

"Une kam patur nje rast me nje mesuese dhe nuk jam ankuar tek drejtori, sepse nuk kam besim qe fjala ime do degjohet...Keshu ka ndodhur ne te gjitha rastet qe di une, asnjehere nuk ka fituar nxenesi. Pastaj kur vjen puna do digjem une qe jam ne mature meqe folam... E per cfare? Per nje beteje te humbur qe ne fillim".

Nxënës, Korçë

b) Frika nga hakmarrja e drejtorit (humbja e vendit të punës)

Frika nga 'hakmarrja' është identifikuar gjithashtu edhe si një problem i mësuesve, të cilët i druhen 'hakmarrjes' së drejtorit të shkollës (*alias* drejtori i institucionit arsimor). Kështu pjesa më e madhe e mësuesve pjesëmarrës në intervistat në grup janë shprehur se ata ndihen të pasigurtë për vendin e tyre të punës, dhe shprehen se ata kanë frikë që drejtuesit e DAR (emërtimi i ri Njësia Arsimore Rajonale) apo drejtori i shkollës mund të marrë masa ndaj mësuesit që ngre zërin për një padrejtësi që vëren në shkollë. Këto masa përfshijnë largimin nga detyra apo transferimin e mësuesit në një shkollë tjetër të një cikli më të ulët, apo në një zonë më të largët. Duhet theksuar se megjithëse këto veprime janë në kundërshtim me dispozitat e ligjit për arsimin parauniversitar (69/2012), mësuesit e intervistuar shprehen të bindur se këto masa mund të ndërmerren ndaj tyre në çdo kohë, duke e ilustruar qëndrimin e tyre edhe me raste të ndodhura gjatë dy viteve të fundit (kur ligji ka qenë në fuqi). Për këtë arsye këto pohime ngrenë edhe shqetësime të tjera që lidhen me shkallën e zbatimit të ligjit për arsimin parauniversitar, dhe të cilat janë trajtuar edhe në kapitujt e tjerë të këtij studimi.

“Une kam qene nendrejtoreshë shkolle dhe me transferuan ne një shkolle tjetër. Mbas njëfjare kohe me therret drejtoresha ne zyre dhe me thote qe na kane dhene urdher qe ti duhet te japesh doreheqjen, perndryshe vjen kontrolli nga Drejtoria Arsimore dhe do kontrollohen mesues etj Une ta jap vete doreheqjen thashe, nuk ka pse ben asnjelloj kontrolli vetem per te me hequr mua. Ndejta një muaj e gjysem pa pune dhe sot jam ne klasen e dyte mesuese. Drejtperdrejt është politika, nuk mori

mendim as te keshilli i prinderve, as vleresimin e punes asgje, thjesht do japesh doreheqjen”

Mësuese

Mund të argumentohet se pasiguria që ndjen mësuesi në vendin e punës, mund të ndikojë edhe në bashkëpunimin e tij me nxënësit dhe prindërit. Në intervistat në grup është raportuar shpesh se mësuesi rezervohet kur vjen puna për të mbështetur ankesat apo kërkesat e nxënësve dhe prindërve të tyre, pasi i druhet reagimit të drejtorit të shkollës, i cili mund të mendojë se është mësuesi që i ka nxitur ata (prindërit dhe nxënësit) që të protestojnë. Në këtë linjë arsyetimi është argumentuar gjithashtu gjatë intervistave në grup, se edhe në takimet me prindër mësuesit nuk priren që të diskutojnë për probleme të shkollës, pikërisht nga frika që mund të akuzohen nga drejtori i shkollës për nxitje të protestave në shkollë dhe më pas të vuanjë pasojat e e një 'hakmarrjeje' të mundshme.

“Eshtë dhe një problem. Ti behesh me prinderit edhe e zgjidh një problem, por ti mbas kesaj, te drejtori nuk je me sy te mire”.

Mësues, Kukës

“Une kam dhe Kryetarin e sindikates në këshillin pedagogjik dhe as nuk e hap asnjë gojen. Te mbeshtesin kur nuk është drejtori aty, ama ne publik nuk te mbeshtet asnjëri”.

Mësues, Tiranë

“Mesuesit ndonjëherë mund te mos jene te per gatitur dhe kane frike te mbeshtesin njeri tjetrin, sepse mund te te kerkoj drejtori te te gjej gabim dhe te gjen gabim...Po edhe po nuk te hoqi nga puna, te transferon me ndonje fshat edhe s'ke ca t'besh”.

Mësues, Durrës

c. Besimi tek fuqia e grupit


Mungesa e besimit të prindërve, nxënësve dhe mësuesve tek forca e tyre në disa raste mund të qëndrojë tek faktorë që shkojnë përtej vullnetit apo bindjes së individit. Për shembull frika e mësuesve për humbjen e vendit të punës, e artikuluar më sipër, nuk është e justifikuar nga pikëpamja ligjore, sepse ligji ofron garanci për karrierën e mësuesit. Megjithatë, siç është argumentuar edhe në kapitujt e tjerë të këtij studimi, mosrespektimi i ligjit përsa i përket emërimeve dhe shkarkimeve të mësuesve, i bën mësuesit të mos kenë besim se ligji do t'i mbrojë ata në rast se ata bashkëpunojnë me prindërit për të reaguar ndaj padrejtësive apo për të ngritur zërin për probleme të shkollës. Shpesh eksperimentat e personale (apo të kolegëve) krijojnë bazat e besimit që personat kanë (qofshin këta mësues, prindër apo nxënës) për forcën e tyre, të grupit të tyre për të sjellë ndryshim në komunitetin shkollor. Kaq i fortë është besimi tek historitë personale (të jetuara apo të dëgjura), sa ato sfidojnë fuqimisht besimin tek ligji dhe garancitë e tij.

Siç u diskutua edhe më lart, fuqia e profetësisë vetëpërbushëse qëndron pikërisht tek besimi i individit. Kështu, nëse prindërit nuk do besojnë se ligji do u japë atyre fuqi për të ndikuar në përzgjedhjen e mësuesve ata nuk do t'i shfrytëzojnë mundësitë që jep ligji, dhe do të vazhdojnë të pranojnë që gjërat të zgjidhen sipas mënyrës së vjetër (ku prindi nuk është pjesë e vendimmarrjes së shkollës). Për pasojë prindërit do vërtetojnë mosbesimin e tyre fillestar që ata nuk kanë asnjë fuqi dhe që ligji i ri nuk do të sjellë asnjë ndryshim në pozitën e tyre në shkollë.

Për sa më lart është e arsyeshme të argumen-

tohet që besimi i mësuesve, prindërve dhe nxënësve tek forca e tyre ka një rol të rëndësishëm në nxitjen apo dekurajimin për të reaguar në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të përbashkëta të komunitetit. Për këtë arsye është eksploruar besimi tek forca e prindërve dhe ka rezultuar se vetëm 25% mësuesve të anketuar shprehen se besojnë tërësisht tek aftësia e prindërve për t'u organizuar dhe ndikuar në zgjidhjen e problemeve të shkollës, dhe vetëm 33% e prindërve të anketuar (Tabela 38) shprehen se kanë plotësisht besim tek aftësia e prindërve për t'u organizuar dhe ndikuar në përmirësimin e situatës në shkollë. Kjo mungesë besimi është eksploruar në thellësi gjatë intervistat në grup me mësues dhe prindër, dhe u evidentua se mungesa e besimit tek forca e prindërve është komplekse: një pjesë e konsiderueshme besojnë se po të bëhen bashkë prindërit kanë për të ndryshuar situatën në shkollë, por ata nuk besojnë se prindërit mund të bëhen bashkë; ndërsa një pjesë tjetër nuk besojnë që prindërit mund të ndryshojnë ndonjë gjë, edhe po të bëhen të gjithë bashkë.

Tabela 38:
Besimi i prindërve tek aftësinë e tyre për të ndikuar në vendimmarrjen e shkollës (në përqindje)



Ky besim i ulët tek forca e prindërve për të ndikuar në zgjidhjen e problemeve të shkollës, është shqetësues pasi mund të dekurajojë prindërit dhe

mësuesit që të ngrenë zërin kundër padrejtësive që ata hasin në shkollë. Me fjalë të tjera duke menduar që edhe nëse ata do të ngrenë zërin askush nuk do t'i mbështesë, ose edhe nëse i mbështet sërish asgjë nuk do të ndryshojë, prindërit dhe mësuesit mund të ngurrojnë të marrin iniciativën për të reaguar ndaj padrejtësive dhe të priren të bashkëtojnë me problemin apo ta shmangin atë (duke u transferuar në një shkollë tjetër) por jo të përballen dhe të përpiqen ta zgjidhin.

“Problemet ne radhe te pare shkoj te mesuesja kujdestare, pastaj shkoj te drejtori, nqs nuk zgjidhet shkoj te Drejtoria Arsimore. Po nuk u zgjidh atje do e largoj femine nga shkolla, ca kam me bo?”
Prind, Kukës

“Une kam nje problem, po se zgjidha me mesuesen do shkoj do takoj drejtorin...po nuk u zgjidh e heq femijen dhe e coj ne nje shkolle tjeter. Vende me u anku ka sa te duash, po s`kam besim”.
Prind, Tiranë

d. Besimi tek autoritetet

Është e arsyeshme të mendosh se njerëzit, si qenie racionale, priren të angazhohen në një veprim, për të cilin besojnë se ka gjasa që të japë rezultat. Për këtë arsye, që të presin zgjidhje nga autoritetet arsimore, prindërit më parë duhet të besojnë tek përgjegjshmëria e këtyre autoriteteve për të qenë në shërbim të nxënësve dhe prindërve. Ndërkohë nga studimi rezulton se besimi i prindërve tek Ministria e Arsimit dhe Drejtoria Arsimore Rajonale është i ulët: respektivisht 21 % dhe 24 %. Pra vetëm një në katër ose një në

pesë prindër beson që këto institucione e kryejnë detyrën e tyre me përgjegjshmëri. Një besim në nivele të tilla mund t'i bëjë prindërit ta shohin si jo të efektshme ankimmimin tek këto institucione për problemet e shkollës. Kur kjo çështje është hulumtuar më në thellësi gjatë intervistave në grup, është evidentuar se prindërit në mungesë të besimit tek këto autoritete shpesh i drejtohen autoriteteve të tjera, të cilat siç duket kanë një ndikim të rëndësishëm në drejtimin dhe administrimin e arsimit parauniversitar në nivel lokal. Këto autoritete janë deputetët e qarkut¹⁵, prefekti i qarkut, apo dhe persona të tjerë që mbajnë detyra të larta në parti të politike (i.e. kryetar dege, apo drejtues të forumeve politike brenda partisë). Pohime të tilla, megjithëse të shpeshta gjatë intervistave, mbeten për tu verifikuar. Por nëse ato janë të vërteta, vënë në pikëpyetje jo vetëm legjitimitetin e autoriteteve arsimore, por hedhin hije dyshimi edhe për funksionimin e tyre sipas ligjit dhe të pandikuara nga ndërhyrjet e jashtme, veçanërisht ndërhyrjeve politike.

“Se cfare behet me prinderit nuk e dime. Per drejtorin e shkolles vendos drejtoria e arsimit. Influencon partia, deputeti zones, prefekti..”
Prind, Kukës

“Po te rrezikohet vendi punes [si mesuese] shkohet tek deputeti zones. Shkova une. Ne shkol-len tone dalin mesuesit teper dhe akoma nuk eshte bere levizja paralele....”
Mësues, Elbasan
“Gjate fushates elektorale, ka qene nje tejn-

¹⁵ Ndikimi i deputetit varion në varësi të pozitës së tij në parti, statusit social dhe ekonomik, si edhe të marëdhënies që ka me komunitetin. Megjithatë pothuajse në të gjitha rastet flitet për ndikim vetëm nga ana e deputetëve që janë pjesë e koalicionit qeverisës, pasi deputetët e partive të tjera kanë shumë pak ndikim në strukturat e arsimit parauniversitar në nivel vendor.

gopje me mesues duke dhene rrogen kot. Ose hiq kete, fut kete tjetrin se eshte i deputetit...”
Mësues, Durrës

“Jo me larg se dje, ne oren 10, une kam pas takim me deputeten e zones, per nje problem qe djali ne shkolle nuk kishte mesues... [emri i lendes] per [disa] vjet...”
Prind, Elbasan

“[Nje prind] e zgjidhi [problemin qe kishte ne shkolle] nepermjet nderhyrjes te prefektit. Dmth nderhyrja e prefektit ne drejtorine arsimore beri qe ai nxenes te kalonte aty ku deshironte, ne nje kohe qe edhe nxenes te tjere kishin pretendime per te levizur, por ishte kategorike qe asnje s` ka per te levizur”.
Prind

Në mënyrë të krahasueshme me besimin tek autoritetet arsimore, prindërit e anketuar gjithashtu raportojnë një besim tepër të ulët tek organet përfaqësuese në nivel shkolle. Kështu vetëm 30% e prindërve të anketuar besojnë plotësisht që Këshilli i Prindërve e kryen detyrën me përgjegjshmëri dhe 27% e besojnë këtë gjë për Bordin e Shkollës Ndërkohë që ky nivel i ulët besimi mund të jetë reflektues i situatës aktuale dhe veprimtarisë së këtyre Këshillave dhe Bordeve (siç u diskutua gjërësisht më sipër), ai mund ta fusë situatën në një cikël të mbyllur dhe të dëmshëm për demokracinë në shkollë. Ka baza të besohet se duke mos besuar tek organet e tyre përfaqësuese, prindërit mund të dekurajohen për fuqizimin e këtyre organeve (i.e. të mos marrin pjesë apo të mos i mbështesin) dhe për pasojë të ndikojnë në dobësimin e mëtejshëm të tyre, duke përmbushur kështu dyshimin profetik se këto struktura nuk janë të afta për të përmirësuar drejtimin dhe administrimin e shkollës.

e) Raste (kontradiktore) sukcesi

Së fundmi vlen të theksohet se përmes këtij studimi është bërë e mundur të eksplorohet kryesisht perceptimi i komuniteteve shkollore (i.e. prindër, mësues dhe nxënës) pa mundur të ballafaqohet ky perceptim me realitetin në terren, siç do të ishte rasti nëse do të ishte observuar jeta e komuniteteve shkollore për një periudhë të caktuar kohore. Por pikërisht mënyra se si prindërit e perceptojnë realitetin, është e rëndësishme për të kuptuar edhe se si ata mund të filtrojnë ngjarjet që ndodhin në jetën e komunitetit shkollor. Për ta ilustruar, përgjithësisht prindërit, nxënësit apo mësuesit, i kanë mbështetur qëndrimet e tyre pesimiste me eksperiencën të jetuara apo të dëgjuara. Megjithatë, kur atyre i është kërkuar që të reflektojnë nëse kanë patur raste të sukseshme ku organizimi i komuniteteve shkollore ka patur rezultate pozitive, pothuajse në çdo intervistë në grup janë sjellë disa raste të tilla. Për pasojë mbetet e paqartë përse këto raste nuk kanë aritur të ndryshojnë mosbesimin e prindërve, apo të luajnë rolin e shembujve inspirues duke zhvilluar kështu besimin tek forca e grupit. Arsyet për një sjellje të tillë mund të variojnë nga sasia e këtyre shembujve krahasuar me shembujt negativë, duke kaluar tek tematika e problematikave të adresuara, dhe deri tek perceptimi i prindërve për shkaqet e suksesit (i.e. kujt ja atribuonë ata suksesin). Megjithatë, kjo çështje mund dhe duhet të eksplorohet më gjerësisht në studimet e ardhshme, për të kuptuar jo vetëm përse në disa raste komunitetet funksionojnë më së miri, por edhe përse këto shembuj sukcesi nuk kanë forcë për të ndryshuar perceptimin dhe vetëbesimin e prindërve.

“Te ne erdhen prinderit per mesuesen e anglishtes, se nuk jepte mesim fare dhe e bene shume problem dhe e hoqen.”

Nxënës, Durrës

“Ne shkollen tone dolen mesues teper nga renia e numrit te nxenesve dhe eshte hera e pare qe mesuesit u bene bashke me njeri tjetrin, dmth nuk kane pranuar qe te benin “pikezimin”, renditja e mesuesve ne shkalle hierarkike. Ne u beme te gjithë bashke drejtuam leter ne Drejtorine Arsimore, kerkuam mbledhje me drejtoreshen...dhe me ne fund ja dolem ta zgjidhim kete problem. Te pakten deri tani”

Mësues, Elbasan

“Kur filloj vajza ime, klasa ishte me 34 nxenes dhe ne na u duk si numer i madh per nje mesuese te menaxhoj gjithë keto femije te klases pare dhe ne u shqetesuam dhe e ngritem ceshtjen dhe u zgjidh. Ne shkuam deri te drejtoresha [e shkolles].”

Prind, Durrës

“Ne nje rast qe patem te shkolla [emri i shkolles] mesuesit ishin ne krahe me neve. Ato e kishin te humbur vendin e punes, neqoftese do u shperndante shkolla...Ne u beme bashke dhe e ndaluam [ristrukturimin e menyre se mesimdhënies ne shkolle]”

Prindër, Kukës

“Une nje rast qe kam nxjerre ne media per nje mesuese qe rrihte nxenesit, menjehere erdhi sulmi i pare nga Drejtoria Arsimore dhe kontrollte te drejtoreshes me synime penalitetin. Po nxenesit e nxorren vete ceshtjen ne gazete. Paten edhe mbeshtetjen e prinderve...Ne fund fare,

dolem edhe tek [emri i emisionit televiziv] dhe drejtoresha u pushua nga puna te nesermen”
Mesues, Tirane

Sivjet u nderrua drejtori tek ne, donte te ndryshonte pozicionin e klasave sidomos te klasave te para dhe te dyta, keshtu duke i larguar nga tualetet femijete vegjel, dhe ne mesueset e klasave paralele, u mblodhem dhe protestuam ndaj ketij ndryshimi dhe ia dolem me sukses te qendronim aty ku ishte me mire per femijet e vegjel.

Mesues, Korce

3.4 – Shkolla, familja dhe nxënësit – një vështrim i thelluar i kontekstit socio-ekonomik dhe kulturor i familjes dhe shkollës ku studiojnë nxënësit

ENDRIT SHABANI

Të dhënat zyrtare tregojnë se 207 mijë familje (gati një e treta e popullatës) në Shqipëri kanë akses të vazhdueshëm në internet (AKEP, 2014) dhe janë rreth 1 milion e 400 mijë përdorues të rrjetit social Facebook me vendbanim në Shqipëri (Facebook, 2015), pjesa më e madhe e të cilëve i përkasin moshës nën 30 vjeç. Në këtë kontekst, siç shpjegohet edhe në kapitullin e metodologjisë, është zhvilluar një sondazh online me nxënës të moshës 15-18 vjeçare. Nga të dhënat e raportuara, rezulton se nga 1177 nxënës të anketuar, 44.3 % ishin 15-16 vjeç, dhe 55.8% e tyre 17-18 vjeç. Ka patur një përfaqësim më të madh të nxënësve që deklarojnë se jetojnë në qytet (89.5%) krahasuar me ata që jetojnë në fshat (10.5%). Kjo ndarje jo e balancuar mund të ketë ndodhur për shkak të numrit më të madh të shkollave dhe nxënësve që studiojnë në qytet, për shkak të depërtimit të internetit më shumë në qytet se sa në fshat, apo ngaqë nxënësit në fshat mund të jenë më pak të motivuar për të marrë pjesë në studime të tilla. Gjithashtu Tirana ka qenë shumë më e përfaqësuar se qytetet e tjera (52%), çka mund të shpjegohet me të njëjtat argumente si më sipër. Ndërkohë përse i përket ndarjes gjinore ka patur një ndarje të balancuar midis të anketuarve djem 50% (588 të anketuar) dhe vajza 50% (589 të anketuara).

Konteksti social, kulturor dhe ekonomik ku jetojnë nxënësit është studiuar me qëllim që të hidhet dritë mbi ndikimin që këta faktorë kanë në

procesin e edukimit të nxënësve. Për këtë arsye ata janë analizuar, duke synuar identifikimin e lidhjeve statistikore mes tyre dhe sjelljeve apo rezultateve të nxënësve. Me një nivel konfidence 95%, janë analizuar lidhjet midis variablave (nënkupto pyetjeve) të ndryshme, duke përdorur testin Chi-Square, dhe duke matur madhësinë e ndikimit (effect size) me Cramer's V. Ky efekt konsiderohet si i vogël për vlerat nga 0.1 deri në 0.29; i mesëm, për vlerat 0.3 deri në 0.49; dhe i madh për vlerat 0.5 e lart.


3.4.1 Familja - Konteksti socio-ekonomik dhe kulturor ku studiojnë nxënësit

a) Kapitali ekonomik dhe social

Shoqëria shqiptare gjatë dekadave të fundit duket po shkon drejt krijimit të njësisive më të vogla familjare, ku çiftet e martuara jetojnë të shpërndara nga prindërit e tyre, ndryshe nga çfarë ka qenë tipike për familjen shqiptare të shekullit të shkuar (Luarasi, 2001). Kështu vetëm 10% e nxënësve deklarojnë se në shtëpinë e tyre banon edhe gjyshi, gjyshja apo kushërinj të afërt. Për më tepër, nxënësit që e kanë pohuar këtë kanë qenë kryesisht banues në fshat, çka tregon se jetesa brenda familjes së madhe (me gjyshërit dhe familjarët e tjerë) është kryesisht present në zonat rurale, ku lidhjet sociale janë ende më të forta, por edhe kostot e strehimit janë më të ulëta dhe për pasojë edhe mundësitë për strehimin e një familjeje të madhe janë më të mëdha.

Shkëputja nga familja e madhe patriarkale, krijon kushte për zbehjen e disa rregullave zakonore dhe mendësisë që përforcon rolet gjinore në familje. Megjithatë nga të dhënat e këtij studimi rezulton se ka një lidhje midis nivelit të shkollimit të gruas

Tabela Nr.39 Kushtet materiale për të studiuar.



dhe rolit të saj si shtëpiake. Kështu ndërsa 67 % e nënave që kanë kryer vetëm arsimin fillor raportohet të jenë shtëpiake¹⁶, kjo shifër është vetëm 5 % tek nënat që kanë kryer arsimin e lartë. Megjithëse të dhënat e studimit tregojnë se shkollimi i ulët e bën punësimin më të vështirë për të dyja gjinitë, shifrat tregojnë se ndryshe nga bashkëshortet e tyre, burrat edhe kur kanë kryer vetëm arsimin fillor në pjesën më të madhe të rasteve (57% e tyre) janë në marrëdhënie pune.

Shkollimi i prindërve duket se ka një lidhje direkte me statusin e tyre të punësimit. Kështu prindërit që janë në punë me kohë të plotë, në 51 % të rasteve kanë kryer shkollën e lartë, dhe në 7 % të rasteve kanë kryer vetëm arsimin 8 vjeçar. Për pasojë mund të argumentohet se papunësia ndikon në

gjendjen ekonomike të familjes në të cilën rritet fëmija. Në këtë kuadër është parë se situata ekonomike e familjes ka një ndikim të drejtpërdrejtë në kohën që nxënësit i dedikojnë shkollës si dhe në përgatitjen e tyre akademike. Kështu, gati një në tre nxënës (27%) shprehet se nevojat familjare dhe problemet e tjera me natyrë ekonomike e pengojnë atë t'i kushtojë kohën e nevojshme detyrave të shkollës.

Gjendja ekonomike gjithashtu lidhet me kushtet për të mësuar që prindërit kanë mundësi për t'i krijuar fëmijës së tyre, përfshi këtu një hapësirë për të studiuar apo materiale të tjera të nevojshme. Megjithatë ndërkohë që vetëm në 6.8 % e nxënësve të anketuar shprehen se kanë libra të letërsisë klasike, 9.6 % e tyre shprehen se kanë një smartphone. Ndërkohë për të kuptuar lidhjen që kanë kushtet materiale me rezultatet e nxënësve në mësim, janë zhvilluar disa analiza statistikore duke i ndarë kushtet materiale që nxënësit raportojnë në tri grupe:

¹⁶ Termi 'shtëpiake' këtu është përdorur për të përshkruar gratë, të cilat si angazhim parësor të tyre kanë mirëmbajtjen e shtëpisë, shërbimin ndaj fëmijëve dhe të moshuarve, si dhe detyrime të tjera që lidhen me përkujdesin për familjen. Ndërkohë me këtë pohim nuk përjashtojmë ndjenjën e përkushtimit që çdo grua (apo nënë) ka ndaj familjes së saj pavarësisht statusit të saj të punësimit.

SOFTWARES (PROGRAME)



SHUME MIRE 8%
MIRE 7%
NEN MESTAR 5%
DOBET 5%

SMARTPHONE



SHUME MIRE 9%
MIRE 10%
NEN MESTAR 11%
DOBET 16%

PLATFORME DIXHITALE



SHUME MIRE 5%
MIRE 5%
NEN MESTAR 6%
DOBET 7%

LIBRA LETERSI KLASIKE



SHUME MIRE 9%
MIRE 7%
NEN MESTAR 2%
DOBET 5%

FJALORE



SHUME MIRE 10%
MIRE 9%
NEN MESTAR 8%
DOBET 7%

a) Hapësira private

(dhomë personale dhe tavolinë studimi)

b) Mjete teknologjike

(PC, internet, programe, smartphone dhe platformë dixhitale)

c) Libra

(letërsi klasike, libra akademikë, fjalorë)

Në lidhje me kategorinë a) ka rezultuar se nxënësit që raportojnë rezultate shumë të mira në mësimet, vetëm në 7 % të rasteve kanë raportuar të kenë një dhomë më vete dhe vetëm në 11 % të rasteve kanë raportuar të kenë një tavolinë personale studimi. Në anën tjetër nxënësit që kanë raportuar rezultate të dobëta në mësimet kanë raportuar më shpesh se kanë një dhomë të tyre (10%) apo një tavolinë studimi personale (12%). Këto të dhëna tregojnë se ndërkohë që hapësira personale në shtëpi është e nevojshme për nxënësin, ajo nuk është e domosdoshme për performancën e tij në shkollë.

Së dyti, është vënë re se sa më shpesh nxënësit të raportojnë për zotërimin e mjeteve teknologjike, aq më shpesh ata raportojnë për rezultate të ulëta në mësimet. Ndërkohë që 56 % e nxënësve me rezultate të dobëta në mësimet deklarojnë se zotërojnë një ose më shumë prej sendeve të përmendura në kategorinë b, vetëm 45 % e nxënësve me rezultate shumë të mira raportojnë zotërimin e tyre. Kjo lidhje e zhdrejtë duket më së miri tek raportimi për internetin në shtëpi, të cilin kanë raportuar se e kanë 11 % e nxënësve me rezultate shumë të mira, 13 % e atyre me rezultate të mira, 15 % e atyre me rezultate nën mesataren, dhe 17% e nxënësve me rezultate të dobëta. Këto të dhëna janë të debatueshme, pasi linja e internetit dhe kompjuteri personal janë mjete të domosdoshme për suksesin në mësimet të një nxënësi në epokën e internetit. Megjithatë të dhënat gjithashtu sugjerojnë se prindërit duhet të bëjnë më tepër kujdes për mënyrën se si fëmijët i përdorin këto mundësi, në mënyrë që interneti të jetë në funksion të mirë-edukimit të fëmijës dhe jo ta shpërqëndrojë atë nga mësimet.

Së fundmi, është parë lidhja mes librave të raportuar dhe notave të nxënësve, e cila ka rezultuar një lidhje statistikore në formë të drejtë, pra sa më shumë libra në shtëpi aq më të larta notat e raportuara. Kështu kanë raportuar se kanë libra në shtëpi (sipas llojeve të përcaktuara në kategorinë c) 29% e nxënësve me rezultate shumë të mira, 25% e nxënësve me rezultate të mira, 16% e nxënësve me rezultate nën mesataren, dhe 19% e nxënësve me rezultate të dobëta. Këto të dhëna mund të sugjerojnë si për rolin që mund të kenë librat në përgatitjen më të mirë të nxënësve, por gjithashtu ato mund të jenë tregues të një kapitali kulturor të familjes, i cili siç analizohet edhe më tej në këtë studim, mund të ndikojë në performancën e nxënësit në shkollë.

b) Kapitali kulturor


Shkollimi i prindërve konsiderohet si mundësi për krijimin e kapitalit kulturor, i cili mund të transferohet më pas tek fëmijët. Për të vlerësuar këtë faktor, nxënësit janë pyetur për shkollimin e prindërve dhe rreth një e treta (37 %) e tyre raportojnë se nëna e tyre, e cila jeton me ta, ka kryer vetëm arsimin e mesëm; ndërsa 38% e tyre raportojnë se ajo ka kryer arsimin e lartë. Përsa i përket shkollimit të babait, 32% e nxënësve të anketuar shprehen se ai ka kryer vetëm arsimin e mesëm, ndërsa 36 % shprehen se ka kryer arsimin e lartë. Është vërejtur se ka një lidhje domethënëse statistikore midis nivelit të shkollimit të dy prindërve, e tillë që burrat që kanë ndjekur shkollën e lartë të martohen me gra që kanë mbaruar shkollën e lartë, dhe e kundërta gra që kanë ndjekur vetëm arsimin fillor të martohen me burra që kanë ndjekur vetëm arsimin fillor. Kjo e dhënë tregon se në të shumtën e rasteve fëmijët ose rriten në familje me prindër të mirë-arsimuar, ose e kundërta.

Megjithatë për të kuptuar lidhjen midis shkollimit të prindërve dhe ndikimit të tij tek fëmijët, janë bërë disa analiza statistikore, dhe është vërejtur se 42% e nxënësve që deklarojnë se babai i tyre ka kryer shkollimin e lartë raportojnë se kanë rezultate shumë të mira në mësim. Nëse llogarisim edhe nxënësit që deklarojnë se kanë rezultate të mira, kjo përqindje është akoma më e lartë (77%). Ndërkohë, në anën tjetër nxënësit që kanë deklaruar se babai i tyre ka kryer vetëm shkollën fillore, vetëm në 5.2 % të rasteve raportojnë të kenë rezultate shumë të mira në mësim. E njëjta gjë vlen edhe për shkollimin e nënës, ku nxënësit e nënave që kanë kryer shkollën e lartë, vetëm në 0.07 % të rasteve raportojnë rezultate të dobëta në mësim. Ndërkohë që kjo shifër është disa herë më e lartë (22%) për nxënësit, nëna e të cilëve ka kryer vetëm arsimin fillor.

Në përfundim, është e qartë se të dhënat tregojnë një lidhje të fortë midis kapitalit kulturor (apo ekonomik) të prindërve dhe rezultateve në mësim të nxënësve. Arsyet e kësaj lidhjeje janë trajtuar nga autorë të ndryshëm (për më tepër lexo Bourdieu 1983), prandaj këto të dhëna janë shumë të rëndësishme për të ndikuar politikatat e institucioneve arsimore në një adresim më të mirë të nevojave dhe vështirësive të nxënësve që vijnë nga familje me prindër të paarsimuar. Rezultatet e ndërhyrjeve të ngjashme në vende të ndryshme të botës, kanë treguar se vetëm nëse institucionet arsimore do të bëjnë përpjekje serioze për të ndihmuar nxënësit që vijnë nga kontekste sociale të disavantazuara, është e mundur të thyhet cikli kulturor (por edhe ekonomik) i këtyre familjeve.

Tabela 40:

Lidhja midis ndihmës së prindërve dhe rezultateve të nxënësit



c) Angazhimi i prindërve për të ndihmuar fëmijët me mësimet

Mospërbushja e detyrimeve ndaj nxënësve nga ana e institucioneve arsimore mund të neutralizohet nga një vëmendje më e lartë e prindërve ndaj nevojave të fëmijës së tyre dhe nga ndihma që ata mund të japin për të. Për këtë arsye është analizuar se sa të angazhuar janë prindërit për t'i ndihmuar fëmijët e tyre me përgatitjen e mësimëve. Të dhënat sugjerojnë se ndihma që prindërit i japin fëmijës së tyre varion në varësi të moshës së fëmijës, nga niveli i arsimimit të prindërve, si edhe nga vendbanimi (i.e. qytet apo fshat).

Së pari është vënë re se ka një diferencë në sjelljen e prindërve që jetojnë në qytet nga ata që jetojnë në fshat, në lidhje me ndihmën që i japin fëmijës me mësimet. Kështu nxënësit që jetojnë në fshat raportojnë më shpesh se nuk ndihmohen asnjëherë nga prindërit e tyre (46%) se sa nxënësit që jetojnë në qytet (35 %).

Së dyti, është vënë re një lidhje domethënëse statistikore midis moshës së nxënësit dhe ndihmës që prindi i jep në mësimet. Kjo lidhje është e zhdrejtë, duke bërë që sa më i vogël fëmija aq më

e madhe gatishmëria e prindit për ta ndihmuar. Kështu raportojnë se ndihmohen gjithnjë ose shpesh nga prindërit 28 % e 15 vjeçarëve, 24.5% e 16 vjeçarëve, 19% e 17 vjeçarëve, dhe 16% e nxënësve 18 vjeçarë. Dhe në krahasim të kundërt ndërkohë që vetëm 18% e 15 vjeçarëve shprehen se nuk ndihmohen asnjëherë nga prindërit e tyre, 28 % e 18 vjeçarëve e pohojnë këtë. Pra duket qartë që me rritjen e moshës bie numri i nxënësve që raportojnë se ndihmohen nga prindërit në përgatitjen e mësimëve. Nga njëra anë kjo mund të duket kundër intuitive pasi me rritjen e nxënësve rritet edhe vështirësia në mësimet dhe nevoja për ndihmë, por nga ana tjetër me rritjen e fëmijës mund të rritet edhe besimi i prindërve tek ta dhe aftësitë e tyre, sikurse edhe ulet mundësia që prindi të ketë njohuritë e nevojshme për ta ndihmuar fëmijën.

Hipoteza e ngritur më sipër, konfirmohet edhe nga korrelacioni midis shkollimit të prindërve dhe ndihmës që ata i japin fëmijës në mësimet. Kur janë pyetur nxënësit nëse ndihmohen nga prindërit në lidhje me mësimet, vetëm 21 % e tyre shprehen se kjo ndodh gjithmonë ose shpesh, ndërsa 36% shprehen se kjo nuk ndodh asnjëherë. Por kur është analizuar se cilët prindër

janë më të gatshëm për të ndihmuar fëmijët me mësimet është vënë re se ndërkohë që kjo ndodh me 17% të nënave që kanë mbaruar vetëm arsimin 8-vjeçar, me nënat që kanë mbaruar arsimin e lartë kjo shifër është 29%. Tek baballarët këto shifra janë respektivisht 15% dhe 27%. Po ashtu ndërkohë që 47% e baballarëve që kanë mbaruar vetëm arsimin 8-vjeçar raportohet se nuk i ndihmojnë asnjëherë fëmijët e tyre në mësimet, kjo shifër është 29% tek baballarët që kanë mbaruar arsimin e lartë. Tek nënat këto shifra janë respektivisht 46% dhe 24%. Me fjalë të tjera, duket që me rritjen e nxënësit dhe komplikimin e mësimet, prindi e delegon ndihmën tek kurset private. Çështje kjo që do të shtjellohet më tej në në këtë kapitull.

Për ta përmbyllur, pavarësisht arsyeve përse prindërit i ndihmojnë apo jo fëmijët e tyre, është me rëndësi të theksohet se ka një lidhje statistikore midis ndihmës që japin prindërit dhe rezultateve të nxënësve. Kështu nxënësit që deklarojnë se ndihmohen gjithnjë nga prindërit në përgatitjen e mësimet, raportojnë më shpesh nota shumë të mira (37%) dhe më rrallë nota nën mesataren apo të dobëta (10%), krahasuar me nxënësit që deklarojnë se nuk ndihmohen asnjëherë nga prindërit, të cilët deklarojnë më rrallë nota të mira (29%) dhe më shpesh nota të dobëta (12%).

3.4.2 Shkolla – Konteksti shkollor, përkushtimi i mësuesve dhe perceptimi i nxënësve për shkollën

Kur i është kërkuar të vlerësojnë performancën e tyre në mësimet, 64% e nxënësve të anketuar e kanë përshkruar atë si të mirë ose shumë të mirë, dhe 28% si mesatare. Këto të dhëna mund të tregojnë për njëanshmëri në kampionin e studimit, ku nxënësit me rezultate të dobëta mund

të jenë të painteresuar për të marrë pjesë në këto studime. Por, ato mund të jenë edhe të ndikuara nga një dëshirë për ta paraqitur veten më mirë se në realitet, siç është shpesh rasti për vlerësimet e bazuara në vetëdeklarim.

a) Perceptimi dhe motivimi i nxënësve për shkollën

Gjendja psikologjike e nxënësit është tepër e rëndësishme për mirërritjen e tij, dhe për këtë arsye shumë shtete bëjnë përpjekje të veçanta për t'i kthyer shkollat në ambiente miqësore për nxënësit, ku ata të mos ndihen të përjashtuar, të dekurajuar apo diskriminuar. Për këtë qëllim janë pyetur nxënësit shqiptarë se si ndihen në shkollë dhe se si e perceptojnë ata mjedisin shkollor.

Së pari, studimi ka evidentuar se shumë nxënës nuk e shohin shkollën si një ambient të gëzueshëm, por si një ambient i cili më së shumti lidhet me ndjenjën e ankthit. Në thelb të kësaj ndjenje duket se qëndron vlerësimi i mësuesve për arritjet e nxënësit (nota), e cila në vend që të shërbejë si motivues duket se shërben si instrument kërcënues për nxënësin. Kështu 89% e nxënësve të anketuar shprehen se ata kanë frikë nga nota, dhe 68% e tyre të anketuar shprehen se do të shkonin me dëshirë në shkollë nëse nuk do të kishte nota. Megjithatë, kjo gjëndje nuk duket të luajë ndonjë rol në frekuentimin faktik të shkollës, pasi vetëm 8.4% e të anketuarve pranojnë se brenda dy javëve të fundit kanë munguar më shumë se tri herë; dhe vetëm 9.5% e tyre deklarojnë se kanë lënë më shumë se tri herë orën e mësimet. Por nga ana tjetër, siç u shpjegua edhe më lart, të dhëna të tilla në vend që të japin një pamje të plotë të realitetit, mund të ilustrojnë njëanshmërinë e kampionit, ku vetëm nxënësit të përdorur për shkollën mund të jenë të inkurajuar për të marrë pjesë në studim duke plotësuar pyetësonin.

Tabela 41:
Lidhja midis mënyrës se si ndihen nxënësit dhe rezultateve që raportojnë në mësim

		Si do ti pershkruanit rezultatet tuaja ne shkolle?				
		Shume te mira	Te mira	Mesatare	Nen mesataren	Te dobta
Unë ndihem shpesh si i lënë mënjanë në shkollë.	Shumë dakord	5,6%	10,0%	10,7%	19,7%	40,0%
	Dakord	11,4%	12,4%	15,4%	16,4%	4,0%
	Pak dakord	22,5%	26,3%	26,7%	27,9%	24,0%
	Aspak dakord	60,5%	51,3%	47,2%	36,1%	32,0%

Së dyti, 23% e nxënësve të anketuar shprehen se ndihen të braktisur kur janë në ambientet e shkollës, dhe 27 % e tyre shprehen se nuk bëjnë kollaj miq në shkollë. E eksploruar më tej kjo çështje ka evidentuar se ka një lidhje domethënëse statistike midis mënyrës se si ndihen nxënësit në shkollë dhe rezultateve të tyre në mësim. Kështu nxënësit që shprehen se ndihen të lënë mënjanë në shkollë kanë prirje të raportojnë rezultate më të ulta në mësim. Më konkretisht, nxënësit që pohojnë se ndihen të braktisur në shkollë raportojnë rezultate të larta në mësim vetëm në 17% të rasteve, ndërsa ky numër është dyfish (60%) për ata që nuk ndihen të braktisur. Kjo lidhje mund të shpjegohet që sa më pak i motivuar të jetë nxë-

nësi për tu përfshirë në jetën shkollore, aq më shumë gjasa ka që ai të ketë rezultate të ulta. Por mund të ndodhë edhe që nxënësit me rezultate të ulta të lihen mënjanë nga mësuesi dhe nxënësit e tjerë duke e bërë edhe më të vështirë kuptimin e mësimëve apo kryerjen e detyrave. Në çdo rrethana është me rëndësi që institucionet arsimore, dhe në veçanti njësia më e afërt me nxënësin (shkolla), të marrë masa jo vetëm për përgatitjen akademike të nxënësve por mbi të gjitha për të garantuar një mjedis të shëndetshëm psikologjik për nxënësin.

Së fundmi, një nga indikatorët kryesorë për vlerësimin e sistemit arsimor që përdoret nga

OECD në renditjen botërore PISA¹⁷ është aftësia e shkollës për të përgatitur nxënësit me aftësi praktike për jetën (OECD, 2001). Ndërkohë nxënësit shqiptar të anketuar duket se nuk shohin një lidhje midis mësimeve që mësojnë në shkollë dhe botës reale, apo të ardhmes së tyre. Kështu gati gjysma e nxënësve të anketuar (46%) mendojnë se shkolla ka bërë pak për t'i përgatitur ata për të ardhmen. Megjithatë, në anën tjetër, një pjesë e konsiderueshme e tyre (56%) shprehen se shkolla i ka ndihmuar për të fituar vetëbesim në marrjen e vendimeve për jetën. Përsa i përket pohimit të fundit, është e vështirë të veçohet ndikimi i drejtpërdrejtë që mund të ketë patur *shkolla* si institucion, apo *shkolla* si komunitet social, ku nxënësi krijon lidhje të rëndësishme sociale jo vetëm me institucionin por edhe me moshatarët e tij.

b) Dendësia e klasave dhe sjellja e nxënësve gjatë orës së mësimi

Përsa i përket përbërjes së klasës në shkollat publike, vetëm 18.3% e nxënësve të anketuar raportojnë se mësojnë në një klasë të përbërë nga 16 - 25 nxënës; pothuajse gjysma e tyre (45%) raportojnë për një klasë me 26-35 nxënës, dhe një e treta (30%) raportojnë se në klasën e tyre ka 36-45 nxënës. Një përqindje tepër e vogël (2%) raporton se në klasën e tyre ka mbi 45 nxënës. Kur është analizuar se cilat shkolla kanë më tepër nxënës, është vënë re se shkollat e qytetit kanë prirjen për të qenë më të mbipoplluara. Kështu 35% e nxënësve që studiojnë në qytet raportojnë që studiojnë në klasa me mbi 36 nxënës, ndërkohë që vetëm 15% e nxënësve që studiojnë në fshat e deklarojnë këtë.

17 PISA – Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve është një studim ndërkombëtar i përgatitur prej Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), i cili vlerëson performancën e 15 vjeçarëve në 65 shtete dhe territore të Botës.

Arsyet e mbipopullimit të klasave mund të lidhen me disa faktorë (si dendësia e popullsisë në zona të caktuara, apo preferenca për një shkollë të caktuar), por duhet theksuar se një klasë me mbi 35 nxënës e bën të vështirë menaxhimin e orës së mësimi nga mësuesi. Për më tepër një raport i tillë mësues për nxënës e bën të vështirë kohën dhe vëmendjen për të cilën secili nxënës ka nevojë. Kjo bëhet edhe më shqetësuese po të merret parasysh kurrikula mësimore e arsimit parauniversitar në Shqipëri ku përveç orës së mësimi nuk parashikohen orë të tjera ku nxënësi të mund të kalojë më tepër mbikqyrje individuale nga mësuesi. Në këtë kuadër janë pyetur nxënësit në lidhje me menaxhimin e orës së mësimi nga ana e mësuesve dhe 20% e tyre shprehen se shpesh në klasë ka zhurmë gjatë orës së mësimi, dhe 22% e tyre shprehen se mësuesi duhet të presë derisa nxënësit të qetësohen. Ndërkohë dhe 39% e nxënësve të anketuar shprehen se në disa orë mësimi, për shkak të zhurmës, nxënësit nuk dëgjojnë pothuajse fare shpjegimin e mësimi.

c) Raportet mësues - nxënës

Për të vlerësuar ndikimin e mësuesve në formimin e nxënësve është synuar që të merret perceptimi i nxënësve për mësuesit. Duke qenë se qëllimi nuk ka qenë që të vlerësohet direkt mësuesi, por perceptimi i nxënësit për të, të dhënat nuk janë mbledhur përmes vëzhgimit të sjelljes së mësuesit gjatë orës së mësimi, por përmes sondazhit me nxënës.

Si fillim, në lidhje me raportin mësues – nxënës, ka rezultuar se 67% e nxënësve të anketuar deklarojnë se mësuesit shkojnë mirë me shumicën e mësuesve, dhe gati gjysma e tyre (53%) shprehen se mësuesit i japin ndihmë të veçantë nxënësve kur këta kanë nevojë për të kuptuar mësimet. Në

Tabela 42:
Lidhja midis numrit të nxënësve dhe metodologjisë së mësimdhënies

Mësuesi më tregon se çfarë duhet të bëj për patur rezultate më të larta në mësim dhe për të kuptuar më mirë mësimin.		Shpesh	Në disa orë mësimi	Rrallë
Sa nxenes ka, mesatarisht, në klasen tuaj?	10-15	6,8%	5,0%	1,6%
	16-25	25,8%	18,0%	11,7%
	26-35	43,1%	43,5%	47,4%
	36-45	23,8%	31,4%	36,0%
	Mbi 45	,5%	2,1%	3,3%

anën tjetër, gati gjysma e nxënësve të anketuar (46%) shprehen se po të kishin mësues të tjerë do të përpiqeshin më shumë për të mësuar. Një pohim i tillë lë të kuptohet se mësuesit luajnë një rol të rëndësishëm në motivimin e nxënësve për të mësuar, rol të cilin shumë mësues ende nuk duket se e kryejnë siç duhet.

Për sa i përket komunikimit midis mësuesve dhe nxënësve gati gjysma e nxënësve të anketuar (52%) shprehen se mësuesi iu kërkon shpesh që të shprehin mendimet e tyre për mësimin. Gjithashtu 64% e tyre shprehen se mësuesit i dëgjojnë me kujdes ato që thonë nxënësit, dhe 74 % deklarojnë se mësuesit iu japin mundësi

të shfaqin hapur mendimet dhe opinionet e tyre. Ndërkohë që të dhëna të tilla tregojnë se në një pjesë të madhe të shkollave komunikimi midis nxënësit dhe mësuesit funksionon mirë, sërish mbetet shqetësues çdo rast ku nxënësit ndiejnë se nuk iu jepet mundësia që të shprehin hapur opinionet e tyre. Një gjë e tillë jo vetëm ndihmon në përmirësimin e procesit të mësimdhënies, por mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në kultivimin e qytetarëve të lirë në një shoqëri demokratike, të ngritur mbi parimet e lirisë dhe barazisë.

Për më tepër, më shumë se gjysma (57 %) e nxënësve të anketuar shprehen se ndodh shpesh

që mësuesi iu bën pyetje nxënësve për të parë nëse ata e kanë kuptuar mësimin, dhe mbi një e treta e tyre (37%) pohojnë se mësuesi i udhëzon për të kuptuar më mirë mësimin dhe për të arritur rezultate më të larta në mësim. Komunikimi transparent në lidhje me vlerësimin dhe udhëzimi i nxënësve për të patur nota më të larta në mësim, janë masa të cilat përbëjnë detyrime tepër të rëndësishme për mësuesin. Për këtë arsye, identifikimi i një komunikimi të tillë vetëm nga një e treta e nxënësve të anketuar do të thotë që ka ende punë për të bërë në këtë drejtim. I takon Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve që ta adresojë këtë çështje përmes politikave të saj, duke garantuar një komunikim mësues-nxënës që i përgjigjet standardeve që vetë kjo ministri ka vendosur në strategjinë e saj për arsimin parauniversitar (2014).

d) Metodologjia e mësimdhënies

Përsa i përket metodologjisë së mësimdhënies, vetëm 22% e nxënësve (më pak se një në katër nxënës) pohojnë se mësuesi e ndan shpesh klasën në grupe të vogla pune, çka tregon se kjo metodë mësimdhënieje nuk është e shpeshtë në arsimin parauniversitar në Shqipëri. Ndërsa përsa i përket trajtimit të diferencuar të nxënësve, bazuar mbi aftësitë dhe nevojat e tyre të veçanta, pjesa më e madhe e nxënësve të anketuar (87%) shprehën se mësuesi i jep të njëjtat detyra të gjithë nxënësve pavarësisht nëse disa prej tyre mund të jenë më të përparuar se të tjerët apo disa mund të kenë vështirësi për të kuptuar mësimin. Mirëpo, teksa trajtimi i nxënësve sipas nevojave të tyre specifike, apo organizimi i klasës në grupe pune, janë metoda efektive mësimdhënieje, duhet kuptuar që shumë shkolla publike kanë vështirësi logjistike (i.e. klasa të vogla dhe të mbipopulluara) për ta praktikuar atë. Për më

tepër ndërkohë që ka shumë faktorë që mund të ndikojnë në mënyrën se si organizohet mësimi (i.e. përgatitja e mësuesit dhe politikat arsimore) është parë se ka një lidhje statistikore midis numrit të nxënësve në klasë dhe sjelljeve të mësuesve. Duhet sqaruar se pavarësisht numrit të nxënësve ora e mësimit mbetet e njëjtë (45 minuta) çka do të thotë që me rritjen e numrit të nxënësve ulet koha që mësuesi ka në dispozicion për secilin nxënës gjatë orës së mësimit (por edhe mbas saj). Kjo vihet re tek pohimet e të anketuarve, ku 67% e nxënësve që studiojnë në një klasë me 10-15 nxënës shprehën se mësuesi iu kërkon shpesh që të paraqesin mendimet e veta. Ndërkohë për nxënësit që studiojnë në klasa me mbi 45 vetë, vetëm 26% (tre herë më pak) e konfirmuan këtë kërkesë. Në po të njëjtën linjë, ndërkohë që 37% e nxënësve që studiojnë në klasa me 10-15 vetë, u shprehën se mësuesi i ndan shpesh në grupe të vogla për të punuar sëbashku, vetëm 18% (dy herë më pak) e nxënësve që studiojnë në klasa me 36-45 nxënës në klasë e pohuan këtë.

Megjithatë, pavarësisht se numri i nxënësve në klasë dhe metodologjia e mësimdhënies lidhen statistikisht, është sërish e vështirë të ndërtohet një marrëdhënie e drejtë shkak-pasojë midis këtyre variablave, pasi numri i vogël i nxënësve në klasë mund të jetë në vetvete pasojë e një shkakut tjetër, i cili mund të jetë përgjegjës gjithashtu edhe për sjelljen e mësuesve. Për shembull në një shkollë private me standarde të larta në mësimdhënie, numri i nxënësve në klasë mund të jetë më i vogël, por edhe mësuesit të sillen ndryshe. Por në këtë rast sjellja e mësuesve mund të mos jetë vetëm për shkak të numrit të nxënësve, por për shkak se procesi i rekrutimit mund të jetë më rigoroz, incenti-

vat ekonomike më të larta, dhe administrimi i shkollës të jetë në mënyrë më të favorshme. Ndoshta do ishte më e drejtë të thuhet se klasat e vogla dhe hapësirat e mëdha janë kushte të domosdoshme, por jo të mjaftueshme për mirëorganizimin e orës së mësimi.

e) Kurset private

Siç u diskutua edhe më sipër, në klasat me shumë nxënës nuk krijohet mundësia për nxënësin që të marrë mbikqyrjen e nevojshme nga mësuesi. Një mundësi alternative janë kurset private¹⁸, të cilat mund të përmbushin këtë nevojë të nxënësit. Në këtë kuadër janë pyetur nxënësit nëse ndjekin kurse private dhe ka rezultuar se 38% e tyre zhvillojnë deri në pesë kurse jashtëshkollore dhe vetëm 4% deklarojnë se zhvillojnë vetëm një kurs jashtëshkollor. Një në katër nxënës (24%) deklaroi se nuk zhvillon asnjë kurs, dhe gati gjysma (53%) e tyre deklaroi se zhvillojnë kurse në dy lëndë (Gjuhë Shqipe dhe Matematikë).

Arsyet përse nxënësit ndjekin kurse private janë të shumta, por arsyet kryesore lidhen me shkollën e lartë. Në përgjithësi kurset private shërbejnë për përgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore (MSH), siç duket qartë edhe nga rezultatet e sondazhit ku tri lëndët kryesore në të cilat nxënësit marrin kurse private janë Matematika (39%), Gjuha e huaj (39%) dhe Gjuha shqipe (14%), të cilat përbëjnë edhe tri provimet e detyruara në MSH. Pra nxë-

nësit ndjekin kurse private për tu përgatitur për lëndët të cilat do të japin provim në MSH, pasi rezultatet e larta ju mundësojnë ndjekjen e studimeve në degën e tyre të preferuar në universitetet shtetërore. Shqetësuese është hipoteza e ngritur se një pjesë e nxënësve zhvillojnë kurse private me mësuesin e lëndës vetëm për të përfituar nota më të mira në atë lëndë. Një tezë e tillë mund të mbështetet nga rezultatet e sondazhit, ku 71% e nxënësve që deklarorin se bënin kurs me mësuesin e lëndës, u shprehën se nuk do ta ndiqnin këtë kurs, nëse në shkollë nuk do të viheshin nota. Kurset private me mësuesin e lëndës janë të ndaluara nga MAS, por ky studim ka evidentuar se ato vazhdojnë të kryhen gjerësisht.

Megjithëse në parim kurset private janë një mundësi më tepër për nxënësin që të mësojë gjëra të reja, shpesh ato bëhen shkak për të krijuar pabarazi mes nxënësve. Të dhënat tregojnë se nxënësit që nuk i kanë prindërit në gjendje pune ndjekin më rrallë kurset private (24 %) se sa ata që i kanë prindërit në punë me kohë të plotë (27%). Por po të marrim parasysh çmimin e këtyre kurseve, ku një seancë është e barabartë me çmimin e një dite pune për rrogën minimale në Shqipëri, mund të thuhet se këto kurse sjellin një barrë për familjet shqiptare, dhe kryesisht për familjet me të ardhura të pakëta. Në rastet kur kjo barrë ekonomike është e papërbalueshme, nxënësi nuk do të ketë mundësi të përgatitet njësoj si nxënësit e tjerë, të cilët në kushtet e MSH-së janë konkurentët e drejtpërdrejtë të tij, me të cilët do të konkuroj për një vend në shkollat e larta shtetërore.

¹⁸ Kurse private, shpesh realizohen midis një mësuesi dhe një apo disa nxënësve. Gjatë këtyre kurseve që zgjasin midis 1 orë dhe 1 orë e gjysëm, mësuesi kundrejt pagesës (e cila varion midis 1000 dhe 3000 lekë në orë) punon me nxënësin (ose nxënësit) për ta ndihmuar atë të kuptojë mësimet përkatëse. Këto kurse shpesh janë informale, por në disa raste ka edhe qendra të organizuara për këtë qëllim. Mësuesi që jep mësim në shkollat publike është i ndaluar të zhvillojë kurse private me nxënësit e tij.

Tabela 43:

Lidhja midis statusit të punësimit të prindërve dhe numrit të kurseve private që zhvillojnë.

Sa here ndjek konsultime/kurs privat per kete lende?

		Më pak se 2 orë në javë	2 ose me shume ore ne jave
Aktualisht cili eshte statusi i punesimit i nenes juaj?	Punon me kohe te plote, me pagese	57	58
	Nuk punon, por eshte ne kerkim te punes	13	13
	Te tjera (p.sh. shtepiake, ka dale ne pension)	21	26

Përmbyllje

Në përfundim, pavarësisht shqetësimeve të ngri-
tura më sipër dhe argumenteve për përgjegjësisë
që kanë institucionet arsimore për t'i ndihmuar nxë-
nësit në mësim, duket se ata kanë patur sukses në
një gjë: ose në bindjen e nxënësit tek aftësitë e tij, ose

në vetëfajësimin e tij për performancën në shkollë. E
thënë kjo pasi 92% e nxënësve të anketuar shprehen
se nëse ata do të përpiqeshin më shumë, do të arrinin
rezultate më të larta në mësim, çka mund të interpre-
tohet se nxënësit besojnë se, pavarësisht të gjithave,
ata nuk janë përpjekur mjaftueshëm.

BIBLIOGRAFI

- AERA. (2011). AERA Code of Ethics: American Educational Research Association Approved by the AERA Council February 2011. *Educational Researcher*, 40(3), 145–156. doi:10.3102/0013189X11410403
- BERA. (2011). Ethical Guidelines for Educational Research. London: *British Educational Research Association*. Retrieved June 1, 2014, from <http://www.bera.ac.uk/ëp-content/uploads/2014/02/BERA-Ethical-Guidelines-2011.pdf>
- Bourdieu, P. (1983). Forms of capital'in Handbook of Theory and Research for the Sociology of Education, ed. JC Richards.
- ESRC. (2012). ESRC Framework for Research Ethics (FRE) 2010 [Updated 2012]. Retrieved June 2, 2014, from <http://www.esrc.ac.uk/about-esrc/information/research-ethics.aspx>
- Facebook (2015). <https://www.facebook.com/>
- AKEP (2014). Raporti vjetor i veprimtarisë për vitin 2014. Tiranë: Agjensia e
- Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
- Ligj Nr. 69 (2012). Për sistemin arsimor parauniversitar në Shqipëri.
- Ligj Nr.9887 (2008). Për mbrojtjen e të dhënave personale. Ndryshuar me ligjin Nr.48/2012.
- Luarasi, A. (2001). *Studime për të drejtën zakonore shqiptare: Marrëdhëniet familjare*. Tiranë: Luarasi
- MAS (2014). Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020. Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Sporteve
- MAS (2013). Udhëzimi Nr. 57 Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të Arsimit Parauniversitar. Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Sporteve
- Merton, R. K. (1948). The self-fulfilling prophecy. *The Antioch Review*, 193-210.
- OECD (2001). *Knowledge and Skills for Life. First Results from the OECD Programme for International Student Assessment (PISA) 2000*. Paris:OECD Publishing
- OSFA (2013). Monitorimi i Ligjit të Arsimit Parauniversitar: Strukturat e ngritura brenda shkolle. Tiranë: Fondacioni Shoqëria e Hapur Për Shqipërinë (OSFA)
- OSFA (2012). Raport monitorimi Alttertekst 2012. Tiranë: Fondacioni OSFA
- Putnam, R. D. (2001). *Bowling alone: The collapse and revival of American community*.
- Simon and Schuster. Sandel, M. J. (2010). *Justice: what's the right thing to do?*. Macmillan.
- Shoqata e Prindërve të Tiranës (2014). *Raport vlerësimi i monitorimit të zgjedhjes së drejtorëve të shkollave në qytetin e Tiranës*.



Rr. Qemal Stafa, Pallati 120/2, Tirana, Albania

www.osfa.al



[soros.al](https://www.facebook.com/soros.al)



[soroshqiperi](https://twitter.com/soroshqiperi)